



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org



DRAFT PLANI I PUNËS I EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2024

Klinë, dhjetor 2023

HYRJE

Ky Plani i Punës është hartuar duke u bazuar në nevojat që kanë qytetarët e Komunës së Klinës të theksuara gjatë dëgjimeve buxhetore dhe kërkesave të vazhdueshme që bëjnë në komunë. Plani ka për qëllim planifikimet për rritjen e vazhdueshme të transparencës dhe llogaridhënies, kontaktit në çdo kohë dhe në çdo vend me qytetarët, duke i përmbushur të gjitha obligimet ndaj qytetarëve, siç e kërkon legjislacioni në fuqi.

Në këtë plan të punës, synimet dhe projektet e planifikuara të ekzekutivit të komunës së Klinës për vitin 2024 janë në funksion të realizimit të synimeve kryesore zhvillimore, të përcaktuara në dokumentet zhvillimore të komunës, si zhvillimi ekonomik, zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve, përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë, përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Ky plan i punës përcakton aktivitetet që do të ndërmerren këtë vit dhe kohën e aktivitetit për të bërë realitet vizionin që Klina gradualisht të bëhet një komunë ekonomikisht e zhvilluar me një administratë efikase, në shërbim të qytetarëve të vet dhe bizneseve, me një mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe punuar, duke treguar progres të vazhdueshëm në përmirësim të cilësisë së arsimit, shëndetësisë dhe shërbimeve publike.

Në vitin 2024 prioritetet kryesore do të jenë përmirësimi i infrastrukturës fizike, në mënyrë që vitet në vijim të krijohen parakushtet për të kaluar në fazën e mirëfilltë të zhvillimit ekonomik lokal, duke u përqendruar në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, posaçërisht në lëmin e prodhimit, bujqësisë, turizmit dhe trashëgimisë kulturore.

Gjatë punës dhe ushtrimit të funksioneve, ekzekutivi, përkatësisht qeverisja komunale, aktivitetet për realizimin e synimeve kryesore do t'i ndërlidhë me dokumentet strategjike të nxjerra nga Kuvendi i Komunës si dhe orientimet strategjike në nivel vendi.

Në vijim po prezantojmë planet sektoriale të punës dhe të veprimit për të gjitha drejtoritë veç e veç, siç vijon:

PËRMBAJTJA:

Hyrje.....	2
1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.....	4
2. Drejtoria e Arsimit.....	13

3. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.....	24
4. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....	29
5. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.....	33
6. Drejtoria për Punë Inspektuese.....	36
7. Drejtoria e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.....	40
8. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.....	48
9. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë	55
10. Drejtoria E Financave, Ekonomisë Dhe Zhvillimit.....	58

1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËR GJITHSHME

Misioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve nëpërmjet komunikimit korrekt dhe transparent lidhur me kushtet, procedurat administrative, respektimin e ligjeve, respektimin e afateve kohore të dhënies së përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve.

1. Sektori i Regjistrimit të Gjendjes Civile - Ofiqaria

Gjendja Civile në Klinë është e organizuar në Zyrën qendrore, ku punojnë 5-zyrtarë së bashku me shefin e Gjendjes civile, si dhe gjithashtu 10-zyra në terren, duke përfshirë 10-zyrtarë.

Planifikimet e Zyrës së Gjendjes Civile për vitin 2024 do t'i paraqesim, si në vijim:

- Të sigurohet një sallë për kurorëzime, që është shumë e domosdoshme;
- Furnizimi me material shpenzues, si tonerë, letër A4, certifikata të gjendjes civile me të gjitha llojet, si dhe materiale tjera të nevojshme për kryerjen e punëve.

Lëshimi i certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, certifikata të vendbanimit, certifikata të shtetësisë, vërtetime nga arkiva, procesverbale mbi pranimin e atësisë dhe amësisë, dëshmi për vdekje, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve, regjistrimin e martesave etj.

Të gjithë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duhet të publikohen në ueb-faqen zyrtare, ku qytetari të ketë qasje dhe informata për realizimin e të drejtës së tij.

Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese, ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse Drejtoria e Administratës, gjegjësisht Zyra e Informimit.

2. Zyra e Teknologjisë Informative

Zyra e Teknologjisë Informative është pjesë e Drejtorisë së Administratës dhe i përgjigjet drejtorit të Administratës për planifikimet dhe punët që kryhen në këtë zyrë, dhe ka vetëm një punëtor dhe kërkohet që të shtohet numri i stafit në këtë zyrë.

- Planifikimi për blerjen e kompjuterëve sipas nevojës për Administratën e Komunës,
- Avancimi i pajisjeve të IT-së me Serverë,
- Instalimi i kamerave në objektet e ZGJC-ve në Komunën e Klinës,
- Avancimi i serverëve për ruajtjen e shënimeve BackUp për Server,
- Trajnime profesionale për fushën e IT-së,
- Mirëmbajtjen e rrjetit të brendshëm të Komunës,
- Mbështetja e stafit të Komunës në përdorimin e Teknologjisë Informative,
- Menaxhimi i llogarive zyrtare për përdoruesit e tyre.

3. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit e themeluar në bazë të LPP dhe Organogramit të Komunës, punën e vet e kryen bazuar në LPP 04/L-042, i ndryshuar dhe amandamentuar me ligjet 04/L237, atë Nr.05/L-68 dhe 05/L-092, si Udhëzuesit dhe Rregullores për prokurim publik, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe ligjeve që kanë të bëjnë me çështje administrative dhe bazuar në Planin e punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2024.

Prokurimi transparent, në këtë kuadër parashikohen:

- Njoftimi për kontratë,
- Njoftim për dhënien e kontratës,
- Njoftim për konkurs të projektimit,
- Njoftim për anulim,
- Njoftim për vazhdimin e afatit,
- Njoftim për nënshkrimin e kontratës,
- Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit,
- Njoftimet nga fusha e prokurimit bëhen publike në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

4. Zyra e Personelit

- Të digjitalizohen në HRMIS të gjitha dosjet e të punësuarve në Komunë,
- Zbatimi i Ligjit për zyrtarë publik dhe rregulloreve përkatëse,
- Shpallja e konkurseve,
- Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve,
- Njoftimi për anulimin e konkursit,
- Rishpallja apo vazhdimi i konkursit,
- Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të zyrtarëve publik është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre, Zyra e Informimit,
- Publikimi i të gjitha procedurave për përzgjedhjen e zyrtarëve publik publikohen në ueb- faqe zyrtare të komunës, në tabelat e objektit të Komunës, në media lokale të shkruara dhe atyre elektronike. Publikimi duhet të jetë edhe te institucionet përgjegjëse për zyrtar publik,
- Zbatimi i planit të personelit i aprovuar nga DMZP- ja,
- Përgjigje në të gjitha shkresat që vijnë nga KPMSHC,
- Përgatit dhe mbikëqyrë zbatimin e planit të trajnimeve për zyrtarët komunal.

5. Zyra pritëse dhe Arkiva Komunale

Duke u mbështetur në Ligjin mbi Administratën e Përgjithshme, në Ligjin mbi Afarizmin Zyrtar, në Ligjin mbi Lëndën Arkivore, si dhe në Rregulloret mbi Ligjin e Shërbimeve Publike, ky sektor ka për qëllim të regjistrimit të të gjitha akteve, shkresave, vendimeve, lejeve të ndërtimit, çka do të thotë i gjithë materiali, regjistrat unik që prodhon KK-Klinë për vitin 2024.

6. Shërbimi për Punë të Kuvendit

Hapat konkretë që Kuvendi i Komunës së Klinës do të ndërmarrë në funksion të përmbushjes së Planit të punës dhe rekomandimeve të Ekzekutivit të Komunës, përfshijnë objektivat si në vijim:

Objekti i parë i përcaktuar në këtë plan ka të bëjë me mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve tjera.

Në këtë kuadër parashikohet:

- Njoftim për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve përmes ueb-faqes zyrtare, medie lokale, të shkruara dhe elektronike, rrjeteve sociale, mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes me agjendë të punës.
- Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe Zyrës për komunikim me qytetarë, së paku 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes.

6.1. Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

- Njoftim për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës përmes ueb-faqes zyrtare, medie lokale, të shkruara/elektronike, rrjeteve sociale mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes me agjendë.
- Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe zyrës për komunikim me qytetarë.

6.2. Konsultimi me publikun, ku parashikohet të ketë:

1. Konsultime për buxhet,
2. Konsultime dhe zgjedhja e kryetarëve të fshatrave,
3. Konsultime për Planin/strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal,
4. Konsultime për planifikim hapësinor,
5. Konsultime për investime,
6. Konsultimi për të hyra komunale, dhe

7. Konsultimi për çështje tjera në interes të përgjithshëm.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit dhe Zyra për komunikim me qytetarë, së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqe zyrtare të komunës, në medie lokale të shkruara dhe elektronike, në rrjete sociale si dhe në vendet e frekuentuara në qytet dhe fshatra.

6.3. Takimet me publikun, ku parashikohet:

Komuna do të mbajë së paku dy takime me publikun për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilat takime mund të marrë pjesë secili qytetar apo organizatë me interes në Komunë.

Përveç këtyre dy takimeve me qytetarë, Komuna mund të mbajë edhe takime tjera me publikun që do të shqyrtohen objektivat e parapara të këtij Plan-veprimi.

Aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i Kryetarit së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në ueb-faqen zyrtare të komunës, në media, vende të frekuentuara si dhe në rrjete sociale (FB) etj.

7. Zyra e Informimit

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, në kuadër të Komunës së Klinës, për vitin 2024 planifikon t'i mbulojë të gjitha aktivitetet që zhvillohen në Komunë dhe ka marrëdhënie të mira me publikun. Zyra ka siguruar informim të vazhdueshëm për të gjithë qytetarët e Komunës dhe më gjerë.

Takimet dhe intervistat e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ, dhe gazetarë

- Takime në formë debati me qytetarë,
- Takime pyetje dhe përgjigje,
- Intervista, konferenca për media,
- Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në zyrën e tij të ketë takime me qytetarë,
- Aktivitetet bëhen të ditura nga shefi i Kabinetit të Kryetarit dy javë para, përmes Zyrës për komunikim të Kryetarit të Komunës.

E drejta e qasjes në dokumente publike

- Kërkesa për qasje në dokumente publike, trajtohet nga secili organ i Komunës që posedon dokumentin e kërkuar duke mbikëqyrur informatën;
- Organi komunal ndihmon kërkuuesin për qasje në dokument publik aq sa është e mundshme për të identifikuar dokumentin e kërkuar dhe trajtimi bëhet në mënyrë të barabartë;
- Aktiviteti i njoftimit bëhet nga zyrtari i caktuar nga Organi brenda (7) ditësh dhe mund të vazhdohet deri në 15 ditë;

- Njësia/zyrtari për komunikim me qytetarë bën pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave dhe i adreson në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-2015 për Qasje në Dokumente Publike te kërkuesi.

Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativat qytetare dhe petitionet

- Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe petitionet do të trajtohen drejtpërdrejt apo përmes kërkesave me shkrim;
- Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe petitionet do të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej 60 ditësh;
- Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit.

Publikimi i akteve komunale

- Të gjitha Rregulloret, Vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilit nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja;
- Të gjitha këto akte nënligjore dhe dokumentet tjera publikohen në ueb-faqen zyrtare të Komunës, në vendet e frekuentuara brenda Komunës brenda 15 ditësh pas regjistrimit në MAPL, ndërsa dokumentet tjera pas hyrjes në fuqi;
- Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit.

Freskimi i faqes zyrtare të Komunës

- Mirëmbajtja e ueb-faqes zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ **Nr.01/2015**;
- Përgjegjësia për mirëmbajtjen e ueb-faqes së Komunës është e Zyrës për Informim dhe Zyrës së IT-së.

8. Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit

Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit e Komunës së Klinës, gjatë vitit 2024 planifikon kryerjen e obligimeve që rrjedhin nga detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës si dhe drejtorive komunale, sipas kërkesave dhe nevojave të tyre si dhe shërbimeve tjera përkatëse, duke përfshirë hartimin e akteve të kryetarit, si dhe akteve tjera sipas kërkesave të Kuvendit të Komunës, drejtorive dhe shërbimeve tjera përkatëse.

Do të merr pjesë dhe përcjell seancat e Kuvendit të Komunës përgjatë gjithë vitit, takimet publike, dëgjimet publike si dhe aktivitetet tjera organizative brenda institucionit.

Po ashtu, Zyra Ligjore dhe e Përfaqësimit sipas autorizimeve të kryetarit të komunës do të përfaqësojë Komunën e Klinës pranë Gjykatave kompetente në lëndët që Komuna e Klinës paraqitet si palë paditëse apo e paditur.

Po ashtu, lëndët në intranet do të procedohen sipas vendosjes së tyre duke përfshirë lëndët e Zyrës Ligjore si dhe lëndët e Zyrës së Kryetarit.

9. Shërbimi teknik

- Sigurimin fizik të objektit të Administratës së Komunës 24/7;
- Ardhja në punë, dalja në pushim si dhe kthimi nga pushimi i punëtorëve në kohë të caktuar;
- Kujdeset për hyrjen dhe daljen e personave dhe qytetarëve në objektin e Komunës;
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhrat të drejtorit.

10. Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Qëllimi i këtij plani për vitin 2024 është të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë, të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet, të përcaktojë përgjegjësitë në nivelin komunal, për të hartuar dhe zbatuar politika që garantojnë barazinë e plotë në mes të grave e burrave.

Objektivat strategjike

Qëllimet kryesore të secilës fushë: Edukimi, Shëndetësia, Ekonomi Punësimi, Të drejtat e grave - dhuna në familje dhe Vendimmarrja janë zbërthyer me objektivat specifike me të cilat realisht pritet arritja e barazisë gjinore. Për secilin objektiv janë planifikuar aktivitete përkatëse, duke i përcaktuar bartësit për ndërmarrjen e këtyre aktiviteteve, afate kohore, treguesit e aktiviteteve, burimet financiare si dhe është përcaktuar buxheti nevojshëm për implementimin e aktiviteteve.

Arsimi

- Sigurimi i qasjes së grave dhe vajzave në arsim cilësor,
- Rritja e numrit të vajzave që vazhdojnë shkollimin fillor dhe të mesëm,
- Rritja e shkollimit të vajzave të komuniteti Rom, Ashkali, për 50% më shumë krahasuar me çdo vit paraprak,
- Krijimi i kushteve në bazë të standardeve për shkollimin e vajzave me nevoja të veçanta .

Punësimi

- Fuqizimi ekonomik dhe rritja e punësimit të grave,
- Rritja e numrit të grave të punësuar,
- Rritja e numrit të grave në inicimin dhe udhëheqjen e bizneseve të vogla,
- Promovimi dhe zhvillimi i bizneseve të vogla të udhëhequra nga gratë.

Shëndetësia

- Përmirësimi i shëndetit të grave dhe vajzave dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore preventive,
- Ngritja e vetëdijes së grave, vajzave, për vizita të rregullta shëndetësore, preventive dhe vizita tjera,
- Ngritja e vetëdijes së grave dhe vajzave për rrezikun e kancerit të gjirit, mitrës,
- Përmirësimi i shëndetit reprodaktiv për gratë dhe vajzat e reja,
- Sigurimi i një aparati mamografik me infrastrukturë përcjellëse për komunën e Klinës.

Te drejtat e grave dhe dhuna në familje

- Promovimi i të drejtave të barabarta të grave dhe dhuna në familje,
- Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit kundër dhunës në familje,
- Ngritja e vetëdijes për dhunë në familje,
- Mbështetja e infrastrukturës për mbrojtjen dhe integrimin e viktimave të dhunës.

E drejta e trashëgimisë

- Krijimi i mekanizmave mbështetës në zbatimin e Ligjit mbi trashëgimin,
- Nxitja dhe vetëdijesimi i grave, vajzave, mbi të drejtën e trashëgimisë,
- Promovimi i të drejtave të barabarta në mes të vajzave, djemve, grave dhe burrave.

Vendimmarrja

- Zbatimi dhe monitorimi i Ligjit mbi Barazinë Gjinore,
- Nxitja e grave për pjesëmarrje në vendimmarrje.

11. Zyra e Përkthimeve

- Është përgjegjëse për punët në lëmin e përkthimeve nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas;

- Bën përkthime të drejtpërdrejta, përkthime me shkrim për të gjitha organet e Administratës Komunale, Kuvendit, Trupat e Kuvendit, Komisioneve etj;
- Bën përkthimin e të gjitha materialeve të cilat i pranon përmes internetit;
- Mban evidencën e të gjitha shkresave të përkthyer;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të Kryetarit të Komunës apo drejtorit të cilit i përgjigjet.

12. Zyra e Lekturimeve

- Kryen dhe është përgjegjëse për lekturimin e procesverbaleve dhe të materialit tjetër të Kuvendit Komunal;
- Kryen lekturimin e të gjitha procesverbaleve tjera të të gjitha organeve Komunale, Komiteteve, si dhe Komisioneve Komunale;
- Kryen lekturimin e të gjitha akteve normative, vendimeve, aktvendimeve, kontratave, proceseve administrative dhe gjithë dokumentacionin tjetër zyrtar të Komunës apo edhe drejtorit të cilit i përgjigjet.

13. Zyra e Pranimi të Mallit

- Pranimi dhe regjistrimi i mallrave të furnizuara;
- Komunikimi me të gjitha drejtoritë Komunale;
- Koordinimi i kërkesave mes drejtorive dhe Zyrës së Prokurimit;
- Implementimi i procedurave administrative në shpërndarjen e mallrave;
- Mbajtja e librave në rregull mbi mallin e pranuar;
- Përcjell kërkesat nga drejtori në Zyrën e Prokurimit;
- Mban evidencën për të hyrat dhe daljet nga depoja e administratës;
- Evidenton me tiketa sipas artikullit;
- Shpërndan materialin për nevoja zyrtare;
- Mban libra të veçanta sipas drejtorive për shpenzimet e krijuara;
- Përgjigjet për hyrjet dhe daljet e tërë mallit në depo;
- Kryen të gjitha fotokopjimet për nevoja zyrtare të Komunës;
- Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrit të drejtorit të cilit edhe i përgjigjet.

Si kërkesa elementare do të ishin këto:

- Pajisja me inventarë të nevojshëm për Drejtorinë e Administratës,
- Avancimi i pajisjeve të rrjetit Sëitcha-ve,
- Trajnime profesionale për fushën e IT-së,
- Digjitalizimi i lëndëve arkivore,
- Zhvillimi i softuerit për menaxhim të autoparkut,
- Mirëmbajtja dhe avancimi i sistemit të menaxhimit të radhës,
- Furnizimi me kompjuterë dhe laptopë sipas nevojës.

Kostoja e mjeteve financiare për investimet kapitale janë si në vijim:

1. Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve komunale me kosto financiare 30.000,00 € (tridhjetëmijë euro) ;
2. Blerja e veturave Zyrtare me kosto financiare 35.000,00 € (tridhjetepesëmijë euro);
3. Digjitalizimi i lëndës arkivore, nga mallra dhe shërbime;
4. Zyra për barazi gjinore, 5.000,00€ (pesëmijë euro).

2. DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Klinë organizimin dhe funksionimin e mbështet në kriteret e përgjithshme të cilat janë në ligjin e arsimit fillor dhe të mesëm si dhe në rregullore përkatëse të Komunës.

Drejtoria Komunale e Arsimit në bazë të Ligjit për arsimin parauniversitar nr.04/L-032, Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/l-040 dhe Ligjit për edukim parashkollor nr.02/l-52 si dhe Ligjit për arsim dhe aftësim profesional AAP nr.04/L-032 ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj lidhur me organizimin e arsimit për fëmijët dhe të rriturit në çdo institucion arsimor; nxit mundësitë, barazinë dhe gjithëpërfshirjen për të ndjekur edukimin parafillor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në komunë; organizon dhe nxit bashkëpunimin në mes të mësimitdhënësve, prindërve, nxënësve si dhe në mes të institucioneve arsimore dhe familjeve; bashkëpunon ngushtë me MASHTI-n për çështje të ndryshme të arsimit komunal ku kërkohet bashkëveprim, bashkërendim dhe përgjegjësi e të dyja palëve; respekton dhe nxit të drejtat e komuniteteve dhe përgjegjësitë që ka DKA-ja.

VIZIONI

Edukim dhe arsimim bashkëkohor me efikasitet të lartë, menaxhim që synon të nxënit gjatë gjithë jetës dhe partneritet të përhershëm me komunitetin.

MISIONI

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë vitit 2024 do të sigurojë arsim dhe edukim cilësor të qëndrueshëm me përdorim të formave të mësimit gjatë gjithë jetës, i cili do të jetë i pranueshëm për të gjitha moshat e nxënësve, në mënyrë që nxënësi të pajiset me shkathtësi të mjaftueshme intelektuale dhe praktike në përparimin shkencor, teknologjik, social e ekonomik.

Qëllimet e përgjithshme:

1. Sigurimi i hapësirës së nevojshme shkollore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar (0,1, 2 dhe 3);
2. Ngritja e cilësisë në mësimdhënie e nxënie;
3. Arsimimi, edukimi i të gjitha grupmoshave sipas planeve të miratuara nga MASHT-i;
4. Krijimi i kushteve për përfshirjen e fëmijëve të moshës parashkollore;
5. Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta;
6. Hapja e profileve të reja në shkollat profesionale sipas kërkesave të tregut;
7. Përfshirja e prindërve dhe komunitetit në vendimmarrje;
8. Rregullimi i ambienteve të jashtme dhe të brendshme të institucioneve edukativo-arsimore.

Nr.	Objektivat	Aktivitetet	Periudha kohore	Kostot financiare	Institucionet përfshira - përgjegjësia	Vërejtjet
1	Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies/nxënies në shkolla	Inspektimi i shkollave për gjysmëvjetorin e dytë	Janar 2024		DKA - shkollat	
		Analiza e gjendjes rreth orëve të pambajtura në gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2023/24	Janar 2024		DKA - shkollat	
		Vizita sistematike në shkolla-takime menaxheriale, me stafin arsimor dhe teknik	Janar-dhjetor 2024		DKA - shkollat	
		Trajnim i organizuar nga DKA për KKK-KB (Korniza Kurrikulare dhe Kurrikula Bërthamë)	Janar-shkurt - mars 2024		DKA-shkollat	
		Funksionalizimi dhe fuqizimi i organeve shkollore sipas udhëzimeve administrative	Janar - shkurt 2024		DKA - shkollat	

2	Qeverisje, udhëheqje dhe menaxhim cilësor në të gjitha institucionet edukative – arsimore të Komunës	Organizimi i trajnimeve në nivel komune dhe me bazë në shkollë	Janar - shkurt 2024		DKA - shkollat	
		Monitorimi dhe fuqizimi i mekanizmave për sigurimin e cilësisë në nivel shkolle dhe komune	Janar - shkurt 2024		DKA - shkollat	
		Takim me stafin teknik të shkollave	Janar - shkurt 2024		DKA - shkollat	
		17 Shkurti -Dita e Pavarësisë - organizime të përbashkëta kulturore e artistike	2024		DKA - shkollat	
		Dita e Tokës - mbjellja e luleve, mbrojtja e ambientit shkollor	2024		DKA - KK-shkollat	
3	Ndërtimi i vazhdueshëm i kapacitetit për mësimdhëni e cilësore	Takim me ekipin komunal - vlerësimi pedagogjik i fëmijëve me nevoja të veçanta (sipas UA 16/2017)	Shkurt 2024		DKA - shkollat	
		Takim me koordinatorët e cilësisë dhe	Shkurt-mars 2024		DKA - shkollat	

	drejtorët e shkollave				
	Analizë e suksesit të të gjitha niveleve – takim me drejtorë dhe koordinatorë të cilësisë	Qershor 2024		DKA-shkollat	
	31 Maji -Dita Botërore Kundër Duhanit	Maj 2024		DKA - QKMF-shkollat-OJQ	
	5 Tetori- Dita Ndërkombëtare e Mësuesit	Tetor 2024		DKA-shkollat-OJQ	
	Takim pune me drejtorë të shkollave rreth investimeve kapitale	Janar - shkurt 2024		DKA - shkollat	
	Funksionalizimi dhe fuqizimi i KDSH-së	2024		DKA-shkollat	
	Ndarja e 80 bursave për studentë për vitin akademik 2023/24	Viti shkollor 2023/24		DKA	
	E-ditari, e- shkolla	2024		DKA - shkollat	
	Përfshirja e gjithë fëmijëve të moshës parashkollore në	Gusht-dhjetor 2024		DKA-shkollat	

	institucionet arsimore				
Mjedisi shkollor i përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve mësimore dhe jashtë-mësimore-krijimi i kushteve optimale në shkolla	Instalimi i kamerave të sigurisë në shkollat që kanë mungesë (sipas nevojës)	Janar-qershor 2024		DKA - shkollat	
	Ndërtimi i sistemit të nxehjeve qendrore me pompa termike në shkollat “Fehmi Agani”, “Motrat Qiriazi” dhe “Ismet Rraci”	2024	120.000	DKA - shkollat	
	Renovimi i objektit shkollor- gjimnazit “Luigj Gurakuqi”	2024	30.000	DKA - shkollat	
	Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme 2023/24	Shtator 2023 - qershor 2024		DKA	
	Instalimi i rrjetit të internetit dhe EËFI në shkollat që kanë nevojë	Janar-qershor 2024		DKA-shkollat	
	Ndërtimi i fushave sportive në shkollat “Motrat Qiriazi” dhe “Emin Duraku” në Sferkë	2024	30.000	DKA-shkollat	

4	Furnizim me artikuj nëpër shkolla sipas kërkesave	Furnizim me material zyrtar dhe higjienik në shkolla	Shtator 2023-qershor 2024		DKA – shkollat
		Furnizimi i shkollave me veshje adekuate për 1 Qershorin	Maj 2024		DKA- shkollat
		Furnizimi i nxënësve me fletore dhe lapsa- (klasat 1-9)	Gusht-dhjetor 2024		
		Furnizimi me inventar për digjitalizim, tabela të mençura në shkollat “Luigj Gurakuqi” dhe “Fehmi Agani”	2024	30.000	DKA- shkollat
		Furnizim me artikuj higjienikë nëpër shkolla sipas kërkesave	2024		DKA- shkollat.
		Sigurimi dhe montimi i xhamave të thyera-sipas nevojës dhe kërkesave të shkollës	Shtator 2024		DKA - shkollat
		Pajisja dhe kontrollimi i aparateve kundër zjarrit	Janar - mars 2024		DKA - shkollat

		Hartimi i projekteve sipas kërkesave të shkollave	Janar-qershor 2024		DKA - shkollat
		Furnizim me ngjyrë për lyerje të objekteve shkollore	2024		DKA - shkollat
		Furnizim me gjeneratorë, sipas kërkesave dhe nevojës.	2024		DKA - shkollat
		Furnizim me inventarë për shkolla -raste specifike	2024		DKA - shkollat
		Furnizim me perde	2024		DKA - shkollat
		Furnizim me makina për kositjen e barit dhe makina për pastrimin e oborrit	Shkurt-qershor 2024		DKA - shkollat
5	Ndërlidhja më e mirë e arsimit profesional me tregun e punës	Ndërtimi i lidhjeve me komunitetin e biznesit për kryerjen e praktikës profesionale	2024		DKA - shkollat

	Regjistrimi i nxënësve në kasën e dhjetë	2024		DKA - shkollat
	EPRBM -Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Shkollë - (themelimi, funksionalizimi , trajnimi, mbështetja)	2024		DKA - shkollat
	Regjistrimi i të dhënave statistikore në fillim të vitit shkollor	2024		DKA - shkollat
	Përgatitja e kontratave, marrëveshjeve, shkresave të ndryshme juridike nga fushëveprimtaria e Drejtorisë së Arsimit	2024		DKA - shkollat
	Analizë për suksesin e nxënësve (gjysmëvjetori i parë, gjysmëvjetori i dytë dhe sukcesi në fund të vitit shkollor)	2024		DKA - shkollat
	Caktimi i koordinatorëve - koordinimi i planeve me biznese -shkolla teknike	2024		DKA - shkollat

3. DREJTORIA PËR KADASTËR, GJEODEZI DHE PRONËSI

Drejtorja për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës, pavarësisht sfidave në vitet paraprake, edhe gjatë vitit 2024 planifikon t'i zgjidhë problemet

me të cilat ballafaqohet sipas Udhëzimeve Administrative në fuqi të përcaktuara nga Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës, duke u bazuar konkretisht në Ligjin mbi Kadastër 2003/2025 i aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Klinës, përbëhet nga katër sektorë të ndryshëm që ofrojnë shërbimet e nevojshme për qytetarë, siç janë:

- **Zyrtarët për pranimin e qytetarëve të cilët ofrojnë këto shërbime:**

- *Lëshimi i certifikatës për pronë;*
- *Lëshimi i certifikatës që nuk posedon pronë;*
- *Lëshimi i certifikatës për social.*

- **Zyrtarët gjeodetë që ofrojnë këto shërbime:**

- *Bën sigurimin e hartave Orto – foto, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, dhe ofron shërbime përmes modelit të sistemit informativ mbi tokën dhe pronën ;*
- *Bën lëshimin e kopjeve të planit; Bën matjet për nevoja komunale dhe me kërkesë të Gjykatës, Prokurorisë dhe Policisë, bën përpunimin e të dhënave si dhe llogaritjen e koordinatave të matjeve, kontrollimin e tyre me kushtet e bazave gjeodezike;*
- *Harton raporte, historiate dhe ekspertiza të pronave sipas kërkesave zyrtare;*
- *Kryen azhurimin pas kërkesës së pranuar nga gjeodetët e licencuar për ndarjen e parcelave, bashkimin e parcelave, regjistrimin e ndërtesës dhe regjistrimin e pjesëve të ndërtesës.*

Zyrtari për shërbim pronësoro-juridik që ofron këto shërbime:

- Kryen të gjitha punët juridike dhe administrative në shërbimin pronësoro- juridik, si p.sh., Përgatitja e shkresave profesionale për punët zyrtare kadastrale dhe pronësore;*
- *Harton regjistrin e uzurpimeve të pronës komunale dhe mbron pronën komunale nga uzurpimet e ndryshme;*
- *Kryen të gjitha procedurat administrative lidhur me shpronësimet dhe veprimet tjera procedurale sipas kërkesave të subjekteve tjera apo edhe Komunës sipas Ligjit për Shpronësimet.*

Zyrtaret përgjegjëse për regjistrim në Regjistrin e të Drejtave të Pronave të paluajtshme që kryejnë këto shërbime:

- Kryen bartjen e pronësisë në bazë të dokumenteve valide ligjore dhe të verifikuara, si: Nga noteri, gjykata dhe vendimet tjera të organeve administrative;
- Nxjerrë aktvendimet mbi regjistrimin e ndarjes, bashkimit të parcelave;
- Kryen regjistrimin e paluajtshmerive, hipotekave, barrëve tatimore dhe nxjerr aktvendimet për to;
- Nxjerr aktvendimet mbi legalizimin e objekteve, lokaleve, shtëpive në Geoportal pas azhurimit të gjeodetit.

Pra, në kuadër të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, përveç punëve të cilat planifikohen të realizohen, ofrohen edhe shërbimet e lartshënuara.

Ndër objektivat kryesore që planifikohen të realizohen në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, gjatë vitit 2024 janë:

1. Informimin me kohë i qytetarëve dhe personave përgjegjës të kompanive të licencuara gjeodezike për miratimin apo refuzimin e kërkesës së tyre për marrjen e shërbimeve të nevojshme dhe kryerjen e lëndëve sipas afateve ligjore të përcaktuara sipas legjislacioneve në fuqi. Çdo qytetar dhe personat përgjegjës të kompanive të licencuara gjeodezike do të informohen me kohë në formë të shkruar, si nga zyrtarët e sportelit për pranimin e palëve, ashtu edhe nga zyrtarët gjeodetë, zyrtarët për regjistrimin e pronave në RDPP, dhe nga zyrtari për shërbimin pronësoro - juridik për lëndën e tyre se a është përfunduar, a është në proces apo është refuzuar.
 - Në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, do të bëhet kryerja e të gjitha lëndëve brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës, si për legalizim, historiate, ndarje - bashkim të parcelave, caktim të kufijve të parcelave, kontratave të noterit, barrëve tatimore, urdhëresave të gjykatës, prokurorisë etj.
2. Zgjidhja e problemit të disa zonave kadastrale komunale të cilat nuk janë të regjistruara në Geoportal.
 - Numër i madh i qytetarëve ankohen si shkak i mungesës së regjistrimit të parcelave të tyre në sistemin Geoportal. Prandaj, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, në bashkëpunim të vazhdueshëm me Agjencionin Kadastral të Kosovës, do të jetë në shërbim të qytetarëve duke trajtuar në përpikëri ankesat e tyre rreth

kësaj çështje dhe ofrimin e shërbimeve më efikase për zgjidhjen e këtij problemi të trashëguar, si nga zyrtarët përgjegjës, ashtu edhe me ndihmën e kompanive të licencuara gjeodezike.

3. Përgatitja dhe publikimi i listës së veçantë dhe të përgjithshme të pronave të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024 në bazë të legjislacioneve në fuqi.

- Sipas kërkesës së Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Komunitat janë të obliguara që ta publikojnë listën e përgjithshme të pronave dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024.
- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, ka përgatitur këto dy lista në bazë të të dhënave zyrtare që i posedon kjo Drejtori e të cilat janë publikuar në ueb-faqen e Komunës së Klinës, dhe të gjitha procedurat për dhënien e pronës Komonale në shfrytëzim do të udhëhiqen sipas legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi, si: *Ligji Nr 06/l-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme.*
- Po ashtu, në këtë listë do të përfshihen edhe pronat të cilat parashihen të këmbehen me persona fizik me arsyetimin e zhvillimit të planit urbanistik.

4. Mbështetja e Drejtorive të tjera brenda Komunës së Klinës për ofrimin e shërbimeve.

- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, do të jetë vazhdimisht në dispozicion të ofrimit të shërbimeve të nevojshme me kërkesë zyrtare edhe për drejtoritë e tjera të cilat funksionojnë në Komunën e Klinës në rastet e kontesteve të ndryshme, si për matjet e nevojshme në terren, ashtu edhe në ofrimin e shërbimeve të tjera, siç janë: Përgatitja e koordinatave, certifikata të pronësisë, kopje të planit, Orto – foto të parcelave etj.

5. Udhëheqja e procedurave për shpronësim të pronës shtetërore, për nevoja komunale nga zyra për shërbim pronëso-ro-juridik.

- Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, përmes sektorit të zyrës për shërbimin pronëso-ro-juridik do të udhëheqë procedurat e nevojshme për shpronësim të pronave komunale në bashkëpunim me Zyrën Ligjore Komonale, konform legjislacioneve dhe rregulloreve në fuqi të cilat janë të përcaktuara nga Ministria e

Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

7. Mbajtja tabelare e raportit financiar të pagesave mujore të realizuara nga gjeodetët, zyrtarja përgjegjëse dhe zyrtarët në sportel.

- Pas çdo muaji nga drejtori përkatës i Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, do të kërkohet raporti financiar prej gjeodetëve, zyrtares përgjegjëse dhe zyrtarëve në sportel dhe ato pagesa do të kompletohen në formë tabelare gjatë tërë vitit. Gjithashtu, gjeodetët pas çdo muaji do të obligohen se barazimin e tyre ta bëjnë me zyrtarët përgjegjës në Drejtorinë e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

8. Trajnimi i gjeodetëve dhe juristit në Agjencionin Kadastral të Kosovës për punët gjeodezike, ndërsa juristi do të trajnohet për përpunimin e aktvendimeve për Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme.

- Gjeodetët dhe juristët vazhdimisht do të dërgohen në trajnime profesionale të cilat organizohen gjatë tërë vitit në Agjencionin Kadastral të Kosovës.
- Gjeodetët në theks të veçantë do të mbajnë trajnime për ndarjen – bashkimin e parcelave, për caktimin e kufijve të parcelave, për legalizimin e objekteve në Geoportal dhe punëve të tjera gjeodezike.
- Ndërsa juristët në trajnimet të cilat organizohen nga Agjencioni Kadastral i Kosovës, do të trajnohen në programin për ndarjet në RDPP dhe lëshimin e aktvendimeve për kontratat e noterit, lëndët e gjykatave, lëndët e gjeodetëve, hipotekat, barrët tatimore, urdhëresat e prokurorisë, gjykatës etj.

9. Rregullimi dhe klasifikimi i dokumentacionit kadastral të arkivës sipas zonave.

- Do të bëhet rregullimi i arkivës komunale të dokumentacioneve që i posedon Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, ku do të bëhet klasifikimi i veçantë për të gjitha zonat e komunës së Klinës për të cilat posedon të dhëna Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.

10. Konsultimi me Agjencionin Kadastral të Kosovës për digjitalizimin e disa të dhënave të nevojshme për gjeodetët.

- Pas konsultimit me zyrtarët gjeodetë dhe me zyrtarët përgjegjës për RDPP, kanë arritur në përfundim se gjatë vitit 2024 të bëhen këto ndryshime për të lehtësuar punën e këtyre zyrtarëve:

1. Lejimi i korrigjimit të tipologjisë të bashkimit të parcelave;

2. Lejimi i modifikimit të procesit (zona, numri etj.) te rastet kur gjeodeti vet e ka krijuar atë;
3. Përmirësimi i opsionit për shtim të koordinatave te ndërtesat (pikat);
4. Lejimi i ndarjes te parcelat që janë në kufi me zona tjera kadastrale;
5. Mundësi instalimi të aplikacioneve të gjeodezisë në kompjuterët që monitorohen nga AKK;
6. AutoCad, GeoMedia ose programe tjera.

Këto objektiva të lartcekura janë të planifikuara për realizim gjatë vitit 2024 në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, në komunën e Klinës.

4. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, vepron në kuadër të Komunës së Klinës me gjithsej 6 sektorë që kryejnë funksione dhe shërbime të ndryshme për qytetarët. Më poshtë shpaloset plani i punës nga kjo drejtori për vitin 2024.

- ARKIVI HISTORIK I KLINËS



Sipas Ligjit të ri për arkivat Nr. 08/L-111 ndryshon edhe organizimi i punëve në arkivat komunale të cilët tani kanë rolin e fondkrijuesit. Me Ligjin e ri, Arkivit Historik të Klinës i pamundësohet marrja e lëndës më të vjetër se 30 vite, pasi ajo duhet të dorëzohet në Arkivin Ndërkomunal në Pejë. Arkivi Historik i Klinës do të fokusohet në rregullimin dhe sistemimin e lëndës së administratës komunale që nuk e ka kaluar afatin më të vjetër se 30 vjet. Do të bëhet vazhdimi i punës në rregullimin e lëndës arkivore, përgatitja e përmbajtjes së fondit, dosjeve, faqosja, vendosja e saj në kutia arkivore dhe regjistrimi në kompjuter. Është planifikuar rregullimi dhe sistematizimi i lëndës arkivore nga këto fonde:

Emri i fondit	Vitet	Sasia në metra	Rregulluar / Parregulluar	Afati i rregullimit
Kuvendi Komunal i Klinës	1945-2005	5 metra	Parregulluar	2024
Sekretariati i Punëve të Brendshme - dega në Klinë	1970-1998	15 metra	Parregulluar	2024-2026

- Puna me palë: shqyrtimi i kërkesave, vulosja dhe vërtetimi i kopjeve, lëshimi i dëshmimeve dhe dokumenteve të ndryshme arkivore për qytetarët dhe hulumtues të fushave të ndryshme.
- Trajnimi profesional i stafit të ri arkivor në lëmin e arkivistikës, sigurimi i transportit për një periudhë një javore në Arkivin Ndërkomunal të Pejës dhe në ASHAK, Prishtinë.
- Digjitalizimi i lëndës arkivore është me prioritet, sidomos lënda e cila rrezikohet si rezultat i dëmtimit të pësuar nga faktori kohë. Prioritet paraqet digjitalizimi i librave të amzës. Për digjitalizim arkivi përmes DKRS-së, parasheh iniciimin e procedurave për sigurimin e aparaturës profesionale për digjitalizim.
- Për ruajtjen e lëndës arkivore, arkivi me përkrahjen e DKRS-së ka filluar procedurat për investime në inventarizim, ndërrimin e rafteve aktuale që janë jashtë standardeve për ruajtjen e lëndës arkivore, zëvendësimin e tyre me rafte modulare sipas standardeve arkivore që mundësojnë jetëgjatësinë e lëndës. Realizimi i këtij investimi është paraparë të kryhet në disa faza brenda periudhës tri vjeçare.

- BIBLIOTEKA E QYTETIT “KONGRESI I MANASTIRIT” - KLINË

Biblioteka Publike “Kongresi i Manastirit” në Klinë, planifikon për vitin 2024 të thellojë dhe zgjerojë veprimtarinë bibliotekare në shërbim të nevojave të qytetarëve e të gjitha kategorive të përdoruesve të

librit në bibliotekë. Planifikim për furnizim me libra, materialin e shtypur dhe elektronik si dhe materialin tjetër bibliotekar. Planifikimi i punës së Bibliotekës “Kongresi i Manastirit” në Klinë përqendrohet në:

- Digjitalizimin e Bibliotekës (fondit librar), shfrytëzimin e mundësive buxhetore nga ana e Komunës dhe kontakteve me Bibliotekën Kombëtare për marrjen e programit të digjitalizimit.
- Trajnimin e stafit rreth programit dhe punës për digjitalizimin e bibliotekës.
- Mbajtja e evidencës dhe regjistrimi i lexuesve.
- Përmirësimi i fondit librar në bazë të kërkesave dhe nevojave të lexuesve.
- Përpunimi i librit, evidentimi dhe regjistrimi i fondit të ri.
- Rritja e numrit të lexuesve.
- Spastrimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e koleksionit të librit dhe gjërave të tjera me vlerë, si punë në vazhdimësi në bibliotekë.
- Bashkëpunimi me BKU dhe me biblioteka të tjera publike në vend.
- Mbajtja e orëve letrare dhe aktiviteteve të tjera.

• QENDRA E KULTURËS “JEHONA E DUKAGJINIT”

Spektori i kulturës në kuadër të DKRS-së, vepron kryesisht me organizimin e aktiviteteve dhe promovimin e artit e të kulturës në përgjithësi, shënimin e datave me rëndësi të veçantë historike e kulturore dhe mbajtjen e programit të rregullt vjetor të manifestimeve. Sipas programit tonë, më poshtë renditen aktivitetet e përvitshme, por nuk përjashtohen edhe bashkëpunimet e vazhdueshme në interes të promovimit të kulturës me OJQ, institucione e individë.

- Organizimi i aktiviteteve kulturore-artistike për 17 Shkurt - Dita e Pavarësisë së Kosovës.
- Përgatitje për shfaqje, dramë, monodramë, komedi, realizimi i provave në skenë dhe inskenimi i saj.
- Ekspozita artistike si bashkëpunime komunale me artistë vendor dhe të tjerë.
- 4 Prilli – Aktivitete përkujtimore në nderim të të pagjeturve të luftës.
- Kurs për pikturë dhe vizatim.
- Kremtimi i ditës së teatrit “Osman R. Gashi” - 21 maj.
- Promovime librash dhe aktivitete të tjera letrare.
- Organizimi i festivalit folklorik “ I këndojmë lirisë” - 06, 07 dhe 08 Qershor.
- Kremtimi i Ditës së Çlirimit të Klinës - 18 qershor.
- Camping Fest - në bashkëpunim me ArtEko (koloni artistike, ekspozitë, program muzikor, promovim i trashëgimisë kulturore, gastronomisë, etj).
- Manifestim i Ditëve të Diasporës.

- Manifestimi letrar tradicional “Ora e Tahir Deskut”.
- Shënimi i ditës së Qendrës së Kulturës “Jehona e Dukagjinit” - 31 tetor.
- Java e kulturës: (ekspozitë, film, shfaqje teatrale, muzikë klasike, letërsi).
- Kremtimi i ditës së flamurit kombëtar - 28 Nëntor.
- Manifestimi i ekspozitës tradicionale artistike “Art Klina”.

• SEKTORI I TRASHËGIMISË KULTURORE

Zyra e trashëgimisë kulturore gjatë vitit 2023 është fokusuar në inventarizime dhe evidentime të reja të objekteve që i takojnë Trashëgimisë Kulturore, Natyrore e Shpirtërore dhe si rezultat ka arritur që përmes dosjeve të plotësuara t’i përfshijë disa nga objektet në Listën e mbrojtjes së përkohshme nga MKRS – viti 2024. Ndaj, ky fenomen do të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm, meqenëse si qytet kemi mjaft pasuri kulturore. Gjithashtu, fokus do të jetë edhe kërkesa e vazhdueshme për bashkëpunime për mundësi të restaurimeve dhe renovimeve të këtyre objekteve. Puna do të vazhdojë në afirmimin dhe promovimin e aseteve kulturore edhe përmes aktiviteteve të ndryshme, si dhe në bashkëpunim me CDF si përfitues në programin IPA gjatë vitit 2024 do të fillohet edhe me formimin e shtigjeve tematike, shenjzimin dhe rregullimin e hapësirave që lehtësojnë vizitën dhe promovimin e trashëgimisë. Synim i yni mbetet edhe krijimi i Draft-Strategjisë Komunale për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Disa nga aktivitetet e planifikuara janë:

- Bashkëpunim të vazhdueshëm me MKRS, Institutin Arkeologjik të Kosovës, Muzeun e Kosovës, QRTK-në, KKTK-në, etj.
- Vazhdimi i punës në terren për inventarizimin e objekteve të paluajtshme dhe të luajtshme.
- Shënimi i 18 prillit - Dita ndërkombëtare e monumenteve dhe lokaliteteve të trashëgimisë.
- Shënimi i 18 majit - Dita ndërkombëtare e muzeut.
- Vizitë objekteve të trashëgimisë kulturore në regjion me mundësi bashkërendimi të aktiviteteve promovuese.
- Në marrëveshje me MKRS pritet të vazhdojnë gërmimet në lokalitetin arkeologjik të Dresnikut .
- Zyra e trashëgimisë do të vazhdojë t’i përgatis lëndët dhe t’i propozojë QRTK-së objekte të reja për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Kulturore në mbrojtje të përkohshme.

• SEKTORI I RINISË

Parasheh mbajtjen e aktiviteteve rinore në interes të fuqizimit rinor dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me të rinj.

- Fushata vetëdijesuese në Shkollat fillore dhe ato të mesme, realizuar në bashkëpunim me DKRS, QKMF, Stacionin Policor, KFOR e organizata të tjera, me qëllim - mbrojtje nga rrezikshmëri të ndryshme shëndetësore e ligjore.
- Riaktivizimi i Këshillit të KVRL-së në bashkëpunim me MKRS-në duke u përqendruar në përmbajtjen e Strategjisë Shtetërore për Rini.
- Vazhdimi i mirëmbajtjes së data-bazës së punës vullnetare.
- Java e Rinisë (aktivitete të shumta në promovim sa më të mirë të rinisë, gjatë kësaj jave kryesisht organizohet program i pasur me trajnime, fushata vetëdijesuese, aktivitete kulturore, letrare e artistike, vizita të ndryshme, gara, etj).
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me OSBE-në dhe USAID-in sipas marrëveshjeve komunale.
- Krijimi i Draft-Planit Lokal i Veprimit për Rini 2024 – 2029.
- Bashkëpunime me OJQ-të, Qendrën Rinore “Ardhmëria” dhe grupe të tjera rinore.

- [SEKTORI I SPORTIT](#)

Zyra e sportit në kuadër të DKRS-së vepron me plan pune si në vijim:

- Mbështetja e vazhdueshme e klubeve sportive përmes thirrjes publike.
- Aktivitete dhe gara sportive për nder të datave të rëndësishme historike.
- Afirmimi dhe promovimi i klubeve dhe shkollave sportive.
- Përgatitje intensive dhe mbështetje e klubeve për pjesëmarrje në kampionatin e Kosovës.
- Regjistrime, leje për klube të reja dhe klube të riaktivizuara.
- Organizimi dhe mbajtja e manifestimit tradicional “Sportisti/ja e vitit” dhe shpallja e sportistëve më të mirë nga klubet – bashkëpunim me klubet sportive.
- Investime në hapësirat sportive për ofrimin e kushteve sa më të mira për zhvillime në sport etj.

5. DREJTORIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

[Drejtorja e Bujqësisë për vitin 2024 planifikon t’i zhvillojë aktivitetet si në vijim:](#)

-Shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve të cilat paraqiten pranë kësaj

Drejtorie,

- Planifikimi i mbjelljeve pranverore,
- Planifikimi i mbjelljeve vjeshtore,
- Informimi i fermerëve për subvencione dhe grande që jepen nga Ministria e Bujqësisë-AZHB.

Aplikimi i fermerëve për subvencione:

- Kulturat lavërtare,
- Kulturat pemëtare,
- Kulturat perimtare.

Blegtori:

- Lopë qumështore, dele qumështore, dhi qumështore, bletari,
- Aplikimi për sasi të qumështit dhe majmëri që mbështeten nga Ministria e Bujqësisë.

Drejtoria e Bujqësisë për vitin 2024 ka planifikuar financimin e këtyre projekteve:

- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Budisalc,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Dollovë,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Jagodë,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Radulloç,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Pjetërq,
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Grabanicë dhe të tjera,
- Rregullimi i rrugëve fushore dhe projekte të tjera.

Nga subvencionet do t'i mbështesë fermerët në:

- Ndërtimi i serrave,
- Pajisja e fermerëve me mekanizëm bujqësor,
- Mbjellëse gruri,
- Mbjellëse misri,
- Shpërndarëse të plehut mineral,
- Freza,
- Motokultivator,
- Spërkatëse.

Spektori i ujitjes:

- Mirëmbajtja e pendëve,
- Kanaleve të ujitjes,
- Mbrojtja e tokës bujqësore nga erozioni sipas nevojës.

Këshillimet me fermerë:

- Vizitë fermerëve në ferma:
- Blegtorale,
- Perimtari (serra dhe në fushë të hapur),
- Plantacione pemëtare,
- Lavërtari (drithërat) dhe dhënia e këshillave,
- Shpërndarja e broshurave fermerëve nga lëmi i bujqësisë,
- Inspektimi i mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore,
- Vizitë punkteve për grumbullimin e qumështit,
- Bashkëpunimi me shoqatat, grupet e fermerëve dhe fermerët,
- Monitorimi i fushatës së korrje-shirjeve,
- Organizimi i trajnimeve dhe dhënia e këshillave për fermerë nga lëmenjtë e bujqësisë në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimit Këshillimor në nivel të Ministrisë së Bujqësisë,

-Organizimi i panairove bujqësore.

6.DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Drejtoria për Punë Inspektuese (DPI), e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Tregut, Inspektoratit Komunal (Shërbimeve Komunale), Inspektoratit të Ndërtimtarisë, Inspektoratit të Komunikacionit dhe Trafikut si dhe Inspektoratit të Mjedisit dhe Bujqësisë, në planin e punës për vitin 2024 planifikon që përmes inspektorëve kompetentë në përgjegjësinë e saj, të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme konform ligjeve dhe rregulloreve komunale në fuqi për mbrojtjen e subjekteve afariste (deri në atë shkallë sa nuk cenohet interesi publik), duke e luftuar konkurrencën e pandershme në tregun e brendshëm, duke siguruar se produktet

ushqimore dhe jo ushqimore të plasura në treg janë të sigurta dhe në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe standardet ndërkombëtare, mbrojtjen e konsumatorëve, mbikëqyrjen e prodhimit, përpunimit, ruajtjes, transportit, bartjes së ushqimit, pajisjeve, veglave të punës dhe zbatimin e masave për pengimin dhe eliminimin e sëmundjeve ngjitëse, marrjes së masave mbrojtëse të shëndetit të popullatës nga veprimi i dëmshëm i produkteve të duhanit, inspektimin e ndërtimeve, instalimeve, renovimeve, zgjerimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, rrënimin e çfarëdo ndërtese apo strukture, evidentimi dhe marrja e masave për parandalimin e ndërtimeve të paligjshme, inspektimin e prodhimeve me origjinë shtazore, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve publike (rrugët, trotualet, sheshet, parqet, tregun e gjelbër etj.), lirimin e hapësirave publike nga pengesat e ndryshme, mbikëqyrjen e aktiviteteve që kanë ndikim në mjedis dhe kontrollon aplikimin e standardeve për mbrojtjen e mjedisit. DPI-ja në objektivat e veta për vitin 2024 ka edhe rritjen e besueshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të inspektorëve, trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të qytetarëve në kohë sa më të shpejtë, gjithashtu transparenca do të luaj një rol të rëndësishëm në raport me subjektet, realizimi i të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga objektivat strategjike dhe politike të qeverisjes lokale, ndjekja me korrektësi e të gjitha procedurave ligjore për rastet dhe shkeljet e ndryshme, rritjen e bashkëpunimit efikas me sektorët e tjerë komunal, bashkëpunimi me Policinë, Gjykatën dhe Prokurorinë, si dhe tentimi për bashkëpunim dhe shkëmbime të informacioneve me inspektorët qendror në fushat përkatëse.

Aktiviteti i Inspektorëve të Tregut për vitin 2024

- Inspektime në subjekte afariste me qëllim të verifikimit të Certifikatës së Biznesit;
- Inspektime në subjekte afariste me qëllim të verifikimit të Aktvendimit të DPI-së për plotësim të kushteve H.T.S;
- Mbikëqyrjen e vazhdueshme të aktiviteteve të subjekteve afariste gjatë shitjes së produkteve dhe ofrimit të shërbimeve (reklamimet e produkteve, çmimet, përcaktimin dhe ekspozimin e çmimeve, pagesën dhe dhënien e faturave);
- Inspektimi në lokalet afariste, mjetet transportuese, shitësit ambulant, kontrollimi i dokumentacionit përcjellës, informatat mbi furnizuesin e tyre, dokumentet përcjellëse të produkteve etj.;
- Inspektimi i subjekteve afariste në bashkëpunim me inspektorët e MINT- të cilët merren me qarkullimin e produkteve nga metalet e çmuara (verifikimin e mjeteve matëse ligjore në qarkullim publik etj.);
- Inspektime me qëllim mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe pronësisë industriale në treg sipas kërkesave të qytetarëve;
- Inspektimi me qëllim verifikimin e karakteristikave të produkteve, përmes kontrollimit të dokumenteve (certifikatat e përputhshmërisë së produkteve, deklarimin dhe etiketimin e produktit);
- Inspektim me qëllim të mbikëqyrjes së respektimit të orarit të punës sipas rregullores komunale;
- Inspektimin e subjekteve afariste që merren me veprimtari turistike, hoteliere dhe zejtare;
- Inspektime të tjera në bazë të ankesave të qytetarëve;
- Inspektime të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Inspektori i Tregut i cili gjatë mbikëqyrjes inspektuese konstaton mangësi, është i detyruar të paralajmërojë subjektin e mbikëqyrur që të eliminojë mangësitë, në të kundërtën është i detyruar të merr masat ndëshkuese të përcaktuara me ligj.

Aktiviteti i Inspektorëve të Ndërtimit për vitin 2024

-Inspektimin e dokumentacionit teknik (projektet e ndërtimit, lejet e ndërtimit, inspektimi i lejeve të përdorimit të objekteve);

-Inspektimin e ndërtimeve, instalimeve, renovimeve, zgjerimeve, ndryshimeve, shndërrimeve, si dhe inspektimin e rrënimit të çfarëdo ndërtese apo strukture;

-Inspektimin për plotësimin e kushteve urbanistike-teknike;

-Inspektime në bazë të autorizimit që i jep ligji për legalizimet e ndërtimeve pa leje;

-Inspektimin e kushteve dhe masave të sigurisë, që kanë të bëjnë me sigurimin e objektit dhe objekteve përreth, si dhe masat për sigurinë e komunikacionit përreth këtyre objekteve;

-Marrjen e vendimeve për ndërprerjen (pezullimin) e punimeve, deri në evitimin e parregullsive tekniko- procedurale;

-Inspektime të tjera në bazë të ankesave të qytetarëve ;

-Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Inspektori i Ndërtimit në rast se konstaton se personat fizik ose juridik ndërtojnë, renovojnë, ndryshojnë, shndërrojnë pa leje apo pëlqim përkatës, ndalojnë punimet dhe ndërmarrin masat tjera të përcaktuara me ligjet në fuqi.

Inspektimi në lëmin e Bujqësisë dhe Ambientit

-Inspektime në eksplantimin e resurseve natyrore për mbrojtjen e biodiversitetit, ekosistemeve dhe zonave që janë nën mbrojtje dhe në vendet të caktuara që kanë ndikim në mjedis;

- Kontrollon eksplantimin e rërës, gurit dhe zhavorrit;

- Inspektime në furrat e bukës, për miellin, peshën e bukës, aditivin, vërtetimin që ka kryer D.D.D- në (Deratizim, Dezinfektim, Dezincektim) etj.;

- Bën kontrollimin e barnatoreve bujqësore dhe për të njëjtat lëshon aktvendime për plotësimin e kushteve teknike;

-Inspektime të vazhdueshme në subjekte afariste dhe vende të caktuara të cilat janë burim i zhurmës dhe marrjen e masave adekuate ligjore për parandalimin e tyre;

- Inspektime të tjera në bazë të ankesave të qytetarëve;

- Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

- Sektori i Mjedisit është i obliguar të mbikëqyr aktivitetet të cilat mund të dëmtojnë mjedisin, të ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara ligjore për ruajtjen e tij.

Aktiviteti i Inspektorëve të Shërbimeve Publike për vitin 2024

-Inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike nga dëmtimet, kyçje ilegale, dëmtimin e rrugëve dhe veprimet tjera ilegale;

-Inspektimin dhe largimin e pengesave tjera (panove, reklamave të ndryshme etj.) nga sipërfaqet publike të cilat nuk janë të pajisura me pëlqim nga organet kompetente;

-Inspektime lidhur me pajisjen me kontrata për Dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komonale (hapësirave publike para lokaleve - tarracave etj.);

- Inspektime lidhur me mirëmbajtjen e qytetit, fshirjen dhe larjen e rrugëve;
- Inspektime lidhur me vendosjen e shportave dhe kontejnerëve publik;
- Inspektime lidhur me mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, (pastrimin nga bora);
- Inspektimin dhe largimin e shitësve ambulantë dhe pengesave tjera;
- Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, tregut të gjelbër, terreneve sportive dhe sipërfaqeve tjera publike;
- Inspektime të tjera në bazë të ankesave të qytetarëve;
- Inspektime të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Inspektorët Komunal janë të obliguar që me vetiniciativë të Inspektojnë hapësirat publike dhe të ndërmarrin masa konform rregulloreve Komunale.

Inspektimi në lëmin e Komunikacionit dhe Trafikut

- Inspektori i Trafikut kontrollon dokumentacionin e shoferëve, automjeteve, transportimin e mallrave dhe kushtet e transportit, licencat për transportin e udhëtarëve (taxi);
- Identifikon të gjitha mungesat e shenjave të komunikacionit në tërë territorin e Komunës së Klinës;
- Kontrollon vendndalimet e autobusëve, nisjen e rregullt dhe kushtet e tjera të parapara me ligj dhe rregullore mbi transportin e mallrave dhe shërbimeve;
- Bashkëpunon me policinë dhe inspektorët e tjerë në kryerjen e punëve të trafikut:
 - * Matja e peshës bartëse gjatë transportit (mallra, udhëtarë);
- Inspektimi i automjeteve transportuese (autobus, vetura) për ndalje në vendin e ndaluar;
- Rregullimi i udhëkryqeve me shenja të trafikut (mungesa);
- Identifikimi i lokacioneve për pajisje me shenja të komunikacionit;
- Inspektime të tjera në bazë të ankesave të qytetarëve;
- Punë të tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Inspektori i Trafikut ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat bazë të sjelljes së pjesëmarrësve dhe subjekteve të tjera në trafikun rrugor.

Ky plan i punës së Drejtorisë për Punë Inspektuese mund të ndryshohet dhe plotësohet në raste kur do të shfaqen nevoja të ligjshme të tjera, si dhe me kërkesën e drejtorit të Drejtorisë për Punë Inspektuese dhe të Kryetarit të Komunës.

7. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

PLANI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2024

<p>-Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës, gjithë fushëveprimtarinë e vet e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, Rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve të Asamblesë Komunale.</p>
--

DREJTORIA	Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, vepron:	Në kuadër të kësaj drejtorie, ushtrohen këto veprimtari:	vërejte
	Shërbimi i Ndërtimit dhe Banimit	<ul style="list-style-type: none"> - Punët aktivitetet ndërtimit banimit, - Legalizimi, - Punët aktivitetet delegohen Drejtorisë, - Certifikata përdorimi, - Pëlqime komunale - Referenca, - Vërtetime, - Mirëmbajtja sistemit adresave. 	

	<p>Zyra për Mbrojtje të Mjedisit</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimi dhe vendimet e kërkesave për leje Mjedisore Komunale, - Identifikimi dhe regjistrimi i depove ilegale së bashku me MMPH-në dhe GIZ-in, - Përgatitja e paramasës dhe parallogarisë për eliminimin e depove ilegale, - Aksioni i pastrimit për largimin e depove ilegale, - Aksioni i pastrimit në pjesën urbane, - Pastrimi i parkut të qytetit – afër lumit, - Mbikëqyrja e fshirjes së rrugëve nga K.R.M “Ambienti “, - Zbatimi i projekteve nga plani komunal për menaxhim të mbeturinave , - Aksioni “Ta pastrojmë Kosovën “, - Aksione vetëdijesimi nëpër shkolla. 	
--	--------------------------------------	---	--

	Planifikimi Urban	<ul style="list-style-type: none"> - Punët aktivitetet Urbanizmit Planifikimit, - Udhëzime për kushte ndërtimore, - Kushtet ndërtimore, - Hartimi, implementimi dhe monitorimi i planeve strategjike në nivel Komune, si: <ul style="list-style-type: none"> - PZHK, - PHRRU, - HZK. 	
	Zyra për Projekte	<ul style="list-style-type: none"> - Punët aktivitetet Urbanizmit Planifikimit, - Hartim të paramasave dhe parallogarive, përgatitje të projekt-propozimeve, raporte teknike, procesverbale, shkresa etj., - Menaxhimi i kontratave, - Mbikëqyrja e ecurisë së punimeve për të gjitha projektet, - Pranime teknike për projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera si dhe bënë inspektime në terren sipas kërkesave të palëve. 	

PLANI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2024

-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Klinës, gjithë fushëveprimtarinë e ve e ushtron në bazë të dispozitave Ligjore, Rregulloreve që janë në fuqi, planeve dhe është ekzekutuese e drejtpërdrejtë e vendimeve të Asamblesë Komunale.

DREJTORIA	Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, veprojnë:	Në kuadër të kësaj drejtorie, ushtrohen këto veprimtari:
	Shërbimi i Ndërtimit dhe Banimit	<ul style="list-style-type: none"> - Punët dhe aktivitetet rreth ndërtimit dhe banimit, - Legalizimi, - Punët dhe aktivitetet që delegohen nga Drejtoria, - Certifikata përdorimi, - Pëlqime komunale, - Referenca, - Vërtetime, - Mirëmbajtja e sistemit të adresave.
	Zyra për Mbrojtje të Mjedisit	<ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimi dhe vendimet e kërkesave për leje Mjedisore Komunale, - Identifikimi dhe regjistrimi i depove ilegale së bashku me MMPH-në dhe GIZ-in, - Përgatitja e paramasës dhe parallogarisë për eliminimin e depove ilegale, - Aksioni i pastrimit për largimin e depove ilegale, - Aksioni i pastrimit në pjesën urbane, - Pastrimi i parkut të qytetit –afër lumit, - Mbikëqyrja e fshirjes së rrugëve nga K.R.M “Ambienti “, - Zbatimi i projekteve nga plani komunal për menaxhim të mbeturinave , - Aksioni “Ta pastrojmë Kosovën “, - Aksione vetëdijesimi nëpër shkolla.
	Planifikimi Urban	<ul style="list-style-type: none"> - Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit –Planifikimit, - Udhëzime për kushte ndërtimore, - Kushtet ndërtimore, - Hartimi, implementimi dhe monitorimi i planeve strategjike në nivel Komune, si: - PZHK, - PHRRU, - HZK.
	Zyra për Projekte	<ul style="list-style-type: none"> - Punët dhe aktivitetet rreth Urbanizmit –Planifikimit, - Hartim të paramasave dhe parallogarive, përgatitje të projekt-propozimeve, raporte teknike, procesverbale, shkresa etj., - Menaxhimi i kontratave, - Mbikëqyrja e ecurisë së punimeve për të gjitha projektet, - Pranime teknike për projektet që janë në kuadër të kësaj drejtorie dhe drejtorive tjera si dhe bënë inspektime në terren sipas kërkesave të palëve.

DREJTORIA	<p>Duke u bazuar në detyrat dhe kërkesat e parashtruara në këtë drejtori, deri në implementimin e tyre, konform ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi të nxjerra nga organet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës, kemi hartuar planin njëvjeçar të punës për vitin kalendarik, janar-dhjetor 2024, si në vijim:</p>
	<ul style="list-style-type: none"> - Implementimi i Hartës Zonale,(revidimi i HZK), - Hartimi dhe Implementimi PZHK, - Shtimi i efikasitetit në organizimin dhe zhvillimin e sektorëve duke filluar nga stafi dhe vazhdimi i shqyrtimit të lëndëve, - Realizimi i planit rreth kompensimit të taksave ndërtimore të cilat na janë ngarkuar nga plani dinamik i drejtorisë, - Ndihmë me këshilla profesionale si dhe menaxhimin adekuat për përdorimin e tokës në pronësi komunale për shfrytëzime të përgjithshme dhe të detajuar, - Ndihma profesionale në planifikim të shfrytëzimit, sanitimit, rrënimit të objekteve që paraqesin rrezik për mjedisin, - Përgatitja e projekt-propozimeve për aplikim te donatorët e ndryshëm, - Përgatitja e detyrave projektuese, - Përgatitja e raporteve të punës, - Përgatitja e kushteve ndërtimore për projektim ndërtim, rindërtim, - Përgatitja e lejeve të ndërtimit, - Përgatitja e lejeve të legalizimit, - Përgatitja e lejeve mjedisore komunale, - Përgatitja e certifikatave te përdorimit, - Pëlqime komunale, - Referenca, - Vërtetime, - Mirëmbajtja e sistemit të adresave, - Menaxhimi dhe mbikëqyrja e kontratave për projektet kapitale, - Me rastin e implementimit të projekteve të ndryshme investive, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje te Mjedisit, jep këshilla profesionale arkitektonike ndërtimore për zgjidhjen e tyre, - Ndihmë profesionale Drejtorisë për Shërbime Publike në lidhje me ambientin dhe projekteve që menaxhohen nga ajo, - Ndihmë profesionale Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi si dhe Drejtorisë për Bujqësi rreth mbikëqyrjes dhe menaxhimit të projekteve kapitale që realizohen në kuadër të këtyre drejtorive, - Zbatimi i të gjitha normave ligjore ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit që janë në përputhje me organizatat e ndryshme botërore në fushën e mjedisit, - Mbrojtja e mjedisit do të jetë pjesë e politikave, planeve zhvillimore e sektorëve të ndryshëm, - Shënimi i datave mjedisore në veçanti, si: <ul style="list-style-type: none"> • “Dita e tokës”- 22 prilli, • “Ta pastrojmë Kosovën”- 24 maji, • “Dita e mjedisit”- 5 qershori. - Sensibilizimi dhe ruajtja e monumenteve natyrore në komunën tonë, - Sensibilizimi dhe ruajtja e mjedisit, - Largimi i depove ilegale.
P	<p>Gjatë vitit kalendarik 2024 planifikojmë t'i realizojmë këto projekte:</p>

DREJTORIA	PROJEKTET	Gjatë vitit kalendarik 2024 planifikojmë t'i realizojmë këto projekte:	
		Të bartura nga viti parapra	<ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i shtratit të lumit Klina, - Ndërtimi i fundërruesit për filtrimin e ujit të pijes në Klinë, - Asfaltimi i rrugëve lokale, Zajm-Deiq, - Ndërtimi i rrugëve dhe inf. nëntokësore në Klinë (sheshi), - Asfaltimi i rrugëve lokale në Caravik, - Asfaltimi i rrugëve lokale në Dollc-Dresnik, - Ndërtimi i rrugëve dhe inf.nëntok. në Jashanicë-Resnik-Jelloc-Pograxhë, - Projekte Zbatuese.

Projekte të reja 2024

- Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës “Ymer Berisha”, “Drini i Bardhë”, “Skender Rexhepi”, “Abedin Rexha”, “Mehmet Haxhaj”, “Haxhi Zeka”
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Caravik-Çabiq,
- Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Nora", (trotuare) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq,
- Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", “Dositej Obradoviq”, “Bekim Fehmiu” dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dresnik-Dollc,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Budisalc-Rudicë dhe urës në Rudicë,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gjurgjevik i Vogël-Klinafc,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllarevë-Rixhevë-Stapanicë-Zabergjë,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Klinë-Shtupel-Kërrnicë,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë-Bokshiq-Dollovë,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gremnik,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pograxhë
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë,
- Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhë-Grabc
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Sferkë-Volljakë-Qupevë,
- Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Qeskovë-Këpuz-Rastok,

		<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc-Leskoc, - Ndërtimi i rrjetit të ujës-jellës në lagjen “Arbëria”, “Tigvesh”, sheshi “Nënë Tereza”, Dollc-Dresnik, Grabanicë, Gremnik, Drenoc, - Bashkëfinancim me donatorë, - Ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes në Klinë, - Ndërtimi i shtratit të lumit “Drini i Bardhë” në Klinë-Volljakë, - Ndërtimi i shtratit të lumit “Lumëbardhi i Pejës” në Drenoc-Grabanicë, - Ndërtimi i shtratit të lumit “Klina”, lagjja “Arbëria”, Burimi i Jarinës-Pograxhë, - Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në Grykën e Jarinës-Pograxhë-Jashanicë, - Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Madh, - Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Përqevë, - Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Zllakuqan-Pataqan-Berkovë, - Ndërtimi i infrastr. nëntok. dhe mbitok. Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan), - Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Pjetërq-Dugajevë-Drenoc.
<p>-Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit do të bëjë edhe punë tjera, si mbikëqyrje të punëve dhe pranime teknike për të gjitha projektet e cekura më lartë, inspektime në terren sipas kërkesave të palëve, paramasa dhe paralogari për rrugë, objekte, rrënim të objekteve, mirëmbajtje të rrugëve, kërkesa, raporte, procesverbale, shkresa, pjesëmarrje në komisione të ndryshme, etj.</p>		

8.DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Fushëveprimtaria:

Bazuar në Ligjin për vetqeverisjen lokale, Ligjin për shëndetësi, Statutin e Komunës së Klinës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet, drejtorja ka këtë fushëveprim:

- ✓ Vlerëson nevojat lokale shëndetësore;
- ✓ Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesin parësor shëndetësor duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga MSh;
- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel të komunës;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën shëndetësore në nivel lokal;
- ✓ Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF-ve, AMF-ve si dhe Qendrës për Punë Sociale;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën shëndetësore;
- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- ✓ Harton propozimet për lirimet nga pagesa për shërbimet ndaj qytetarëve, nëse skemat janë bazuar mbi kriteret e objektivit të hapur ndaj publikut dhe në pajtueshmëri me ligjin në fuqi;
- ✓ Ndërmarrë veprime për të siguruar fonde të mjaftueshme për ngritjen e vazhdueshme profesionale të profesionistëve shëndetësorë nëpërmjet trajnimeve specifike, në harmoni me aktet ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton kujdesit parësor shëndetësor në sektorin publik, nëpërmjet shërbimeve të mjekësisë familjare, dhe përcjellja e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e komunës;
- ✓ Harton strategjitë për kujdesin parësor shëndetësor, bazuar në nevojat e identifikuar në nivel lokal duke u dhënë prioritet masave parandaluese, dhe në respektim të gjendjes shëndetësore, moshës, gjinisë dhe pozitës ekonomiko - sociale të qytetarëve dhe kushteve dhe mundësive në ofrimin e kujdesit shëndetësor; kushteve teknologjike - mjekësore, distancës dhe konfiguracionit gjeografik, si dhe strukturës dhe përbërjes së institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor;
- ✓ Ndërmerr masa parandaluese për zbulimin dhe diagnostikimin e hershëm, mjekimin, shërimin dhe rehabilitimin e sëmundjeve, çrregullimeve dhe lëndimeve, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;

- ✓ Organizon dhe zbaton procesin e imunizimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, si një nga masat themelore të kujdesit ndaj shëndetit publik;
- ✓ Kujdeset për përparimin e shëndetit të fëmijëve, të rinjve dhe grupeve tjera;
- ✓ Promovon shëndetin oral dhe kujdesin themelor stomatologjik si dhe shëndetin mendor, në pajtim me metodat e avancuara;
- ✓ Kujdeset për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik të qytetarëve të komunës, nëpërmjet aktiviteteve parandaluese (por duke mos u kufizuar vetëm në këto), si: promovimit të mënyrës së shëndoshë të jetesës, edukimit shëndetësor, ndërmarrjes së masave të përgjithshme kundër epidemike dhe preventive, si: dezinfektimi hapësinor, deratizimi dhe dezinfektimi, kontrollimi i mjedisit, kontrollimi i shkaktarëve, si dhe parandalimi i sëmundjeve, çrregullimeve, lëndimeve dhe gjendjeve me rëndësi sociale mjekësore;
- ✓ Zhvillon programe për aftësimin profesional të punëtorëve shëndetësorë nëpërmjet “Zhvillimit të vazhdueshëm profesional” (ZHVP), me qëllim të ngritjes së cilësisë së kujdesit shëndetësor;
- ✓ Bashkëpunon me kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor, në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- ✓ Vlerëson nevojat lokale për shërbime sociale;
- ✓ Harton buxhetin, në përputhje me nevojat lokale dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- ✓ Zbaton normat dhe standardet e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore sipas akteve ligjore të miratuara nga niveli qendror;
- ✓ Vendos dhe mbledh bashkëpagesat brenda kornizës së përcaktuar nga ministritë e linjës;
- ✓ Përcakton prioritetet lokale dhe objektivat në bazë të informatave, në përputhje me strategjinë e shërbimeve sociale;
- ✓ Ofron shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit të komunës;
- ✓ Kujdeset për të drejtën për të pasur, zhvilluar dhe përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda territorit të komunës;
- ✓ Bashkëpunon me ministritë e linjes përkatëse për vendosjen dhe zbatimin e politikave sociale, për kategoritë e fëmijëve të rrezikuar dhe të gjitha grupet tjera në nivelin lokal, përmes QPS – së;
- ✓ Ushtron kompetenca dhe përgjegjësi të tjera që dalin nga ligjet e veçanta, Statuti i Komunës, aktet nënligjore dhe të deleguara nga pushteti qendror;
- ✓ Mbledhë dhe analizon informatat në fushën sociale në nivel lokal;
- ✓ Organizon fushata sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe harton marrëveshje bashkëpunimi në fushën sociale;
- ✓ Raporton lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të arriturave komunale në këtë fushë;
- ✓ Përgatitë planet vjetore për zhvillimin dhe përparimin e shërbimeve sociale dhe familjare dhe mbajtjen e shënimeve statistikore;
- ✓ Siguron ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të komunës, sipas standardeve të përcaktuara nga ministritë e linjës;

8.1. QKMF / QMF / AMF - Objektivat kryesore

Objektivat	Veprimet/hapat	Afati kohor	Bashkëpunimi	Rezultatet pritshme	Vështirësitë/sfida	Vërejtje
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve	Rritja e numrit të shërbimeve mjekësore, furnizimi me medikamente për pacientët, shërbimet e patronazhes, etj.	Janar - Dhjetor	QKMF - Komunë - MSh - Donatorë	Përmirësimi dhe rritja e shërbimeve mjekësore për të gjithë qytetarët pa dallim moshe e përkatësie etnike,		
Rritja e imunizimit/ Vaksinimi kundër gripit sezonal dhe vaksinat tjera të parapara nga MSh	Fushata vaksinimi dhe veprime tjera për të rritur shkallën e imunizimit	Janar - Dhjetor	MSh DSHMS QKMF	Rritja e imunizimit		Të organizohen fushata sensibilizuese për vaksinim
Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore: Ndryshimi i sistemit të ngrohjes në objektin e QKMF-vendosja e pompave termike	Krijimi i hapësirave të reja dhe renovimi i hapësirave ekzistuese për përmirësimin e shërbimeve mjekësore	Janar - Mars	DSHMS QKMF Zyra e prokurimit Zyra e projekteve Donatorë	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në të gjitha institucionet shëndetësore.	Buxheti Stafi	
Ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore për përmirësimin e shërbimeve mjekësore	Trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore përmes bashkëpunimit me organizata dhe institucione tjera relevante	Janar - Dhjetor 2024	DSHMS QKMF Donatorë	Përmirësimi i performancës së stafit	Buxheti	
Vazhdimi i bashkëpunimit me donatore ekzistues dhe takimet e reja me donatorët potencial	Prezantimi i objektivave tona parësorë dhe projektet e planifikuara dhe	Në vazhdimësi	DSHMS QKMF	Rritja e gamës së shërbimeve		

	prezantimi para tyre.					
Vazhdimi i projektit “Vizitat sistematike shëndetësore në Shkolla”	Përgatitja e projektit, sigurimi i aspekteve teknike	Shkurt - Nëntor	DSHMS QKMF DKA	Vizita mjekësore, regjistrimi, analiza dhe prezantimi i shëndetit publik të nxënësve.	Buxheti Stafi	
Rritja e gamës së shërbimeve dhe cilësisë në Diagnostikim – Rëntgen dhe Laborator	Rritja e gamës së analizave, menaxhimi me kujdes i reagensëve, digjitalizimi i kabinetet të RTG. Rritja e numrit të analizave laboratorike	Janar – Dhjetor	DSHMS QKMF Donatorë	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe rritja e shërbimeve ndaj pacienteve.	Buxheti	
Furnizim me paisje mjekësore për QKMF dhe AMF Venia ne funksion te Mamografise	Furnizimi me paisje mjekësore ngritë dhe përmirëson shërbimet mjekësore	Janar – Mars	DSHMS QKMF Donatorë	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe AMF	Buxheti	
Programi për kujdesin mjekësor për të moshuarit Programi për kujdesin paliativ dhe pacientëve terminal Kujdesi mjekësor për komunitetet pakicë	Ofrimi i shërbimeve mjekësore në shtëpi për pacientët që nuk mund të kryejnë shërbimet mjekësore në QKMF dhe AMF	Janar - Dhjetor	DSHMS QKMF Donatorë	Përkujdesje shëndetësore për të gjithë qytetarët që kanë nevojë për përkujdesje.	Buxheti	

Programi i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmijët 0-3 vjeç Programi i vizitave në shtëpi synon të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve 0-3 vjeç dhe grave shtatzëna.	Të shtatzënat realizohen dy vizita, tek fëmijët realizohen gjithsej 5 vizita nga lindja deri në moshën 3 vjeçe.	Janar - Dhjetor Targeti për vitin 2024 është 2340 vizita, vizitat duhet të realizohet nga punëtorët shëndetësorë të trajnuar dhe certifikuar nga M.SH.	DSHMS QKMF Donatorë	Përkujdesje shëndetësore për të gjitha nënat dhe fëmijët 0-3 vjeç Gjatë vizitave, profesionistët shëndetësorë këshillojnë dhe ndihmojnë familjet për zhvillim të shëndetshëm; ushqyerje, siguri të fëmijëve, mirëqenie prindërore.		
---	---	---	---------------------------	---	--	--

8.2.QENDRA PËR PUNË SOCIALE NË KLINË

Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Familjare

Objektivat	Veprimet/hapat	Afati kohor	Bashkëpunimi	Rezultatet e pritshme	Vështirësitë/sfidat	Vërejtje
Aplikimi në përpikëri e standardëve minimale të përcaktuara nga MPMS/DPSF	Për çdo ofrim të shërbimeve sociale dhe familjare, te udhëzohemi se si te vepohet nga Standardet Minimale.	Gjate vitit 2024	Drejtori, Udhëheqësja e Shërbimeve dhe zyrtarët e shërbimeve Sociale në QPS	Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare	Hezitimi i bashkëpunimit të kërkuesit të shërbimeve ofruesin e shërbimeve në zbatimin e standardeve minimale	
Përmirësimi i shërbimeve sociale dhe familjare duke i vendosur ato me pranë nevojtarëve.	Të organizohen takime më të shpeshta me komunitetin, shkollat, institucionet shëndetësore, organizatave ofruese të shërbimeve, komunitetit ndërfetar etj, për një informim më të mirë për referimin e personave në nevojë për shërbime sociale në Institucione të duhura që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare.	Takime të tilla do organizohen gjatë tërë vitit 2024	QPS, DKA, Shkolla, QKMF, OJQ, përfaqësues komunitetesh etj	Trajtimi dhe kujdesi për personave/familjeve në nevojë sociale dhe ofrimi i shërbimeve me profesionale	Realizimi i takimeve të rregullta të përfaqësuesve nga Institucionet ndersektoriale Komunale	
Rritja e cilësisë së Shërbimeve Sociale dhe Familjare	Do angazhohemi në avancimin e formave alternative të mbrojtjes për të gjitha grupmoshat. Mbajtja e ligjëratave nëpër shkolla herë pas here, përgatitja e fletushkave në	Gjatë tërë vitit 2024	QPS, DKA, Gjykata, Policia, Shkolla, OJQ, përfaqësues komunitetesh etj	Shërbimet do të jenë më afër atyre që kanë nevojë për shërbime sociale.		

	lidhje më shërbimet që ofron QPS etj.					
Planifikimi buxhetor për QPS-në	Planifikimi për nevojat buxhetore të QPS-së, për vitin 2024, duke u bazuar në kostot e shërbimeve të ofruara, dhe të njëjtin planifikim do e dorëzojmë në kohën e duhur në Institucionet përkatëse për aprovim	Qershor-Dhjetor 2024 (gjatë rishikimit të buxhetit)	QPS, DSHMS, Drejtori e Financave Ekonomisë dhe zhvillimit	Ndarja e një buxheti që plotëson nevojat e QPS-së	Mungesa e një zyrtari financiar në QPS, si dhe mos vullneti i Institucioneve Komunale për një qasje më pozitive në raport me kërkesat e QPS-së, për buxhetim të Institucionit tonë.	
Gjetja dhe trajnimi i familjeve strehuese.	Organizimi i fushatave senzibilizuese duke shfrytëzuar radion lokale, fletushkat informuese etj, në lidhje me rëndësinë e familjeve strehuese, kriteret, përfitimet, trajnimet etj. Në mënyrë që të kemi të gatshme 1-2 familje strehuese.	Janar-Prill 2024	QPS, DSHMS, DPSF, Radio lokale, OJQ, përfaqësues komunitetesh etj.	Përgatitja e familjeve, të gatshme për strehim familjar të fëmijëve pa përkujdesje familjare.	Mosgatishmëria e familjeve që të marrin në strehim fëmijë pa përkujdesje edhe përkundër pagesës që behët nga ana e MPMS-së.	
Rritja e përkushtimit në mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje familjare, fëmijëve me sjellje asociale, rritja e përkushtimit në punën kundër dhunës në familje, sanimin e marrëdhënieve bashkëshortore, strehimin familjarë, kujdestarinë, kontaktin e fëmijëve me prindërit e tyre, do e rrisë kujdesin ndaj personave të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, personat me nevoja të veçanta si dhe do e rrisë angazhimin në parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda të fëmijëve.	Jetësimi në përpikëri i Ligjeve, Udhëzimeve Administrative, Rregulloreve, vendimeve, standardëve minimale të shërbimeve sociale dhe familjare etj. Puna në teren, takimet formale dhe jo formale ndersektoriale më të gjithë faktorët që kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve.	Gjatë tërë vitit 2024	QPS, DSHMS, DPSF, OJQ, Institucione rezidenciale, Strehimore, Shkolla, Polici, Prokurori, Gjykata përfaqësues komunitetesh etj.	Të ofrojmë shërbime sa më profesionale dhe sa më afër njerëzve në nevojë.	Mungesa e kuadrove profesionale, sidomos e psikologut dhe zyrtarit financiar etj.	

8.3.Sektori i Ndihmave Sociale

Objektivat	Veprimet/hapat	Afati kohor	Bashkëpunimi	Rezultatet e pritshme	Vështirësitë/sfidat	Vërejtjet
Përkrahja financiare e familjeve në gjendje të rëndë ekonomike,	Identifikimi në teren dhe përzgjedhja e familjeve nevojtare, dhënia e	Gjatë tërë vitit 2024	QPS, DPSF, përfaqësues komunitetesh , OJQ etj.	Të gjitha familjet në nevojë, që i plotësojnë kriteret e parapara për		

në përputhshmëri më kriteret e parapara ne Ligjin e Skemës për Ndhim Sociale	informacioneve të dhura për aplikim për ndihmë sociale etj			ndihmë sociale, të futën në skemë		
Realizmi i Planit të veprimit	Riverifikimi i familjeve që dyshohet që kanë përmirësuar gjendjen ekonomike	Janar – Prill 2024	QPS-DPSF	Identifikimi dhe largimi nga skema e ndihmave sociale e të gjitha familjeve të cilat kanë përmirësuar gjendjen ekonomike.	Mungesa edhe një veture për verifikim, pasi që, vetura të cilën e posedojmë në shumicën e rasteve është e zënë me raste në shërbime sociale.	
Rishikimi me kujdes të shtuar i të gjitha dosjeve, të familjeve të përfituese të Ndhimave Sociale	Në afatin sa më të shkurtër të mundshëm të rishikohen të gjitha dosjet e përfituesve të NS, në mënyrë që të evidentohen gabimet e mundshme që janë bërë më rastin e pranimi të dokumentacionit.	Janar – Prill 2024	Spektori i Ndhimave Sociale	Te kompletohen të gjitha dosjet më dokumentacionin duhur ashtu siç parashihet me Ligj dhe udhëzime administrative.		
Respektimi i afateve ligjore për procedim me kohë të kërkesave për Ndhim Sociale	Të gjitha kërkesat për Ndhim Sociale, të procedohen me kohë (pranim të kërkesës, verifikim në teren, futje në bazën e të dhënave)	Gjatë tërë vitit 2024	QPS-DPSF	Të procedohen me kohë të gjitha kërkesat për Ndhim Sociale	Problemet e vazhdueshme më bazën e shënimeve gjatë futjes së të dhënave, pastaj koha e shkurtë në dispozicion për futjen e këtyre të dhënave/riaplikim etj.	

9.DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENTE

Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente, gjatë muajve të ardhshëm të vitit 2024 do të angazhohet në bazë të detyrave dhe obligimeve të përshkruara në Statutin e Komunës së Klinës, dhe do të ndërmerri masa dhe aktivitete që kanë për qëllim ngritjen dhe përmirësimin e kapaciteteve dhe performancës së përgjithshme si dhe përmirësimin e shërbimeve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës në tërë territorin e komunës për shfrytëzimin e buxhetit të alokuar për vitin 2024. Posaçërisht do të fokusohemi në disa nga aktivitetet vijuese:

- **Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (parqeve).**

Gjithashtu edhe në këtë vit do të vazhdohet me përmirësimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve ekzistuese, posaçërisht shëtitoretja përgjatë lumit “Klina”, duke vazhduar me trendin e zgjerimit të këtyre hapësirave publike. Do të pastrohen nga mbeturinat e ndryshme, posaçërisht depot ilegale me inerte dhe mbetjet e ndërtim-demolimit. Do të mirëmbahet edhe parku i ri “Ilir Merturi”, në mënyrë që të jetë në shërbim të qytetarëve dhe të mbrohet nga dëmtimet.

Për këtë vit janë planifikuar 100,000€.

- **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit.**

Komuna e Klinës ka lidhur kontratë më 30.11.2022 dhe është kontratë tri vjeçare, të cilën e kemi kontraktuar dhe do ta bëjë dekorimin e qytetit të Klinës për festat e fundvitit. Shuma e ndarë për këtë projekt është 50,000€ dhe ky projekt do të vazhdojë edhe në vitin 2024-2025.

- **Mirëmbajtja e kamerave të qytetit.**

Edhe në vitin 2024 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente në komunën e Klinës, do të iniciojë procedurë një vjeçare për mirëmbajtjen e kamerave, duke furnizuar dhe mirëmbajtur kamerat e qytetit me një kontratë 15,000€.

- **Mirëmbajtja dhe riparimi i ndriçimit publik.**

Komuna e Klinës ka të lidhur kontratën për mirëmbajtjen e ndriçimit publik e cila ishte dy vjeçare dhe vlen deri në korrik të vitit 2024, ku do të vazhdojë me mirëmbajtjen e trupave ndriçuese dhe problemeve tjera përcjellëse që lidhen me ndriçimin publik.

- **Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.**

Komuna e Klinës do të zgjerojë ende rrjetin e saj të ndriçimit publik, duke investuar 100,000€ vlerë të kontratës, ku do të zgjerohen fshatrat dhe një pjesë e qytetit të Klinës.

- **Riparimi dhe rregullimi i gropave të rrugëve me asfalt.**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, do të investojë në kontratën e riparimit edhe rregullimin e gropave dhe rrugëve me asfalt. Ne do të bëjmë intervenimin e gropave ku ka nevojë dhe sipas kërkesave të qytetarëve t’i sanojmë ato me asfalt dhe të bëhet mirëmbajtja e

tyre.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, për vitin 2024 do të investojë 250,000€.

- **Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.**

Nevoja për trajtim të ujërave të zeza është problem madhor në komunën e Klinës, siç është edhe në tërë Kosovën. Komuna e Klinës do të investojë 200,000€ në ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza.

- **Blerja e kamionit me ekskavator për shërbime publike.**

Komuna e Klinës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, ka nevojë për mjete të tilla që t'i kryejë shërbime qytetarëve dhe projekteve të veta. Blerja e këtyre mjeteve ishte paramenduar për vitin 2023, por për shkak të disa telasheve që komuna ishte dëmtuar nga përmbaruesi, e kishte të pamundur që ta blinte në vitin 2023. Andaj, drejtoria ka planifikuar që për vitin 2024 të investojë 50,000€ për posedimin e këtyre pajisjeve.

- **Mirëmbajtja dimërore e rrugëve.**

Duke kuptuar rrezikun e borës dhe pastrimin e rrugëve për arsye të largimit të aksidenteve, komuna e Klinës ka lidhur kontratë tri vjeçare me vlerë 150,000 € që do të shërbejë për pastrimin e rrugëve dhe largimin e borës nga pjesët e rrezikuara. Kontrata është për vitin 2023, 2024 dhe 2025.

- **Trajtimi i qenve endacakë.**

Qentë endacakë janë problem i gjithë Kosovës. Komuna e Klinës është ndër komunat e pakta të Kosovës që kanë lidhur kontratë për trajtimin e qenve endacakë, e cila sadopak do të përmirësojë gjendjen e qenve dhe me rëndësi të qytetarëve. Kontrata ka vlerë 30,000€ dhe është për vitin 2023- 2024.

- **Shpimi i puseve për ujitje të sipërfaqeve të gjelbëruara.**

Drejtoria për vitin 2024 ka planifikuar edhe kontratë për shpimin e puseve për ujitje të hapësirave të gjelbëruara, ku ne mund të kemi qasje më të lehtë për ujitjen e këtyre hapësirave.

- **Mirëmbajtja e drunjve dekorativ në rrugët e qytetit.**

Drejtoria jonë ka iniciuar në vitin 2022 kontratë për mirëmbajtjen e drunjve dekorativ. Kontrata është me vlerë 12,972 € dhe është tri vjeçare që vlen deri në tetor të vitit 2024. Drejtoria jonë, duke shfrytëzuar këtë kontratë bën krasitjen dhe rregullimin e pemëve të dëmtuara duke zëvendësuar ato me të reja. Po ashtu, drejtoria e bën mirëmbajtjen dy herë në vit, edhe atë dimëror dhe veror.

- **Furnizim me zhavorr për riparim të rrugëve lokale dhe fushore për shërbime të tjera për pastrim të kanaleve inerte, të lumenjve në rrugë dhe zona urbane.**

Komuna e Klinës ka lidhur kontratë tri vjeçare me vlerë 299,500 € të cilën do ta shfrytëzojë edhe në vitin 2024. Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, do të bëjë rregullimin dhe shtrimin e rrugëve fushore dhe rrugëve ku ka nevojë me zhavorr, duke u mundësuar qasje banorëve të cilët janë në nevojë. Në vitin 2023 komuna jonë është dëmtuar nga reshjet atmosferike dhe shumë rrugë e hapësira janë bërë të pakaluar, ku ne do të bëjmë ende përmirësimin e rrugëve edhe në vitin 2024.

- **Furnizim me uniforma të zjarrfikësve.**

Drejtorja jonë ka menduar edhe për zjarrfikësit. Pas shumë intervenimeve të ndryshme, ata i dëmtojnë uniformat e tyre dhe ne do t'iu ofrojmë kushte sa më komode që të qëndrojnë në selinë e tyre në raste gatishmërie. Pra, në vitin 2024 do të bëjmë një furnizim me uniforma dhe rroba për zjarrfikësit.

10.DREJTORIA E FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

Në periudhën e planifikimit të punëve dhe detyrave të punës, 01 janar -31 dhjetor 2024, në vendet e punës së Drejtorisë Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, është siç vijon:

10.1. Sektori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim

- Lëshuarja e kontratave të ndryshme që ndërlidhen me taksat komunale, tatimet dhe qiratë sipas urdhrimit të Kryetarit të Komunës dhe drejtorit;
- Lëshuarja e më se 30 aktvendimeve për shfrytëzim të pronës komunale sipas marrëveshjeve paraprake dhe sipas pëlqimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjente dhe komisionit komunal, për periudhën më pak se një vit;
- Lëshuarja e 1 600 aktvendimeve të taksave për ushtrim të veprimtarisë të subjekteve afariste që operojnë në komunën e Klinës për vitin 2024;
- Lëshuarja dhe vendosja e më se 75 ankesave të arritura gjatë vitit 2023 nga personat fizik dhe juridik të tatimit mbi pronën (çdoherë krahasuar me vitin paraprak);
- Lëshuarja dhe vendosja e më se 10 ankesave të arritura gjatë vitit 2023 nga personat fizik dhe juridik të taksave komunale për ushtrim të veprimtarisë;
- Lëshuarja e konkluzioneve të përgjithshme të arritura dhe të preferuara nga eprorët kompetentë në komunë dhe Drejtorinë përkatëse;
- Lëshuarja e më se 125 akteve të përgjithshme administrativo-juridike sipas urdhrimit të Kryetarit të Komunës dhe drejtorit të Drejtorisë;
- Lëshuarja e 350 njoftimeve qytetarëve dhe bizneseve me akte administrative juridike lidhur me neglizhencat e ndryshme të pagesave të taksave komunale dhe qirave të ndryshme sipas lëmenjve përkatës;
- Paraqitja e raporteve mujore, tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore sipas kërkesave të eprorëve kompetentë dhe organeve kompetente;
- Përcjellja e të gjitha akteve ligjore të zbatueshme në Drejtori si dhe ekzekutimi i tyre sipas kompetencave ligjore;
- Angazhimi direkt tek zyrtarët e Drejtorisë në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit komunal të aprovuar nga Kuvendi;
- Organizimi dhe realizimi i dëgjimeve publike për buxhetin e vitit 2025 dhe projeksionet e viteve 2026-2027;
- Dërgimi i vendimeve për përmbardim për obliguesit që nuk i përmbushin obligimet e tatimeve dhe taksave;
- Përcjellja sistematike e disiplinës në punë nga zyrtarët e Drejtorisë përkatëse;
- Si dhe punë tjera sipas urdhrimit të eprorëve kompetentë dhe kohës së paraqitjes së punëve dhe detyrave përkatëse gjatë vitit planifikues.

10.2. Zyra e të Hyrave

- Regjistrimi i të gjitha të hyrave vetanake komunale për periudhën 01 janar -31 dhjetor 2024, sipas transaksioneve të bankës dhe arkës;
- Regjistrimi në akses i të hyrave dhe Free-balance;
- Nxjerrja dhe raportimi i raporteve ditore, mujore dhe vjetore lidhur me gjendjen e të hyrave sipas periudhave të përcaktuara kohore;

- Raportimi lidhur me gjendjen e të hyrave në organet kompetente Komunale dhe në organet qendrore, respektivisht në MEF;
- Barazimin e gjendjes financiare të të hyrave dhe plotësimin e formularëve për alokim të mjeteve komunale;
- Përcjelljen e gjendjes së pagesave të qirave të lokaleve afariste komunale dhe të banesave sociale;
- Nxjerrjen e raporteve mujore lidhur me gjendjen e pagesave të qirave komunale sipas periudhave kohore që obliguesit i kryejnë;
- Gjithsej planifikohen rreth 700 transaksione;
- Si dhe punë tjera sipas urdhrit të eprorit.

10.3. Zyra e Zotimeve

- Zotimi i të gjitha mjeteve buxhetore për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2024 sipas kërkesave të arritura nga zyra e prokurimit;
- Zotimi i të gjitha mjeteve financiare të arritura nga Drejtoritë komunale sipas planifikimit të tyre buxhetor;
- Zotimi i mjeteve në modulin e blerjes, aprovimeve etj;
- Nxjerrja e raporteve ditore, mujore, vjetore, lidhur me gjendjen e zotimeve dhe shpenzimeve përkatëse gjatë periudhave planifikuese;
- Përgatitja e lëndëve për dërgim në zyrën e pagesave;
- Gjithsej planifikohen për kryerje 1 750 lëndë që duhet të përcillen në zyrën e pagesave në Komunë;
- Si dhe punë tjera sipas urdhrit të eprorëve kompetentë.

10.4. Zyra e Regjistrimit të Bizneseve

DETYRAT KRYESORE

1. Hartimi i planit të punës në pajtim me mbikëqyrësin e drejtpërdrejt për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e tyre;
2. Pranon kërkesat për regjistrimin e 150 bizneseve dhe shuarjen e 30 bizneseve, ndryshimin e veprimtarive, 30 biznese për vitin 2024;
3. Shqyrton dhe procedon kërkesat e parashtruara për regjistrim të bizneseve individuale, shoqërive tregtare dhe subjekteve tjera, ose për emrat tregtarë të dorëzuara nga biznesi dhe bën validimin e emrit të biznesit;
4. Bën përpunimin e të dhënave lidhur me regjistrimin e bizneseve dhe emrave tregtarë;
5. Pranon, shqyrton dhe vendos lidhur me pajisjen apo refuzimin e kërkesës së aplikuesit me leje për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike;
6. Regjistron të dhënat në sistemin e para regjistrimit në bazë të tipareve të biznesit;
7. Krijon arkivin elektronik me qëllim të ruajtjes, evidentimit, përmirësimit të mundësive për shfrytëzimin e lëndëve arkivore dhe ruajtjes së të dhënave të njoftimeve të depozituara.;
8. Ju ofron këshilla aplikuesve që parashtrorjnë kërkesa për regjistrimin e bizneseve, si dhe bën regjistrimin e tyre sipas kërkesave të tyre;
9. I raporton udhëheqësit të drejtpërdrejt lidhur me aktivitetin e tij në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore;
10. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi, të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt.

10.5. [Zyra e Tatimit në Pronë](#)

- Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Komunale mbi tatimin në Pronë;
- Regjistrimi në kompjuter i të gjitha ngarkesave tatimore për vitin 2024;
- Dërgimi-shpërndarja e vërejtjeve të fundit për obliguesit tatimor që nuk i kanë përmbushur detyrimet tatimore paraprake dhe të këtij viti;
- Shpërndarja e marrëveshjeve për pagesa;
- Shpërndarja e urdhëresave për bllokim të gjyrollogarive për obliguesit që nuk i kanë kryer obligimet tatimore;
- Kushtëzimin e shërbimeve komunale me lëshuarjen e vërtetimeve që i kanë përmbushur obligimet tatimore;
- Aktiviteti i shpërndarjes së vërejtjeve të fundit bashkë me shpërndarjen e faturave tatimore për vitin 2023-2024 dhe obligimeve paraprake;
- Regjistrimi i pagesave sistematikisht në programin e pagesave të tatimit në pronë sipas pagesave për secilin obligues;
- Aplikimi i llogaritjes së kamatave sipas normave të MEF-it;
- Regjistrimi në kompjuter i ndryshimeve sipas vendimeve të ankesave të vitit 2024;
- Marrja e aksionit në inkasimin e obligimeve tatimore të pakryera nga ana e obliguesve tatimor;
- Si dhe punë tjera të kësaj natyre sipas dispozitave ligjore aplikative dhe sipas nevojës së paraqitjes sipas kohës.

10.6. [Sektori i Thesarit](#)

- Regjistrimi në sistemin e Menaxhimit të Financave Publike (SIMF), urdhër obligim pagesat për të gjithë shfrytëzuesit;
- Kryerja e pagesave sistematikisht për të gjitha Drejtoritë Komunale sipas pagesave të përgatitura nga Drejtoritë.
- [Kontabiliteti](#)
- Regjistrimi sistematikisht i të gjitha pagesave sipas lëmenjve të caktuar në kontabilitet;
- Regjistrimi i bllokave të automjeteve sipas numrit serik;
- Regjistrimi i bllokave të taksave Komunale dhe Administrative sipas Drejtorive;

- Regjistrimin e pagesave të të gjitha llojeve të qirave komunale;
- Regjistrimi i të gjitha pagesave të arritura nga arka komunale dhe zyrat e vendit etj;
- Regjistrimi i të gjitha ngarkesave të përcaktuara për subjektet afariste për taksa komunale-licenca për vitin 2023;
- Regjistrimin e të gjitha ndryshimeve sipas aktvendimeve të lëshuara nga shërbimi i caktimit të taksave komunale.

10.7. [Regjistrimi i Pasurisë Komunale](#)

- Planifikimi i regjistrimit të tërë pasurisë komunale sipas Udhëzimit Administrativ dhe rregullave tjera financiare në fuqi;
- Regjistrimi i pasurisë së paregjistruar sipas urdhër zotim pagesave;
- Zhvlerësimin e pasurisë sipas procesit të komisionit Komunal për vlerësim të pasurisë komunale;
- Regjistrimi dhe zhvlerësimi i tërë pasurisë komunale në Free-balance;
- Mbajtja e regjistrave të pasurisë në vlerë më e ulët se 1000€;
- Mbajtja e regjistrit të pasurisë së imët (inventarit të Komunës) të pranuar nga Komisioni Komunal i regjistrimit të inventarit.

10.8. [Zyra e Pagesave-Arka](#)

- Planifikimi i kryerjes së të gjitha pagesave sipas kohës së paraqitjes në vlerë prej 10 € dhe dorëzimin e këtyre mjeteve në bankë;
- Pagesa e të gjitha taksave administrative dhe taksave tjera për të gjitha organet Komunale dhe zyrën e komuniteteve.

[10.9. Ndryshimet Mujore Për Paga Dhe Mëditje –Ptkash](#)

- Përgatitja e formularëve për ndryshimin e të ardhurave personale;
- Përgatitja e formularëve për pagesën e mëditjeve për këshilltarët Komunal;
- Përgatitja e formularëve për tërheqje të PTKASHIT në zyrën e thesarit;
- Shpërndarja e PTKASHIT sipas drejtorive komunale dhe zyrës së komuniteteve.



DRAFT-PLANI I PUNËS

I KUVENDIT TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN

2024

Pasqyra e planit 2024

<u>Parathënie</u>	
<u>Janar</u>	
<u>Shkurt</u>	
<u>Mars</u>	
<u>Prill</u>	
<u>Maj</u>	
<u>Qershor</u>	
<u>Korrik</u>	
<u>Gusht</u>	
<u>Shtator</u>	

Tetor
Nëntor
Dhjetor

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës; dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësive të saj, përfshirë edhe funksione tjera, detyra dhe përgjegjësi të pa deleguara si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Planit Zhvillimor Urban (PZHU), dhe Planeve Rregulluese Urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre; dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Klinës është dokument i mbështetur në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, Statuti dhe aktet tjera nënligjore.

Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2024, ku Kuvendi i Komunës së Klinës planifikon t'i mbaj 11 seanca të rregullta, 6 prej të cilave në gjashtëmuajorin e parë dhe 5 në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2024, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Klinës, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e Kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit;

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmoj dhe lehtësoj punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2024 e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë 11 seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca tjera përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne siç parashihet me LVL dhe Statutin e Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit e të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës së përcaktuar me këtë program - plan, do të përkujdesen Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i Programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet planit të Kuvendit për vitin 2024.

Plani i punës së Kuvendit sipas dinamikës mujore përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2024 do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

Plani i punë së kuvendit të komunës për vitin 2024

	Rend dite	Harton	Propozon	Shqyrton	Miraton
Janar 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi Raportit vjetor financiar për vitin 2023	Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kryetari i Komunës/kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i raportit të II-të të KKSBSë për vitin 2024	KKSB	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2023	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

Shkurt 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Bartja (rialokim) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i Raportit të punës se Komiteteve	Kryesuesit e Komiteteve	Kryesuesi i Kuvendit	KPF/KK	
	Raport nga Komiteti për Auditim të brendshëm për vitin 2023	Kryesuesi i Komitetit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	

Mars 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror	Drejtorja e Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

Prill 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Raport nga komisionet e formuara nga Kuvendi i Komunës	Komitetet dhe komisionet	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i raportit tre mujor financiar janar - mars 2024	Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

Maj 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informatë mbi Qarkoren 1-rë të MF-së-KAB	Drejtoria për Buxhet	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
Qershor 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2027	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	Kuvendi
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2024	Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Raportim i kryetarit të komunës për situatën ekonomike-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024 -sipas LVL-së	Kryetari i Komunës	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raporti i performancës komunale për vitin 2023	Kordinator për performancë komunale	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të KKS-së për gjashtë mujorin e parë 2024	KKS-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Vazit Pune e Kuvendit në Kroaci	Anëtarët e Kuvendit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Korrik 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informatë për Qarkoren e 2-të buxhetore	Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim	Anëtarët e KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2024	Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit shkollor 2023/2024	Drejtori i DKA-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale lidhur me funksionimin e punës në QKMF	Drejtori i SHMS-le	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	

	Shqyrtimi i Raportit të auditorit të jashtëm dhe plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit	Ekzekutivi	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Klinës	Drejtori i Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi realizimin e planit të punës së Zyres së Prokurimit janar – qershor 2024	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

Gusht 2024					
	PUSHIM I KUVENDIT				
Shtator 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës së Klinës për vitin 2025	Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Informatë rreth shërbimeve komunale ndaj mërgimtarëve për vitin 2024	D. Administratës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë për përgatitjen e vitit shkollor 2024/2025	Drejtori i DKA-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
Tetor 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën janar – shtator 2024	Drejtorja për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

Nëntor	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Diskutimi i raportit të Auditorit të Brendshëm në Kuvendin Komunal dhe Plani i Veprimit	Zyra e Auditorit	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	

	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Klinës	Drejtoria e Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
--	---	--------------------------------	----------------------------	--------	--

Dhjetor 2024	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i Planit të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2025	Zyra e auditorit të brendshëm	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së kuvendit komunal për vitin 2025	Zyra e Kuvendit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Ekzekutivit për vitin 2025	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i Planifikimit të prokurimit publik për vitin 2025	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2025	KKSB	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raportim i kryetarit të komunës për situatën ekonomike-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për vitin 2024 -sipas LVL-së	Kryetari i Komunës	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raportimi i Planit të Integritetit për Komunën e Klinës	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi


KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. _____/2023
Klinë, më _____/2023

Kryesuesi
Fadil Gashi



Për/To/Za :	KRYESUESIT TE KUVENDIT Z. FADIL GASHI
Kopje	Z. ZENUN ELEZAJ
Nga/From/Od	<u>ZYRA E PROKURIMIT Z. Labinot Morina</u>
Tema/Subject/Subjekat	PLANIFIKIMI I PROKURIMIT PER VITIN 2024
Data	06.12.2023



Te nderuar

Te nderuar Bazuar në Nenin 8 te LPP-se është Obligim ligjor për përgaditje te Planifikimit te Prokurimit publik per vitin 2024 dhe te postohet ne Platformen e- prokurimi

Zyra e Prokurimit duke u bazuar ne Buxhetin aktual per vitin 2024 , Kerkesave të njesive kërkuese –Drejtorive kemi kete situat :

Procedura te prokurimit per kategori te Furnzimeve 23 procedura ne vlere te planifikimeve 809.402.00 EURO.

Procedura te prokurimit per kategori te shërbimeve 13 procedura ne vlere te planifikimeve 1.406.364.00 EURO

Procedura te prokurimit per pune 38 procedura ne vlere 3.548.860.00 EURO

Numri i te gjitha procedurave eshte 74.qe ne vlere buxhetore eshte 5.761.626.00 EURO

Per Informaten tuaj Disa Projekte qe jane në buxhet por nuk kane nevoj te behen procedura prokurimi meqenëse kane kontrata dy dhe tri vjeçare .

Dhe nga kategoria e Furnzimeve jane aktuale Kontratat kornize per furnizime te ndryshme qe jane 36 te Auritetit tone kontraktues dhe 14 Unike nga AQP qe jemi te obliguar te i shfrytezojme .

P.S. Shkreses i Bashkangjesim Tabelarin Unik nga sistemi te Planifikimit te Prokurimit Dhe Tabelarin e Kontrave kornize ne shfrytëzim aktual .

Me respekt



PLANIFIKIMI PËRFUNDIMTAR I PROKURIMIT

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr.04/L-042, Ligji mbi Prokurimin Publik

Për vitin Fiskal 2024

Planifikimi përfundimtar i Prokurimit duhet të plotësohet dhe të dërgohet në AQP jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes së legjislationit të përvetësimeve

Data e dërgimit në AQP

E rezervuar për AQP

Planifikim paraprak

03.12.2023

Planifikimi përfundimtar

NENI I. Identifikimi i Autoritetit Kontraktues (AK)

Emri i AK

KUVENDI KOMUNAL I KLINËS

Personi kontaktues

Labinot Morina

Adresa

ABEDIN REXHA

Email-i

Labinot.Morina@rks-gov.net

Qyteti

KLINË

Kodi Postar

Telefoni

Regjioni

Email-i

Faksi

URL

URL

NENI II. Përshkrimi përmbledhës i kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

Rendori i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendori	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përfaqëruar nga Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
63	27521500-8	FURNIZIM ME LETER PER PRINTIM	06.02.2024	1	LETET PER PRINTIM A 4 - 80 GR	RIS	5000.00	3,00	15.000,00

43	02100000-5	Furnizim me dru dhe lende djegese per ngrohje te objekteve	23.05.2024	2	LETET PER PRINTIM A3-80 GR	RIS	50,00	4,50	225,00
				3	LETET SPECIALE GLOS	RIS	10,00	10,00	100,00
				4	LETET SPECIALE MATE	RISA	10,00	10,00	100,00
				5	LETET SHTYPI ME NGJYRA DIMENSIONE TE NDRYSHME	RISA	20,00	15,00	300,00
				6	LETET PER FOTO 120 GR	TABAK	20,00	5,00	100,00
				7	LETET PER TRAJNIME	TABAK	50,00	2,00	100,00
				1	dru per ngrohje	m3	1000,00	70,00	70.000,00
				2	pelet per ngrohje	Ton	200,00	350,00	70.000,00
				3	naft per ngrohje	Litra	8000,00	1,40	11.200,00
				4	anti friz per radiator	Litra	800,00	1,00	800,00
36		Blerje e kamionit me eskavator per sherbime publike	07.02.2024	1	Blerje e kamionit me eskavator per sherbime publike	Cope	1,00	80.000,00	80.000,00
34		Furnizim me Certifikata Originale te Gjendjes Civile	05.01.2024	1	Certifikata origjinale te Gjendjs civile	Cope	40000,00	0,50	20.000,00
33		Furnizim me paisje T.I.	10.01.2024	1	kompjuter lap Top	Cope	15,00	1.000,00	15.000,00
				2	kompjuter des top	Cope	24,00	500,00	12.000,00
				3	PRINTER	COPE	1,00	120,00	120,00
				4	SCANNER A4=A3	COPE	2,00	500,00	1.000,00
				5	FOTOKOPJUS	COPE	10,00	1.000,00	10.000,00
32		FURNIZIM ME PAISJE PER ZERIM	21.02.2024	1	Bas Bina	Cope	2,00	1.000,00	2.000,00
				2	mikset	Cope	1,00	3.000,00	3.000,00
				3	mikrofona ajror	Cope	4,00	200,00	800,00
				4	video projektor me mbajttese	Cope	1,00	1.500,00	1.500,00
31		Sherbime per Festivalin i	04.04.2024	1	AKOMODIM I MUSAFIREVE	PERSONA	134,00	15,00	2.010,00

				NE SHKOLLA				ROLETNEVE TE THJESHTA NE SHKOLLA					
							2	FURNIZIM DHE MONTIM I KLIMAVE	TOTAL	1,00	5.000,00	5.000,00	
							3	FURNIZIM MONTIM DHE MIREMBITJE e kamerave	Total	1,00	10.000,00	10.000,00	
							4	furnizim me ore dore per te pensinuaaret	Total	1,00	1.000,00	1.000,00	
							5	furnizim me libra lektyre shkollore	Total	1,00	5.000,00	5.000,00	
							6	furnizim me mjete konkretizimi	Total	1,00	2.000,00	2.000,00	
							7	PAISJE PER LABORATORE	TOTAL	1,00	7.000,00	7.000,00	
							8	FURNIZIM ME ULESE PUSHOMRE NE SHKOLLA	TOTAL	1,00	5.000,00	5.000,00	
							9	FURNIZIM ME MAKIE PASTRIMI TE DYSHEMEVE	TOTAL	1,00	4.000,00	4.000,00	
							10	FURNIZIM ME E- DITAR	TOTAL	1,00	10.000,00	10.000,00	
							11	FURNIZIM ME VESHMBATHJE SETE PER NXENES ME RASTIN E FESTAVE	TOTAL	1,00	6.000,00	6.000,00	
9				FURNIZIM DHE MBJELLJE E BARIT SINTETIK NE SHKOLLA	29.03.2024		1	FURNIZIM DHE MBJELLJE E BARIT SINTETIK NE SHKOLLA	TOTAL	1,00	20.000,00	20.000,00	20.000,00
							2	NDRIQIMI I FUSHAVE	TOTAL	1,00	10.000,00	10.000,00	
4				FURNIZIME ME UNIFORMA DHE RROBA PUNE	02.05.2024		1	UNIFORMA DHE RROBA PUNE PER ZJARREFIKES	TOTAL	1,00	8.000,00	8.000,00	8.000,00
							2	UNIFORMA PER INSPEKTOR DHE ROJE	TOTAL	1,00	7.000,00	7.000,00	7.000,00
2				FURNIZIM ME MISH DHE PRODUKTE MISHI PER QERDHE	07.03.2024		1	MISH DHE PRODUKTE MISHI TE FRESKET	KG	700,00	9,00	6.300,00	6.300,00
							2	MISH I FRESKET PULE	KG	500,00	5,00	2.500,00	2.500,00
							3	VIRSHLLE - SALLAMA DHE	KG	300,00	4,00	1.200,00	1.200,00

TE NGJASHIME									
Totali i Vlerës									
809.402,00									

II.2) KONTRATAT PËR SHËRBIME

Rendori i prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendor	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
44	93411300-5	Sherbime te veçanta.Ekspert per menaxhimin e kontratave ne projektet infrastrukturore dhe sherbime tjera	02.02.2024	1	Sherbime te veçanta.Ekspert per menaxhimin e kontratave ne projektet infrastrukturore dhe sherbime tjera	persona	6,00	7.200,00	43.200,00
				2	Sherbime te veçanta.Ekspert per menaxhimin e kontratave ne projektet infrastrukturore dhe sherbime tjera	persona	2,00	6.000,00	12.000,00
41	93950000-2	Mirembajtje e mobijeve dhe paisjeve	02.05.2024	1	servisim dhe mirembajtje e aparateve kundrazjarrit	paushall	1,00	3.000,00	3.000,00
				2	servisim dhe mirembajtje e nxemjeve	paushall	1,00	7.400,00	7.400,00
				3	mirembajtje e paisjeve tjera	paushall	1,00	4.400,00	4.400,00
42	93411300-5	sherbime pastrimi dhe mirembajtje te objekteve	07.02.2024	1	mirembajtje hixhenike e objekteve te shkollave	paushall	1,00	50.400,00	50.400,00
				2	mirembajtje hixhenike e objekteve shtepise se kultures dhe palestres se sporteve	paushall	1,00	25.520,00	25.520,00
				3	mirembajtje hixhenike e objekteve shendetesore	paushall	1,00	50.000,00	50.000,00
40	93411300-5	Mirembajtje dhe riparime	16.02.2024	1	Mirembajtja e drunjeve dekorativ	total	1,00	5.000,00	5.000,00
				2	Zgjerimi i siperfaqeve gjelbruese dhe parqeve	total	1,00	100.000,00	100.000,00
				3	hapje e puseve ne siperfaqet e gjelbruara	total	1,00	10.000,00	10.000,00

39	93411300-5	Zgjerimi i rrjetit te ndriqimit publik	15.02.2024	1	Zgjerimi i rrjetit te ndriqimit publik	total	1,00	100.000,00	100.000,00
38		Sanimi i rrugëve -Gropave dhe detimeve	01.02.2024	1	sanimi i gropave dhe riparimet ne rrugët me asfalt	total	1,00	250.000,00	250.000,00
37		Mirembajtje dhe riparime te rrjetit te kanalizimeve dhe trajtim i ujrave te zeza	09.02.2024	1	Ndertim i impiantit te ujrave te zeza	total	1,00	300.000,00	300.000,00
35		Mirembajtja e rrjetit te kamerave ne qytet	22.02.2024	1	Mirembajtje e rretit te kanalizimeve	total	1,00	50.000,00	50.000,00
23		Lyerje dhe renovime ne shkolla	17.05.2024	1	Lyerje dhe renovime te vogla ne shkolla	total	1,00	90.000,00	90.000,00
10		SHERBIME TRANSPORTI I NXENESEVE NE SHKOLLA DHE PJESEMARRJE NE GARA	06.02.2024	1	SHERBIME TRANSPORT I NXENESEVE SHKOLL SHTUPI DHE PJESEMARRJE NE GARA	TOTAL	1,00	50.000,00	50.000,00
8		SHERBIME INTERNETI NE SHKOLLA DHE TRAJNIME PROFESJONALE PER ARSIMTAR	12.03.2024	1	SHERBIME INTERNETI NE SHKOLLA	TOTAL	1,00	2.000,00	2.000,00
7		SHENJEZIM HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGEVE	05.03.2024	1	SHENJEZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGEVE	TOTAL	1,00	30.000,00	30.000,00
5		RRENIM I OBJEKTEVE TE VJETRA DHE NDERTIMEVE PA LEJE	28.02.2024	1	RRENIM I OBJEKTEVE TE VJETRA DHE NDERTIMEVE PA LEJE	TOTAL	1,00	15.000,00	15.000,00
6		MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE	15.08.2024	1	MIREMBAJTJA DIMERORE E RRUGEVE	TOTAL	1,00	150.000,00	150.000,00
3		PROJEKTE PER TRASHEGIMI KULTURORE	15.03.2024	1	DOKUMENTI STRATEGJIA PER ZHVILLIMIN E TRASHEGIMIA KULTURORE NE K.KLINE	TOTAL	1,00	10.000,00	10.000,00

				2	RESTAURIMI I OBJEKTEVE TE TRASHHEGIMIS KULTURORE	TOTAL	1,00	20.000,00	20.000,00
Totali i Vlerës									
1.406.364,00									

II.3) KONTRATAT PËR PUNË

Rendori prokurimeve	Klasifikimi i produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Data e parashikuar e fillimit të prokurimit	Nr. Rendori	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e përafërt Vjetore	Çmimi për Njësi	Vlera e parashikuar e kontratës
1	45000000-7	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Potery-Dugajeve-Drenovc	22.03.2024	1	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Potery-Dugajeve-Drenovc	TOTAL	1,00	100.000,00	100.000,00
65	45000000-7	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Potery-Dugajeve-Drenovc	07.03.2024	1	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore Krusheve e Vogel(trotuari Kline-Zllakuqan)	TOTAL	1,00	45.000,00	45.000,00
66	45000000-7	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Zllakuqan-Pataqan-Berkove	16.05.2024	1	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Zllakuqan-Pataqan-Berkove	TOTAL	1,00	50.000,00	50.000,00
67	45000000-7	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Perqeve	08.05.2024	1	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Perqeve	TOTAL	1,00	30.000,00	30.000,00
68	45000000-7	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Gjurgjevik te Madhe	14.05.2024	1	Ndertimi i infrastruktures nentokësore dhe mbitokësore ne Gjurgjevik te Madhe	TOTAL	1,00	50.000,00	50.000,00
69	45000000-7	Ndertimi shtigjeve te ecjes dhe infrastruktures rrugore ne Gryken e Jarines-Pograxhe- Jashanice	21.02.2024	1	Ndertimi shtigjeve te ecjes dhe infrastruktures rrugore ne Gryken e Jarines-Pograxhe- Jashanice	TOTAL	1,00	75.000,00	75.000,00
70	45000000-7	Ndertimi i shtratit te lumit Lumebardhi i Pejes ne Drenoc- Grabanic	15.05.2024	1	Ndertimi i shtratit te lumit Lumebardhi i Pejes ne Drenoc- Grabanic	TOTAL	1,00	50.000,00	50.000,00
71	45000000-7	Ndertimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Kline, Vollljak	08.05.2024	1	Ndertimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Kline, Vollljak	TOTAL	1,00	50.000,00	50.000,00
72	45000000-7	Ndertimi i liqenit akumulues per	29.04.2024	1	Ndertimi i liqenit akumulues per	TOTAL	1,00	120.000,00	120.000,00

		furnizim me uje te pijes ne Kline		furnizim me uje te pijes ne Kline				furnizim me uje te pijes ne Kline					
74	45000000-7	Bashkëfinancim me donatorë	29.02.2024	1	Bashkëfinancim me donatorë - ne ifrastrukture rugore	total	1,00	100.000,00	100.000,00				100.000,00
				2	Bashkëfinancim me donatorë- ne ujesjeles	total	1,00	100.000,00	100.000,00				100.000,00
				3	Bashkëfinancim me donatorë- ne kanalizime	total	1,00	50.000,00	50.000,00				50.000,00
				4	Bashkëfinancim me donatorë-Infrastrukture tjeter	total	1,00	66.860,00	66.860,00				66.860,00
73	45000000-7	Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit ne LAgjen Arberia, Tigvesh, te Sheshi Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanice, Gremnik, Drenoc	22.05.2024	1	Ndertimi i rrjetit te ujesjellesit ne LAgjen Arberia, Tigvesh, te Sheshi Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanice, Gremnik, Drenoc	TOTAL	1,00	30.000,00	30.000,00				30.000,00
62	45000000-7	Ndertimi i segmenteve dhe ifrastruktures nentokesore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh, Skender Rexhepi, Abedin Rexha, Mehmet Haxhaj, Haxhi Zeka	01.02.2024	1	Ndertimi i segmenteve dhe ifrastruktures nentokesore të rrugës Ymer Berisha, Drini i Bardh, Skender Rexhepi, Abedin Rexha, Mehmet Haxhaj, Haxhi Zeka	total	1,00	230.000,00	230.000,00				230.000,00
61	45000000-7	Ndertimi i ifrastruktures nentokesore dhe mbitoksore në Cerovik-Qabiq	15.02.2024	1	Ndertimi i ifrastruktures nentokesore dhe mbitoksore në Cerovik-Qabiq	total	1,00	40.000,00	40.000,00				40.000,00
60	45000000-7	Ndertimi i segmenteve të rrugës Nora ,(Trotuare) dhe ifrastruktures nentokesore ne Zajme-Deiq	13.02.2024	1	Ndertimi i segmenteve të rrugës Nora ,(Trotuare) dhe ifrastruktures nentokesore ne Zajme-Deiq	total	1,00	120.000,00	120.000,00				120.000,00
59	45000000-7	Ndertimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota , Prek Prendi , Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe ifrastruktures nentokesore ne Kline-Dersnik-Dollc	22.02.2024	1	Ndertimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota , Prek Prendi , Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe ifrastruktures nentokesore ne Kline-Dersnik-Dollc	total	1,00	270.000,00	270.000,00				270.000,00
58	45000000-7	Ndertimi i ifrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Budisalce-Rudice dhe ures ne Rudice	08.02.2024	1	Ndertimi i ifrastruktures nentokesore dhe mbitoksore ne Budisalce-Rudice dhe ures ne Rudice	total	1,00	50.000,00	50.000,00				50.000,00
57	45000000-7	Ndertimi i ifrastruktures	07.02.2024	1	Ndertimi i ifrastruktures	total	1,00	120.000,00	120.000,00				120.000,00

45	45000000-7	Ndertimi i shtratit te Lumit Klina, Lagjia Arberi, Burimi i Jarines-Pograxhe		1	Ndertimi i shtratit te Lumit Klina, Lagjia Arberi, Burimi i Jarines-Pograxhe	total	1,00	300.000,00	300.000,00
17	93411300-5	Ndertim dhe renovim i objekteve sportive dhe te kultures	05.01.2024	1	Ndertim dhe rinovim i objekteve sportive dhe te kultures	total	1,00	55.000,00	55.000,00
16	45000000-7	Renovime te objekteve shkollore	13.06.2024	1	Renovim i fushave sportive dhe rekreative	total	1,00	20.000,00	20.000,00
				2	Regurimim u hyrjeve dhe oborreve te shkollave me kubeza	total	1,00	10.000,00	10.000,00
				3	Ndertimi i kabines ne hyrje te shkolles Ismet Raci	total	1,00	2.000,00	2.000,00
				4	regulimi i ndriqimit ne hyrje te shkollave	total	1,00	10.000,00	10.000,00
				5	Ndertimi i pjerrinave ne hyrje te shkollave	total	1,00	5.000,00	5.000,00
				6	Ndertimi i kendeve per parafilor ne shkolla	total	1,00	15.000,00	15.000,00
				7	Ndertimi i rrethojave ne Motrat QIRIAZI	TOTAL	1,00	40.000,00	40.000,00
15	45000000-7	Ndertimi i nxemjes qendrore me pompa termike ne Gjirnazin Luigj Gurakuqi he ate Shtjefen gjeqovi	04.06.2024	1	Ndertimi i nxemjes qendrore me pompa termike ne Gjonaz dhe SHMU Ate Shtjefen GJEQOVI	TOTAL	1,00	110.000,00	110.000,00
14	45000000-7	Ndertimi dhe renovime ne QKMF-QMF-AMF vendosje e pompave termike	08.03.2024	1	Ndertimi dhe renovime ne QKMF-QMF-AMF vendosje e pompave termike	total	1,00	100.000,00	100.000,00
13	45000000-7	Ndertimi i shtepise per perkujdesje te personave ne nevoj	01.03.2024	1	Ndertimi i shtepise per perkujdesje te personave ne nevoj	Total	1,00	300.000,00	300.000,00
Totali i Vlerës									3.548.860,00

II.4)KONKURSET E PROJEKTIMIT

Rendor i	Klasifikimi i	Përshkrimi i Kontratës	Data e	Nr.	Artikulli	Njësia matëse	Sasia e	Çmimi për Njësi	Vlera e
----------	---------------	------------------------	--------	-----	-----------	---------------	---------	-----------------	---------



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E KLINËS

**DRAFT STRATEGJIA E
ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL
PËR KOMUNËN E KLINËS
2024-2029**

Dhjetor, 2023



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E KLINËS 2024-2029

Dhjetor, 2023

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë nga ALBO GROUP në partneritet dhe financuar nga Komuna e Klinës

Autoriteti kontraktues: Komuna e Klinës

Hartoi: ALBO GROUP në bashkëpunim me Komunën e Klinës

Albana Berisha Qehaja

Rizah Muçolli

Shpend Sopa



PËRMBAJTJA

Lista e tabelave	IX
Lista e grafikëve	X
Lista e figurave	XI
Lista e shkurtesave.....	XII
<i>Hyrje</i>	13
1. Metodologjia.....	15
2. Analiza e gjendjes socio-ekonomike	17
Historik i shkurtër i komunës	17
Pozita dhe veçoritë gjeografike	18
Popullsia	20
Vendbanimet	24
Migrimi.....	27
Arsimi	28
Shëndetësia	32
Mirëqenia sociale.....	35
Tregu i punës	36
Shërbimet administrative.....	37
Infrastruktura	38
Telekomunikacioni	40
Rrjeti energjetik	42
Ndriçimi publik.....	43
Furnizimi me ujë	44
Kanalizimi	45
Mbeturinat.....	46
Kultura.....	46
Profili ekonomik i komunës së Klinës.....	51
Buxheti komunal	58
3. Analiza SWOT	63

4. Vizioni, qëllimet dhe objektivat për zhvillim ekonomik.....	65
Vizioni, misioni dhe vlerat kyçe	65
Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike	68
Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të strategjisë	72
Ndikimi financiar i zbatimit të strategjisë	80
<i>Shtojca 1 - Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal</i>	<i>83</i>
<i>Shtojca 2 - Struktura organizative e komunës së Klinës</i>	<i>97</i>
<i>Shtojca 3 - Vendbanimet joformale në komunën e Klinës.....</i>	<i>98</i>
<i>Shtojca 4 - Organizimi territorial në komunën e Klinës</i>	<i>99</i>
<i>Shtojca 5 - Zonat e veçanta të mbrojtura në komunën e Klinës</i>	<i>100</i>
<i>Shtojca 6 - Trashëgimia kulturore në komunën e Klinës.....</i>	<i>101</i>
<i>Shtojca 7 - Vendimi për ndalimin e aktiviteteve minerare.....</i>	<i>102</i>

Lista e tabelave

Tabela 1. Popullsia e komunës së Klinës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare	25
Tabela 2. Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Klinës	26
Tabela 3a. Migrimi kombëtar në komunën e Klinës, periudha 2018-2020	26
Tabela 3b. Migrimi ndërkombëtar në komunën e Klinës, periudha 2018-2020	28
Tabela 4. Trendi i sëmundjeve ngjitëse për vitet 2020-2022	35
Tabela 5. Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2020	53
Tabela 6. Burimet e financimit në komunën e Klinës (€), periudha 2023-2025	58
Tabela 7. Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Klinës (€), 2023-2025	59
Tabela 8. Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Klinës (€), vlerësim për periudhën 2023-2025	60

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Popullsia në komunën e Klinës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011.....	20
Grafiku 2. Shtimi natyror në komunën e Klinës, periudha 2018-2020	21
Grafiku 3. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Klinës.....	22
Grafiku 4. Struktura etnike e popullsisë në komunën e Klinës	22
Grafiku 5. Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Klinës.....	23
Grafiku 6. Struktura moshore e popullsisë në komunën e Klinës	23
Grafiku 7. Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Klinës	26
Grafiku 8. Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2011	27
Grafiku 9. Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2018-2021	31
Grafiku 10. Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2020-2021	34
Grafiku 11. Statistikat e tregut të punës, 2020.....	36
Grafiku 12. Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Klinës.....	41
Grafiku 13. Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës në komunën e Klinës.....	51
Grafiku 14. Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Klinës (%), periudha 2022-2024	59
Grafiku 15. Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Klinës (%), vlerësim për periudhën 2022-2024.....	61

Lista e figurave


Figura 1. Struktura e përmbledhur organizative e komunës së Klinës.....	12
Figura 2. Metodologjia e punës.....	15
Figura 3. Pozita gjeografike e komunës së Klinës	19
Figura 4. Komuna e Klinës	24
Figura 5. Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut	48
Figura 6. Ujëvara e Mirushës.....	56
Figura 7. Vlerat kyçe të komunës së Klinës.....	65

Lista e shkurtesave

AMF	Ambulanca të Mjekësisë Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
Ha	Hektarë
KABK	Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale
Km	Kilometër
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjetësimit
Kv	Kilovat
M	Metër
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit – Asociimit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
PSAK	Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë
QKMF	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendër e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SWOT	<i>Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats</i>
SZHEL	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
TM	Tremujor

Struktura organizative e komunës së Klinës

Fig. 1 Struktura e përmbledhur organizative e komunës së Klinës*



- Strukturën e detajuar organizative e gjeni në shtojcën nr. 2.

HYRJE

Zhvillimi ekonomik lokal është një proces përmes të cilit sektori publik, bizneset dhe shoqëria civile punojnë bashkërisht për të krijuar kushte më të mira për rritjen ekonomike dhe gjenerimin e vendeve të lira të punës. Qëllimi i tij është të ndërtojë kapacitetin ekonomik të një zone lokale për të përmirësuar të ardhmen e saj ekonomike dhe cilësinë e jetës për të gjithë. Zhvillimi ekonomik lokal i suksesshëm fokusohet në rritjen e konkurrencës, rritjen e qëndrueshme të zhvillimit dhe të siguruarit që rritja të jetë gjithëpërfshirëse.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal është një dokument që prezanton përcaktimin e synimeve vjetore, buxhetimin dhe proceset e vlerësimit të projekteve. Duke zhvilluar një vizion afatgjatë të komunitetit, strategjia jep një tablo të së ardhmes së dëshiruar të komunës së Klinës. Nismat strategjike për periudhën pesëvjeçare 2024-2029 e përqendrojnë komunën në veprimet dhe investimet që duhet të bëjë tani për të vazhduar mbështetjen e përparimit të komunitetit drejt vizionit të përcaktuar. Ndonëse, komuna e Klinës është aktori kryesor në këtë dokument strategjik, suksesi në këto nisma do të kërkojë mbështetjen e të gjithë komunitetit, si atë të biznesit, pushtetit vendor, shoqërisë civile dhe akterëve tjerë.

Duhet theksuar se komuna e Klinës ka zhvilluar edhe më parë strategji për zhvillim ekonomik lokal. Qëllimet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Klinës për periudhën 2024- 2029 janë përmbledhur në vijim: zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm, zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve, përmirësimi i cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ofrimi i shërbimeve komunale cilësore efikase për qytetarët dhe bizneset, ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit jetësor.

Ky dokument strategjik është hartuar bazuar në udhëzuesin “Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023”, përgatitur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Qeverisja lokale, e cila tani po kalon në vetëqeverisje me tendenca të konsolidimit të autonomisë lokale për komunat dhe thellimit të reformave në sistemin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, po hyn në fazën më të rëndësishme të funksionalizimit të saj.

Në kuadër të strategjisë për vetëqeverisje lokale janë paraparë gjithsej 5 objektiva, e para nga to është fuqizimi i rolit të komunave si akterë kryesorë në zhvillimin ekonomik lokal.¹

Strategjia mbështet ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmirësuar zbatimin e ligjeve, krijimin e klimës së partneritetit me biznesin, krijimin e mundësive për aktivitete rinore dhe hapësira për grupet e marginalizuara, shoqërinë civile dhe qytetarët, që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes lokale. Në nivel komunal, plani strategjik për zhvillim ekonomik lokal është dokumenti kryesor strategjik për mbështetjen e vendimmarrjes.

Vizioni dhe misioni i prezantuar në këtë plan strategjik përshkruajnë një komunitet të qëndrueshëm ekonomikisht, të mbështetur nga shërbime cilësore të komunës. Ky vizion dhe nismat strategjike që janë krijuar për të arritur këtë vizion bëjnë thirrje për investime në komunitet që do të mbështesin dhe ndërtojnë ato cilësi që e bëjnë komunën e Klinës të veçantë.

Plani strategjik ka për synim që komuna e Klinës t’iu ofrojë shërbime qytetarëve të vet në mënyrë sa më efikase dhe efektive. Rrjedhimisht, synon të përkrahë dhe mbështes zhvillimin e NVM-ve, bujqësinë dhe turizmin, duke ruajtur edhe trashëgiminë kulturore. Pastaj, ta përmirësojë infrastrukturën fizike, ta rris cilësinë në arsim dhe shëndetësi, ta ruajë mjedisin dhe natyrën. Realizmi i këtyre qëllimeve lidhet drejtpërdrejt me ngritjen e cilësisë së jetesës në komunën e Klinës, për periudhën pesë-vjeçare 2024-2029.

Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 6.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023, fq. 4

1. METODOLOGJIA


Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal (tash e tutje mund ta gjeni si shkurtesë SZHEL) e komunës së Klinës për periudhën 2024-2029, është hartuar duke përfshirë gjatë procesit: sektorin publik, pra zyrtarë të drejtorive të komunës, bizneset dhe shoqërinë civile. Andaj, SZHEL mbështetet me projekte për arritjen e objektivave zhvillimore të cilat reflektojnë interesat e qytetarëve, komunitetit të biznesit dhe akterëve tjerë në komunën e Klinës, për të krijuar dhe ofruar kushte cilësore të jetesës për qytetarët e kësaj komune.

Ky dokument strategjik bazohet në politikat strategjike për zhvillim ekonomik lokal, si:

- ✚ Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
- ✚ Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026
- ✚ Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023
- ✚ Programin Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim (MS)
- ✚ Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) dhe
- ✚ Strategjitë e Veprimit në Nivel Lokal

Figura në vijim paraqet grafikisht metodologjinë e punës së hartimit të SLEZH-it, për komunën e Klinës.

Fig. 2 Metodologjia e punës



Gjatë hartimit të SZHEL janë mbajtur takime të rregullta pune me përfaqësuesit e komunës së Klinës. Si rrjedhojë janë identifikuar akterët kryesorë dhe përfaqësuesit e tyre janë përfshirë në ekipin e punës. Tutje është bërë planifikimi i procesit të hartimit të SZHEL. Pastaj janë mbledhur të dhënat nga burimet dytësore mbi veçoritë gjeografike dhe demografike, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, tregun e punës, shërbimet administrative të komunës, infrastrukturën, telekomunikacionin, rrjetin energjetik, furnizimin me ujë të pijshëm, kulturën dhe profilin ekonomik lokal të komunës së Klinës. Të dhënat tjera janë mbledhur nga burimet parësore, nëpërmjet intervistave të strukturuar dhe jo strukturuar si dhe nëpërmjet fokus grupeve. Duke ditur rolin dhe rëndësinë e komunitetit biznesor në zhvillimin ekonomik të komunës, jemi këshilluar me këtë komunitet. Nga ta kemi mbledhur të dhëna lidhur me faktorët lehtësues dhe pengues në të bërit biznes. Në këtë mënyrë, komuna ka krijuar një pasqyrë më të qartë të faktorëve që ndikojnë në inkurajimin dhe rritjen e tyre. Pas mbledhjes së të dhënave nga të gjitha burimet, është bërë vlerësimi ekonomik lokal që ka rezultuar me identifikimin e forcave, dobësive, mundësive dhe rreziqeve, e njohur si analiza SWOT.

Rrjedhimisht, rezultatet e analizës SWOT janë përdorur për definimin e planit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Këto rezultate kanë ndihmuar po ashtu në zhvillimin e vizionit dhe misionit të komunës. Tutje janë përcaktuar qëllimet dhe objektivat e komunës së Klinës. Po ashtu, nga to kanë derivuar edhe programet dhe projektet të cilat kanë qëllim maksimizimin e forcave, adresimin e dobësive, shfrytëzimin e mundësive dhe zbutjen e rreziqeve apo kërcënimeve.

Ky dokument ka kaluar procedurat e konsultimit paraprak dhe të konsultimit publik, sipas rregullave për hartimin e dokumenteve strategjike në Republikën e Kosovës.

1. ANALIZA E GJENDJES SOCIO-EKONOMIKE

Analiza e gjendjes socio-ekonomike përfshin informata mbi gjendjen socio-ekonomike në komunën e Klinës. Më specifikisht, informata mbi pozitën dhe veçoritë gjeografike të komunës, popullsinë, vendbanimet, migrimin, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, shërbimet administrative, infrastrukturën, telekomunikacionin, kulturën etj. Në vazhdim prezanton buxhetin komunal dhe vazhdon me profilin ekonomik të komunës.

HISTORIK I SHKURTËR I KOMUNËS – Vendbanimet në lokalitetin e Klinës me sa dihet datojnë që nga parahistoria-koha e neolitit. Dëshmi për këtë janë gjëmadhat e shumta që gjenden në lokalitete të ndryshme të komunës. Më karakteristike janë gjurmët e lokaliteteve të njohura ilire si në Dresnik, Përçevë, Gllarevë, Dollc, Pograxhë, Klinafc, Jashanicë, Sferkë etj. Pothuajse në çdo lokalitet të vendbanimeve të sotme ka gjurmë të lokaliteteve të vjetra të periudhave të ndryshme.

Profirogoniti në traktin e tij të njohur “Shënime për popujt” shkruan në vitin 948-952, se ndër qytetet e banuara dendur është edhe Dresniku – “Desstinik”. Vendbanim i hershëm është edhe Dollci i sotëm, i cili ishte i shënuar me emrin Zalug në hartën e Manastirit të Hilandarit në vitin 1200 nga Solovjevi. Pas rënies nën turqit, jeta e shqiptarëve ishte e vështirë. Që prej atëherë Klinën e karakterizon edhe larmia fetare. Popullsia e këtyre trevave merrej kryesisht me bujqësi e cila ishte mjaft e zhvilluar.

Kohëve të fundit, në lokalitetin e Dresnikut janë bërë gjurmime dhe gjërmime arkeologjike të cilat pritet të hedhin me shumë dritë mbi historinë e pasur të Klinës. Komuna e Klinës si njësi organizative në kuadër të organizimit territorial të Republikës së Kosovës, është themeluar si komunë në vitin 1954.

POZITA DHE VEÇORITË GJEOGRAFIKE – Komuna e Klinës ka pozitë të mirë gjeografike. Ajo shtrihet në perëndim të Kosovës, përkatësisht në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit. Territori i kësaj komune zë një sipërfaqe prej 308.8 km². Kufizohet me shtatë komuna. Në veri me Istogun, në lindje me Skenderajn dhe Drenasin, në jug me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën.

Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike veçanërisht në pjesën e Rrafshit të Dukagjinit janë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë: kultivimit të kulturave bujqësore, perimeve, pemëve dhe kushteve të mira për zhvillimin e blegtorisë dhe bletarisë. Nëpër territorin e Klinës kalojnë gjashtë lumenj: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Klina, Mirusha, Lumi i Istogut dhe Lumëbardhi i Deçanit. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujë nxënieve (pendëve) përgjatë rrjedhës së tyre do të mund të ujiteshin deri në

2,000 ha toka bujqësore. Me realizimin e projekteve për ndërtimin e kanaleve të ujitjes dhe pendëve deri me tani ujiten rreth 1,200 ha tokë bujqësore.¹

Klina hyn në zonën intensive për nga mundësitë e zhvillimit të bujqësisë, pasi që 87.7% e sipërfaqes është nën 600 metra të lartësisë mbidetare. Tokë bujqësore është 95%, vetëm 4.9% janë toka jopjellore. Në strukturën e tokave bujqësore dominojnë arat me 12,734 ha, pyjet me 12,735 ha, livadhet me 2,184 ha, kullosat me 2,043 ha. Klina ka resurse natyrore minerale dhe jo minerale: rezerva të linjtit i ka 2 miliardë ton, të xehes së boksitit 2 milionë ton, të argjilës 6.5 milionë ton, të rërës dhe zhavorrit 3.5 milionë ton.

Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, në pjesën jugore dhe jug-perëndimore të Klinës janë ujëvarat, një bukuri e rrallë natyrore me një botë bimore dhe shtazore të pasur. Ky kompleks me një sipërfaqe prej 200 ha është një zonë e mbrojtur-rezervat, me mundësi të mira për zhvillimin e turizmit.

Klina shtrihet 55 km larg Prishtinës dhe 28 km larg Pejës. Hapësira e qytetit është e përkufizuar me rrjedhjen e lumenjve Drini i Bardhë dhe Klina, si dhe me kodrën e Krushevës në veri. Në kuptim të lidhjeve trafikore paraqet qendër të rëndësishme, duke qenë se në qendër të saj kryqëzohen drejtimet për magjistrale, Istog dhe Skenderaj. Pozita natyrore dhe konfiguracioni mundësojnë që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Npër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë-Klinë-Pejë, rruga Klinë-Skenderaj- Mitrovicë, Klinë-Istog-Pejë, si dhe vijat hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Pejë dhe Fushë Kosovë-Klinë-Prizren.

Fig. 3 Pozita gjeografike e komunës së Klinës



Territori i Klinës dhe i tërë Dukagjinit përbën një pjesë të mbyllur më vete dhe të rrethuar me male. Drini luan rol të madh në lidhjet në mes këtij territori e Republikës së Shqipërisë. Përmes Llapushës lidhet me Prishtinën e më larg. Rrugët që çojnë kah Gjakova, Peja, Gurrakoci, Prishtina dhe tani kah Skenderaj, të gjitha këto të asfaltuara, i mundësojnë këtij territori lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës. Vija hekurudhore që kalon nëpër territorin e Klinës, ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e komunës së Klinës. Territori i komunës së Klinës ka karakteristika të ndryshme gjeomorfologjike.

¹ <https://kk.rks-gov.net/kline/qyteti/historiku/>


Pjesa lindore ka karakter të lartësisë, ndërsa pjesa perëndimore ka karakter të rrafshët. Pjesa veriore dhe verilindore e komunës është e përbërë prej viseve malore të Llapushës dhe Drenicës, ndërsa pjesa perëndimore dhe pjesa qendrore janë pjesë e rrafshinës së Rrafshit të Dukagjinit. Pjesët të cilat i përkasin Rrafshit të Dukagjinit janë në zonën me lartësi mbidetare deri në 500 m, ndërsa pjesët kodrinore gjenden kryesisht në lartësinë ndërmjet 500 dhe 700 m. Në pjesën lindore, një pjesë vogël e territorit të kësaj komune ka lartësinë pak më shumë se 700 m. Pjesa më e madhe e vendbanimit është e rrafshët nga pjesa e majtë e Drinit të Bardhë, në lartësinë mbidetare prej 385 deri 390 m. Një pjesë e terrenit në afërsi të drejtimit hekurudhor për Pejë është e nënshtruar ndaj rrëshqitjeve. Pjesët e vendbanimit në veri të binareve të hekurudhës gjenden në pjesë me rënie të lehtë në një lartësi mbidetare 400-420 m².

Klima: Klima në komunën e Klinës ka karakteristikat e klimës së butë kontinentale, me ndikim të klimës mesdhetare. Temperatura mesatare e ajrit është 11.3°C. Në korrik arrihet temperatura maksimale absolute prej 37.6°C, ndërsa në shkurt temperatura minimale absolute prej -11,8°C. Amplituda mesatare është 46.1°C. Në këtë rajon për shkak të ndikimit të mediteranit i cili depërton me anë të lumit Drini i Bardhë, klima është mjaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturë të ajrit gjatë vitit.


Vlera mesatare vjetore e të reshurave në Klinë është 540 mm. Të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa më të vogla në janar dhe shkurt.

POPULLSIA - Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, komuna e Klinës ka gjithsej 38,496 banorë. Rezultatet e regjistrimeve të popullsisë në këtë komunë për periudhën 1948-2011 janë paraqitur në grafikun nr. 1. Siç shihet në grafikun në vijim, që nga viti 1948 e deri në vitin 1991, komuna e Klinës ka pasur një rritje të vazhdueshme të popullsisë. Mirëpo, vërehet një rënie e dukshme në regjistrimin e vitit 2011.

Graf. 1 Popullsia në komunën e Klinës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2011



² <https://kk.rks-gov.net/kline/qyteti/pozita-geografike/>




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia sipas vendbanimeve në komunën e Klinës, 1948-2011.*

Dendësia: Në komunën e Klinës dendësia e popullsisë është rreth 125 banorë në 1 km², bazuar në popullsinë totale të regjistruar në vitin 2011 (38,496 banorë) dhe sipërfaqen e territorit të saj (308.8 km²). Ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë sipas vendbanimeve. Në vendbanimet që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia e popullsisë është më e madhe, ndërsa në vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë, edhe dendësia e popullsisë është më e vogël.

Shtimi natyror: Nëse e analizojmë rritjen e popullsisë prej vitit 1948 e deri në vitin 1991, komuna e Klinës pothuajse e ka trefishuar atë. Ndërsa, regjistrimi i vitit 2011 vë në pah një rënie të dukshme të popullsisë. Statistikat e tri viteve të fundit (2018-2020) nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, tregojnë se kemi një rënie prej 30% të shtimit natyror në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Ndërsa, në vitin 2020 kemi një rritje prej 12% të shtimit natyror, krahasuar me vitin 2019.

Nataliteti ka pësuar rënie prej 16.2% nga viti 2018 në atë 2019, ndërsa vërehet një rritje e natalitetit prej 16.8% në 2020-tën krahasuar me 2019-tën. Mortaliteti ka rritje në vitin 2019 kundrejt vitit 2018 (16.6%). Po ashtu, ka rritje edhe më të madhe në vitin 2020 kundrejt vitit 2019 (23.5%). Më gjerësisht, shih figurën në vijim.


Graf. 2 Shtimi natyror në komunën e Klinës, periudha 2018-2020



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2018-2020*.

Struktura gjinore: Sa i përket strukturës gjinore në këtë komunë, ka pak diferencë. Sipas regjistrimit të vitit 2011, 49.86% (19,193) janë meshkuj, ndërsa 50.14% (19,303) janë femra.


Graf. 3 Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Klinës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas gjinisë 2011.*

Struktura etnike: Struktura etnike e popullsisë në komunën e Klinës është mjaft homogjene, meqë mbi 96.67% e popullsisë janë shqiptarë. Pastaj, egjiptianë 2.43%, serbë 0.25%, ashkalinj 0.22%, dhe të tjerë 0.42%. Më gjerësisht shih figurën në vijim, ku janë paraqitur grafikisht të gjitha etnicitetet me përqindje në pjesëmarrjen totale prej 100%.


Graf. 4 Struktura etnike e popullsisë në komunën e Klinës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas etnicitetit 2011.*

Struktura religjioze: Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Klinës është si në vijim: 81.01% e popullsisë i takojnë besimit islam, pastaj besimit katolik 18.51% dhe besimit ortodoks 0.26%. Prej gjithsej të regjistruarve, 0.22% nuk janë deklaruar apo u takojnë besimeve tjera. Më gjerësisht shih figurën në vijim, ku janë paraqitur grafikisht religjionet përkatës me përqindje në pjesëmarrjen totale prej 100%.


Graf. 5 Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Klinës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas religjionit 2011.*

Struktura moshore: Siç shihet në grafikonin në vijim, komuna e Klinës ka strukturë moshore relativisht të re. Rreth 50.5% e popullsisë janë nën moshën 24 vjeçare. Ndërsa vetëm 6.77% i takojnë grupmoshave jo aktive për punë, prej 65 e tutje. Më gjerësisht, për secilën grupmoshë, shih figurën në vijim ku janë paraqitur edhe me përqindje.

Graf. 6 Struktura moshore e popullsisë në komunën e Klinës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas grupmoshës 2011.*

VENDBANIMET - Komuna e Klinës ka gjithsej 54 vendbanime. Njëmbëdhjetë vendbanime të komunës së Klinës kanë më shumë se 1,000 banorë. Qyteti i Klinës si vendbanim ka numrin më të madh të popullsisë (5,542), krahasuar me vendbanimet tjera. Megjithatë, duhet theksuar se mbizotëron shtrirja e popullsisë në zona rurale (85.6%), ndërsa, në zonë urbane jetojnë vetëm 14.4% e tyre.

Numri i ekonomive familjare sillet prej 4 (Dranashiq) deri në 1,010 (qyteti i Klinës). Gjithsej janë të regjistruara 5,843 ekonomi familjare. Më gjerësisht, shih tabelën në vijim.

Fig. 4 Komuna e Klinës



Tab. 1 Popullsia e komunës së Klinës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare

Nr.	VENDBANI MI	POPULLS IA	EKONOMI TË FAMILJARE	Nr .	VENDBANI MI	POPULLS IA	EKONOMI TË FAMILJARE
1	Klinë	5,542	1,010	28	Rudicë	446	75
2	Sferkë	2,448	296	29	Dollovë	444	70
3	Gllarevë	1,784	218	30	Drenoc	440	60
4	Jashanicë	1,784	267	31	Bokshiq	433	54
5	Dresnik	1,770	304	32	Dugajevë	399	67
6	Siqevë	1,338	205	33	Resnik	399	55
7	Zajm	1,267	184	34	Budisalc	398	64
8	Caravik	1,241	175	35	Deiq	376	61
9	Gremnik	1,131	150	36	Qeskovë	373	47
10	Përqevë	1,005	117	37	Pograxhë	366	52
11	Volljakë	929	118	38	Radulloç	353	61
12	Rixhevë	870	112	39	Ranoc	353	59
13	Çabiq	862	120	40	Dobërdol	339	54
14	Kërrnicë	794	110	41	Krushevë e Vogël	323	56
15	Shtupel	771	113	42	Dolc	276	53
16	Gjurgjevik i Vogël	745	119	43	Berkovë	246	49
17	Grabanicë	728	114	44	Dush i Vogël	241	31
18	Zabërgjë	728	102	45	Leskoc	239	32
19	Videjë	663	105	46	Grabc	206	28
20	Zllakuqan	660	114	47	Jagodë	197	34
21	Këpuz	622	88	48	Dush	196	33
22	Krushevë e Madhe	585	101	49	Stupë	179	32
23	Qupevë	579	89	50	Pjetërq i Poshtëm	160	23
24	Pjetërq i Epërm	563	97	51	Binxhë	117	18
25	Ujmirë	544	86	52	Nagllavë	67	13
26	Klinafc	480	88	53	Jelloc	27	5
27	Gjurgjevik i Madh	449	51	54	Dranashiq	21	4

Gjithsej 38,496 banorë dhe 5,843 ekonomi familjare

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare 2011.*


Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Klinës mund të kategorizohen si në figurën në vijim.

Prej 54 vendbanimeve, mbi gjysma (29) janë vendbanime rurale deri në 500 banorë, 15 janë vendbanime rurale

prej 500-999 banorë, tetë janë vendbanime rurale prej 1,000- 1,999 banorë, ndërsa në kategoritë 2,000-4,999 dhe mbi 5,000 banorë, vetëm nga një vendbanim.

Më gjerësisht, shih vendbanimet joformale në shtojcën nr. 3. Ndërsa, në shtojcën nr. 4 organizimin territorial të ndarë në qendrën kryesore, sub-qendrat, qendrat lokale dhe vendbanimet tjera.

Graf. 7 Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Klinës



Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Klinës mund të kategorizohen si në vijim.


Tab. 2 Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Klinës

Deri në 500 banorë		500-999 banorë	1,000-1,999 banorë	2,000-4,999 banorë	Mbi 5000 banorë
Klinafc Gjurgjevik i Madh Rudicë Dollovë Drenoc Bokshiq Dugajevë Resnik Budisalc Deiq Qeskovë Pograxhë Raduloc Ranoc Dobërdol	Krushevë e Vogël Dollc Bërkovë Dush i Vogël Leskoc Grabc Jagodë Dush Stupë Pjetërq i Poshtëm Binxhë Nagllavë Jelloc Dranashiq	Volljak Rixhevë Çabiq Kërnice Shtupel Gjurgjevik i Vogël Grabanicë Zabërgjë Videjë Zllakuqan Kpuz Krushevë e Madhe Qupevë Pjetërq i Epërm Ujmir	Gllarevë Jashanicë Drsnik Siqevë Zajm Caravik Gremnik Përqevë	Sferkë	Qyteti i Klinës

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas vendbanimit, 2011.*

Në vijim është paraqitur grafikisht, numri i popullsisë sipas vendbanimeve, bazuar në regjistrimet 1948-2011.

Graf. 8 Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2011



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Klinës sipas vendbanimit, 1948-2011.*

Siç shihet në grafikonin më lart, të gjitha vendbanimet e komunës së Klinës kanë rritje të popullsisë prej vitit 1948 në atë 2011, përveç vendbanimeve: Dranashiq, Jelloc, Binxhë, Pjetërq i Poshtëm, Bërkovë, Nagllavë, Drenoc, Stupë, Dollc, Budisalc, Krushevë e Madhe, Videjë, të cilat kanë pësuar rënie të dukshme. Bazuar në përqindjen e rritjes prej vitit 1948 në atë 2011, rritje më të madhe kanë shënuar vendbanimet: qyteti i Klinës, Qupevë, Zajm, Sferkë, Volljakë, Përqevë, Zabërgjë, Dush i Vogël, Ujmirë, Gjurgjevik i Vogël, Caravik, Çabiq, Gremnik, Dollovë, Deiq, Gllarevë, Siqevë dhe Dresnik. Pastaj vendbanimet: Qeskovë, Resnik, Kërmicë, Bokshiq, Këpuz, Jashanicë, Grabanicë etj.

MIGRIMI - është lëvizja e njerëzve nga një vend në tjetrin me qëllime të ndryshme si vendosja e përkohshme ose e përhershme. Migrimi është më shumë se rritja ose zvogëlimi i njerëzve që jetojnë në një vend të caktuar. Ai ndikon në kulturën, stilin e jetës dhe qëndrimin politik të një kombi.



Të dhënat dhe statistikat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë se në komunën e Klinës ekziston një trend i ngjashëm i migrimit kombëtar. Ndërsa, migrimi ndërkombëtar në vitin 2019 ka shënuar në rritje të madhe, duke u zbutur dukshëm më pas në vitin 2020. Më konkretisht, shih tabelat në vijim.

Tab. 3a Migrimi kombëtar në komunën e Klinës, periudha 2018-2020

Migrimi kombëtar	2018	2019	2020
Imigrimi	226	230	156
Emigrimi	259	264	178
Bilanci i migrimit kombëtar	-33	-34	-22

Tab. 3b Migrimi ndërkombëtar në komunën e Klinës, periudha 2018-2020

Migrimi ndërkombëtar	2018	2019	2020
Imigrimi	199	179	226
Emigrimi	551	683	193
Bilanci i migrimit ndërkombëtar	-352	-504	33

Burimi: ASKDATA: *Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi, 2018 – 2020.*

ARSIMI - është institucion shoqëror përmes të cilit shoqëria u siguron anëtarëve të saj njohuri të rëndësishme, duke përfshirë faktet themelore, aftësitë e punës dhe vlerat e normave kulturore. Një nga përfitimet më të rëndësishme të arsimit është se ai përmirëson jetën personale dhe ndihmon shoqërinë të funksionojë më mirë. Duke ofruar arsimim, varfëria mund të zhduket dhe çdo person mund të japë kontributin e tij në zhvillimin e vendit.

Arsimimi i mirëfilltë ndikon në zbutjen e varfërisë, rritjen e sigurisë, zhvillimin e tregtisë, vënien e rendit dhe rregullit, respektimin e ligjit, fuqizimin e gruas, përmirësimin e pjesëve më të dobëta ekonomike të shoqërisë etj. Pra, pa një sistem të qëndrueshëm arsimor, nuk mund të formohet një shoqëri e mirë.

Arsimi është pjesë integrale e shoqërisë njerëzore. Ai inkurajon inovacionin dhe krijimtarinë. Andaj, themi se një vend që të evoluojë, duhet të ketë sistem të qëndrueshëm arsimor.

Sistemi arsimor në Kosovë: Sistemi arsimor në Kosovë është duke funksionuar sipas modelit 5+4+3 nga viti 2002. Sipas këtij modeli 5 vite janë në arsimin fillor, pastaj vazhdohet me 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Edhe struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Klinës është e organizuar në tri nivele: arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII).

Në komunën e Klinës arsimit është i organizuar në 29 institucione shkollore. Prej tyre 1 çerdhe, 26 shkolla të nivelit fillor dhe mesëm të ulët dhe 2 shkolla të nivelit mesëm të lartë.

Gjatë vitit 2023 janë përfunduar disa projekte kapitale, si në vijim:

1. Furnizim- montimi i pompës termike në sistemin e ngrohjes qendrore në SHFMU “Ymer Berisha” në vlerë prej 35,166.00 euro.
2. Rinovimi i objektit të çerdhes “Xhevë Lladrovci” në vlerë prej 12,966.48 euro.
3. Furnizim- montimi i pompës termike në sistemin e ngrohjes qendrore në SHML “Fehmi Agani” në vlerë prej 89,000.00 euro.
4. Rinovimi i objektit dhe rregullimi i oborrit në SHFMU “Motrat Qiriazhi” në vlerë prej 29,550.00 euro.
5. Furnizim dhe montim i tabelave të mençura në vlerë prej 29,450.00 euro.
6. Mirëmbajtje, rinovim dhe pastrim i objekteve shkollore në vlerë prej 108,052.86 euro.
7. Furnizimi me shujtë ditore për fëmijë para fillorë dhe nxënës të klasave 1-5, vlera 76,141.01 euro.
8. Transporti i nxënësve në relacionin shtëpi-shkollë dhe anasjelltas, në vlerë prej 45,941.94 euro.
9. Furnizim me material për zyre dhe me material higjienik në vlerë prej 19,887.05 euro.
10. Furnizim me inventar në vlerë prej 37,770.00.
11. Këndi i lojërave në SHFMU “Ismet Rraci” dhe në çerdhen “Xhevë Lladrovci” në vlerë prej 5,999.00 euro.



Arsimi parashkollor dhe parafillor: Sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK, në komunën e Klinës ka një çerdhe për

fëmijët e moshës nën 5 vjet. Mirëpo, në shumicën e shkollave fillore në vend ofrohet arsimim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeçare.


Burimi i njëjtë vë në pah një numër të vogël që kanë vijuar arsimin parashkollor. Në vitin 2021/2022 kanë vijuar 80 fëmijë, në vitin 2022/2023, 95 fëmijë. Ndërsa, në arsimin parafillor në vitin 2021-2022 e kanë ndjekur 417 nxënës, ndërsa në vitin 2022/2023, 374 nxënës.

Arsimi i mesëm i ultë: Bazuar në statistikat e ASK-së për komunën e Klinës, këtë nivel arsimi në vitin 2021-2022 e kanë ndjekur 2812 nxënës, në vitin 2022/2023, 2248 nxënës.

Arsimi i mesëm i lartë: Këtë nivel arsimi në vitin 2021-2022 e kanë ndjekur 1499 nxënës. Në vitin 2022/2023, 1423 nxënës.

Gjatë vitit 2023 janë ndarë 60 bursa nga komuna e Klinës për studentët e universiteteve publike, për dallim me vitin paraprak që ishin ndarë 40 bursa. Në vitin 2024 planifikohen të ndahen 80 bursa. Dhe në vitet vijuese do të rritet numri i bursave për studentët.

Graf. 9 Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2019-2023



Graf. 9 Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2019-2023

Siç shihet në grafikun e mësipërm, pothuajse të të gjitha nivelet e arsimit në komunën e Klinës, ka rënie mesatare nga viti në vit për periudhën e analizuar.

Bazuar në të dhënat nga ASK (periudha 2022-2023), numri mesatar i personelit në arsimin publik për këtë periudhë është 654. Prej tyre mesatarisht 540 janë mësimdhënës. Ndërsa, numri mesatar i nxënësve për periudhën 2023-2024 është 6682. Rrjedhimisht, raporti nxënës/mësimdhënës (edukator) është 12.

Hulumtimi i vitit 2011 nga ASK mbi popullsinë e moshës 10 vjeçe e mbi, sipas nivelit të arsimit dhe njohjes së shkrimleximit, vë në pah se pjesa dërrmuese e popullsisë së komunës së Klinës kanë të përfunduar shkollimin e mesëm të ultë (40.63%), pastaj të mesëm të lartë (22.76%) dhe atë fillor (20.24%). Prej tyre të diplomuar rezultuan 5.39%, ndërsa me studime postdiplomike vetëm 0.46%. Prej gjithsej të anketuarve, 10.52% e tyre nuk kanë përfunduar asnjë lloj niveli të arsimit.

Nuk duhet lënë anash faktin se Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me Bashkimin Evropian (BE) për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathtësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. MSA i kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit për arritjen e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë, gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe personat me aftësi të veçanta. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të marrë formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të Planit Strategjik të Arsimit.

Nuk duhet lënë anash faktin se Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me Bashkimin Evropian (BE) për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet, me qëllim të përmirësimit të shkathhtësive, punësueshmërisë, përfshirjes sociale dhe nxitjes së zhvillimit ekonomik. MSA i kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit për arritjen e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë, gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe personat me aftësi të veçanta. Pritet që bashkëpunimi në mes të BE-së dhe Kosovës të merr formën e asistencës teknike për jetësimin e masave të caktuara të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK-ut).

SHËNDETËSIA - Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të listës prioritare të projekteve ka inkorporuar edhe projektin për fuqizimin e infrastrukturës në kujdes parësor. Veprimtaria e kujdesit parësor shëndetësor përfshin promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin dhe rehabilitimin që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike mbështetur në konceptin e mjekësisë familjare.⁹

Në komunën e Klinës shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor, dhe në sektorin privat ku ofrohen shërbime parësore të lëmenjve të specializuar mjekësorë³.

Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 15 objekte shëndetësore, si në vijim:

- 1 Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) “Nënë Tereza” në Klinë.
- 3 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në: Zllakuqan, Ujmirë dhe Sferkë.
- 10 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF) në: Gllarevë, Jashanicë, Jashanicë e Epërme, Drenoc, Caravik, Budisalc, Jagodë, Shtupel, Grabanicë, Leskoc etj⁴.



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “Nënë Tereza” paraqet institucionin e kujdesit parësor shëndetësor në

³ Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2023,

⁴ Po aty.

komunë. Në kuadër të këtij institucioni, funksionojnë dy departamente: departamenti i mjekësisë familjare dhe departamenti i administratës si dhe barnatorja qendrore.

Departamenti i mjekësisë familjare në kuadër të të cilit funksionojnë 4 sektorë:

- Sektori i mjekësisë familjare, që ka dy njësi: njësia e vaksinimit dhe njësia e SISH,
- Sektori i urgjencës,
- Sektori i shëndetit oral,
- Sektori i diagnostikës (laboratori+rentgeni).

Në kuadër të Sektorit të mjekësisë familjare ndodhen shërbimi i praksës së përgjithshme, shërbimi i pediatriisë, shërbimi konsultativ, shërbimi i vaksinimit dhe imunizimit, Sistemi Informativ shëndetësor (SISH) etj.


Numri i të punësuarve në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve në komunën e Klinës në vitin 2023 është 141. Prej tyre, 31 mjekë, 1 farmacist, 85 infermierë dhe 24 punëtorë jo shëndetësorë. 10

Grafiku në vijim tregon numrin e vizitave të përgjithshme në QKMF në komunën e Klinës në vitin 2020 dhe 2021.

Po ashtu, nëse e analizojmë numrin e përgjithshëm të vizitave mjekësore në QKMF me numrin e përgjithshëm të popullsisë në këtë komunë, rezulton se mesatarja e vizitave mjekësore vjetore për person është rreth 4 herë. Më gjerësisht, shih informatat e prezantuara në grafikun në vijim⁵.

Graf. 10 Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2020-2021

⁵ ASKDATA: *Të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve.*



Burimi: ASKDATA: Numri i vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare, 2020-2021.

Shërbimet e dhëna në QKMF 2022	Nr i vizitorëve
Stomatologjia	1,373
Laboratori	12,629
Mjekësia Familjare	58,610
Intervenimet	63,118

Statistikat e ASK për periudhën 2022-2023 tregojnë se mesatarja vjetore e të sëmurëve me sëmundje malinje është rreth 59. Ndërsa, i njëjti burim vë në pah se gjatë periudhës 2020-2022, në komunën e Klinës kanë vdekur 72 persona si pasojë e COVID-19.

Në vijim janë ranguar trendët e sëmundjeve ngjitëse në komunën e Klinës, bazuar në statistikat e QKMF për vitin 20226.

Tab. 4 Trendi i sëmundjeve ngjitëse për vitet 2020-2022

⁶ Burimi: QKMF-KLINE: Trendi i sëmundjeve ngjitëse, për vitet 2020-2022

Diagnoza	2020	2021	2022
Pneumonia	155	163	79
Diarre Akute	120	1620	833
Variqela	234	43	57
Intoxication alim	38	0	15
Covid-19	407	1650	1884
Pertusis	0	0	1
Verdhëza akute "B"	1	5	6
Parotiti epidemik	3	0	3
Brucelloza	0	0	2
J11-Influenza	3064	2629	1996

Burimi: Trendi i sëmundjeve ngjitëse, për vitet 2020-2022

Komuna e Klinës përgjatë viteve 2020- 2023, ka ndërtuar objektet e reja të QMF në Ujmirë, AMF në fshatin Shtupel, pastaj rinovimin e disa prej tyre si dhe rinovimin e hapësirave të ndryshme në QKMF.

Po ashtu, është bërë digjitalizimi i kabinetit të radiologjisë i cili ka bërë të mundur një trajtim mjaft të mirë për të gjithë ata që kanë nevojë. Kërkesa është rritur në masë të madhe me fillimin e pandemisë COVID-19. Është blerë edhe një Ultrazë i ri për të lehtësuar punën e mjekëve në ofrimin e shërbimeve për pacientë, si dhe është pajisur Laboratori me pajisje të reja duke shtuar gamën e shërbimeve për qytetarët. Këtë vit pritet të bëhet furnizimi me Mamograf, i cili do të shërbejë në parandalimin dhe zbulimin e hershëm të sëmundjeve të kancerit të gjirit, si dhe si dhe në edukimin dhe promovimin shëndetësor të komunitetit në komunën e Klinës. Po ashtu, gjatë vitit 2023 do të përfundojë projekti për qasje më të lehtë në objektin e QKMF të personave të hendikepuar. Gjatë vitit 2024 do të bëhet vendosja e pompave termike për ngrohje në QKMF. Si dhe do të vendosen shtretërit e rinj në QKMF, QMF dhe AMF.

MIRËQENIA SOCIALE – Sistemi i mirëqenies sociale është një rrjet programesh i krijuar për të ndihmuar banorët e një vendi në faza të ndryshme të jetës së tyre. Ky sistem lind nga përpjekjet e qeverisë ose organizatave për të siguruar mirëqenie sociale. Është një proces i vazhdueshëm që synon të kujdeset për nevojat specifike të shoqërisë. Përmes programeve të mirëqenies sociale, qytetarët mbrohen nga pasiguritë e ndryshme të jetës.

Në komunën e Klinës ka një Qendër për Punë Sociale (QPS), e cila në kuadër të misionit të saj ka kategoritë më të rrezikuara dhe që kanë nevojë për shërbimet që iu ofron ky institucion, në veçanti për fëmijët e braktisur,


fëmijët pa kujdes prindëror, dhunën në familje, viktimat e trafikimit, personat e moshuar dhe pa përkujdesje, personat me nevoja të veçanta, delikucencën, shkurorëzimet etj. Po ashtu, kjo qendër ofron edhe ndihmë financiare nëpërmjet Sektorit të Asistencës Sociale për familjet nevojtare, të cilat i plotësojnë kriteret që janë të parapara në Ligjin dhe Udhëzimet Administrative në fuqi, gjithmonë duke u bazuar edhe në verifikimin dhe monitorimin e këtyre familjeve. 11

Të dhënat e fundit nga ASK për vitin 2022 (TM1-TM4) tregojnë se në komunën e Klinës janë mesatarisht 820 familje të cilat kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale. Ndërsa për vitin 2023 (TM1-TM4), janë mesatarisht 790 familje⁷.

TREGU I PUNËS – Në vijim janë përmbledhur disa statistika të përgjithshme mbi tregun e punës në Kosovë.

Graf. 11 Statistikat e tregut të punës 2020, në Republikën e Kosovës

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020.



Siç shihet në grafikun e mësipërm, fuqia ekonomike aktive për vitin 2020 ishte 488,485 persona. Rrjedhimisht, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë ekonomike aktive për vitin 2019 rezultoi 40.5 %. Ndërsa, fuqia ekonomike jo aktive për vitin 2019 ishte 718,321 persona, që rezultoi në 59.5 % shkallë të pjesëmarrjes në fuqinë ekonomike jo aktive për vitin 2019.

Po ashtu, të dhënat nga ASK, tregojnë se në vitin 2019 ishin të punësuar 363,180 persona, që rezultoi në 30.1% shkallë të punësimit. Po në të njëjtin vit të papunë ishin 125,305 persona, pra, shkalla e papunësisë sillet rreth

⁷ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2022-2023

25.7%.

Numri i personave kontributdhënës në Trustin pensional në vitin 2019 ishte 6,188. Rreth 6% më shumë se në vitin paraprak.⁸

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE - Komuna e Klinës ka gjithsej 10 drejtori të cilat janë prezantuar detajisht te skema organizative e komunës (shih Shtojcën 2). Sipas statistikave të institutit GAP, në vitin 2011 ishin të punësuar 165 persona si shërbyes civilë. Rreth 2.5% më shumë se në vitin paraprak.

Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale - Ligji Nr. 03/L-040. Si rezultat, komuna e Klinës i ofron të gjitha shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Shërbimet administrative kryesore në nivel të komunës janë të përqendruara në Klinë, ku përfshihen edhe Qendra për Punë Sociale (në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale), Qendra për Regjistrim (në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme), Post-Telekomi, si dhe filialet e disa prej bankave komerciale.⁹

Në zonat rurale, shërbimet e vetme administrative ofrohen përmes zyrave të bashkësive lokale.

Në kuadër të zyrës së informimit menaxhohet edhe ueb-faqja e komunës e krijuar që nga viti 2010. Kjo ueb-faqe zyrtare u mundëson qasje më të lehtë qytetarëve në ngjarjet komunale. Postimi i vazhdueshëm i dokumenteve dhe ngjarjeve të rëndësishme janë në interes për qytetarët e komunës së Klinës.

Qytetarëve të komunës së Klinës, përveç që u ofrohen shërbime të mira në komunë, atyre u ofrohen edhe shërbime elektronike nëpërmjet E-kioskut.

Me gjithë vështirësitë që ka pasur komuna e Klinës për shkak të pandemisë COVID-19, ka arritur t'i realizojë synimet dhe objektivat e parapara sipas ligjeve aplikative në fuqi, duke shënuar

⁸ Instituti GAP. <https://www.komunat.institutigap.org/Statistics/index/Klin%C3%AB-8/271/y>

⁹ Plani zhvillimor i komunës së Klinës.

shumë të arritura dhe angazhime të administratës komunale, me qëllim që të arrihen kushte sa më të mira për qytetarët e kësaj komune.


Administrata komunale gjatë vitit 2022-2023 ishte funksionale dhe efikase në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe profesionale për qytetarët, në riorganizimin profesional dhe reformimin krahas reformës së administratës publike, punën transparente me media, OJQ, shoqëri civile, duke ofruar qasje në dokumentet zyrtare, duke demonstruar qeverisje transparente dhe komunikim dhe qasje transparente me qytetarët. 14

Gjatë vitit 2022-2023 janë kryer disa projekte kapitale, si: ndërtimi i ofiqarisë në Ujmirë, rinovimi i zyrës pritëse, digjitalizimi dhe rinovimi i objektit të komunës - nyjat sanitare, rinovimi i Departamentit të Shërbimeve Publike dhe Emergjente, rinovimi i oborrit të komunës, vendosja e pllakave në muret rrethuese, funksionalizimi i fontanave të jashtme, vendosja e E-kioskut në objekt të komunës, vendosja e skanerëve të sigurisë në hyrje të objektit komunal dhe shndërrimi i ngrohjes nga përdorimi i karburantit në ngrohje termike.¹⁰

INFRASTRUKTURA - Një ndër sfidat kryesore të komunave është edhe mirëmbajtja e infrastrukturës publike. Ato janë përgjegjëse për mirëmbajtjen, organizimin, operimin dhe zhvillimin e rrjetit rrugor të tyre. Infrastruktura teknike në komunën e Klinës si dhe shërbimet publike të ndërlidhura me të, kanë nevojë për përmirësime dhe investime të mëtutjeshme, ngjashëm si në pjesën më të madhe të Kosovës. Përkundër faktit se Klina është një ndër komunat më të pasura me rrjedha ujore, uji i pijshëm ende paraqitet si problem i pazgjidhur në tërësi. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, përkundër investimeve të deritashme, ka nevojë për shtrirjen e mëtutjeshme të tij dhe përmirësimin dhe kompletimin e rrjetit ekzistues. Furnizimi me energji kërkon investime të mëtutjeshme, me qëllim të rritjes së kapaciteteve. Rrjeti rrugor është përmirësuar në vazhdimësi pas luftës, por mbetet ende për t'u bërë, sidomos në brendi të disa vendbanimeve, si dhe në plotësimin e profileve rrugore, me qëllim të rritjes së sigurisë. 16

Rrugët: Rrjeti rrugor përbëhet prej rrugëve që kategorizohen në magjistrale, regjionale dhe lokale. Rruga magjistrale dhe ato regjionale paraqesin vijat kryesore

të qarkullimit dhe lidhjeve brenda komunës dhe në pjesën më të madhe shtrihen në terrene të rrafshëta apo përgjatë luginave. Ndërkaq, rrugët lokale kanë një shtrirje të lirë në mes vendbanimeve, duke iu përshtatur kushteve natyrore që ofron hapësira e Klinës.



¹⁰ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2021, fq. 4.

Rrjeti i rrugëve në komunën e Klinës përbëhet nga:

Magjistranja Prishtinë - Pejë: paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor në territorin e komunës dhe shtrihet kryesisht në drejtimin lindje-perëndim, duke e ndarë atë në dy tërësi. Kjo magjistranje mundëson lidhje me pjesët qendrore dhe lindore të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve të mëtutjeshme mundëson lidhje me shtetet fqinje, Maqedoninë dhe Serbinë. Në drejtimin perëndimor, magjistranja mundëson lidhje me Pejën si qendër regjionale, si dhe me Malin e Zi në vazhdim.

Rruga regjionale për Gjakovë: kryqëzohet me rrugën magjistranje rreth 620 m në lindje të kryqëzimit për qytetin e Klinës dhe është lidhja më frekvente në krahasim me drejtimet tjera regjionale brenda komunës. Shtrihet kryesisht në drejtimin veri-jug, përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë dhe pothuajse paralel me drejtimin hekurudhor për Prizren. Kjo rrugë regjionale mundëson lidhjen e Klinës me Gjakovën dhe Prizrenin, si dhe në vazhdim lidhjen me Shqipëri.

Rruga regjionale për Skenderaj: lidhet me rrugën magjistranje përmes zonës urbane të Klinës, ku kryqëzohet me rrugën nga Istogu. Kjo rrugë mundëson lidhjen me Skenderajn, Mitrovicën dhe me pjesët tjera të veriut të Kosovës. Në pjesën më të madhe shtrihet përgjatë terreneve kodrinore, kryesisht në drejtim verilindor.

Rrugët lokale: përbëjnë kategorinë më të ulët në hierarkinë e rrugëve në komunë, por që ka shpërndarjen më të gjerë, meqenëse i lidhin fshatrat në mes veti. Rrjeti i rrugëve lokale është më i dendur përgjatë drejtimeve kryesore rrugore si dhe përgjatë luginave, meqë në këto hapësira janë të përqendruara vendbanimet. 17

Rrugë të pa kategorizuara: Lidhin lagjet e fshatit si dhe të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike. Duhet theksuar që përveç rrugëve regjionale të renditura më lart, rruga regjionale për Istog është projekt i paraparë me buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës për periudhën 2022-2025. Ndërtimi i kësaj rruge është paraparë edhe me hartat zonale dhe do të kushtojë rreth 1,800.000€.

Disa nga statistikat e projekteve kapitale të përfunduara në vitin 2022- janë:

- ✚ 30739 m asfaltime rrugore
- ✚ 19674 m kanalizim fekal,
- ✚ 1900 m ujësjellës,
- ✚ 3990 m trotuar,
- ✚ 1100 m shteg për biçikleta,
- ✚ 1 urë mbi lumin Klina (Pograxhë),
- ✚ 1 urë për këmbësorë mbi lumin Drini i Bardhë (Rastok),
- ✚ 3 ura të përmasave më të vogla (mbi përroska)

Gjatë periudhës 2022 janë kryer këto projekte të asfaltimeve të rrugëve lokale në fshatrat: Qupevë, Gremnik, Gjurgjevik i Vogël, Gllarevë, Stapanicë, Rixhevë, Dollc, Caravik, Zajm, Stupë. Pastaj asfaltimi i rrugëve lokale në: Shtupel, Kërrnicë, Ranoc, Leskoc, Deiq, Jashanicë, Berkovë, Videjë, Paskalicë, Ujmirë, Shtaricë, Siqevë, Rudicë, Krushevë e Madhe, Drenoc, Përqevë, Bokshiq, Pjetërq i Poshtëm, Pjetërq i Epërm, dhe ndërtimi i rrugës Volljakë-Sferkë.

Rregullimi i infrastrukturës nëntokësore: Shtupel, Dresnik, Jashanicë, Kërrnicë, Berkovë, Videjë, Paskalicë, Rudicë, Krushevë e Vogël, Dollovë, Qeskovë, Pjetërq i Poshtëm, Pjetërq i Epërm.

Ndërtimi i rrugëve dhe trotuareve në Klinë, ndërtimi i stacionit të autobusëve, rregullimi i shtratit të lumit Klina në drejtim të Jarinjës, rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë, ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes, ndërtimi i ujësjellësit në Klinë, ndërtimi me gurë i sheshit dhe rrugëve të qytetit, fasadimi i objekteve të vjetra, rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave në Klinë, instalimi i trafos në ujësjellësin -Volljakë¹¹.

Po ashtu, gjatë vitit 2021 janë riparuar dhe mirëmbajtur rrugët pa asfalt. Është bërë sanimi i gropave, rrafshimi, mbushja dhe ngjeshja me cilindër në rrugë e rrugica në fshatra dhe periferi të qytetit. Janë shpërndarë rreth 13,400 m³ zhavorr të fraksioneve të ndryshme për meremetime rrugëve lokale.¹⁸

Rrjeti hekurudhor: Klina ka lidhje të mira edhe përmes hekurudhës, duke qenë se në Klinë gjendet nyja e dytë hekurudhore e Kosovës, pas asaj në Fushë Kosovë. Në këtë nyje degëzohen drejtimet për Pejë dhe Prizren të cilat përmes Klinës lidhen me Fushë Kosovën për t'u degëzuar më tej për Shkup, Nish apo Beograd. Fatkeqësisht drejtimet hekurudhore paraqesin një potencial ende të pashfrytëzuar duke pasur parasysh qarkullimin minimal të trenave në hekurudhat e Kosovës. 19

Transporti publik: Për shkak të funksionimit tejet të ulët të komunikacionit hekurudhor, pothuaj se i tërë transporti i udhëtarëve bëhet me autobusë. Edhe pse Klina karakterizohet me lidhje të mira rrugore, transporti i udhëtarëve në Klinë ballafaqohet me mungesa të mëdha organizative.

Klina që nga periudha e paraluftës e deri në vitin 2021 nuk ka pasur stacion të autobusëve. Gjatë vitit 2022 është realizuar projekti i stacionit të autobusëve.

TELEKOMUNIKACIONI - është transmetim i informacionit nga lloje të ndryshme të teknologjive mbi tela, radio, optike ose sisteme të tjera elektromagnetike.


Në vijim grafikun në vijim janë paraqitur rezultatet e anketimit nga ASK, lidhur me ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e

¹¹ Plani zhvillimor i komunës së Klinës 2013-2023

Klinës. 12

Rezultatet e këtij anketimi tregojnë se vetëm 2% e ekonomive familjare në komunën e Klinës posedojnë telefon fiks. Pjesa dërrmuese e tyre (85.6%) posedojnë vetëm telefon celular. Telefon fiks dhe celular kanë 10.6% e tyre, ndërsa as telefon fiks e as celular 1.8% e tyre.

Graf. 12 Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet në komunën e Klinës



Burimi: ASKDATA: *Ekonomitë familjare private në banesa të zakonshme sipas posedimit të telefonit, kompjuterit dhe qasjes në internet, 2016.*

Sa i përket posedimit të kompjuterit personal, rezultatet e këtij anketimi tregojnë se 51% e ekonomive familjare në komunën e Klinës e posedojnë së paku një të tillë dhe 49% nuk posedojnë. Prej ekonomive familjare që posedojnë kompjuter, 45.1% e tyre kanë qasje në internet nga njësia e banimit dhe 5.9% e tyre nuk kanë. Ndërsa, nga ekonomitë familjare që nuk kanë kompjuter, 1.7% e tyre shfrytëzojnë mundësitë alternative të qasjes në internet dhe 47.3% e tyre nuk kanë qasje fare.

RRJETI ENERGJETIK - Qyteti i Klinës me rrethinë furnizohet nga trafostacioni TS Klina 110/10(20) kV/kV, me fuqi instaluese 31.5 MVA. Ky trafostacion furnizohet në formë unazore nga TS Gjakova II dhe TS Peja 3, me këtë është plotësuar kushti i kërkuar sipas standardeve evropiane N-1 dhe problemet që Klina i kishte në furnizim nga rrjeti radial përmes vetëm një linjë ajrore 110 kV është eliminuar.

Ekziston mundësia e furnizimit të qytetit edhe me linjën 35 kV nga Gurrakoci, përmes trafostacionit TS Klina 35/10 kV/kV, me fuqi instaluese 2x4MVA, mirëpo nuk ka nevojë, sepse rrjeti 35kV gradualisht do të shuhet si dhe për shkak të problemeve me fytyrën e ngushta në rrjetin distributiv në Distriktin e Pejës (Klina është njësi e Pejës), është eliminuar mundësia e furnizimit në nivelin 35 kV, pra nga TS Klina 35/10 kV/kV.

Linjat furnizuese të tensionit të mesëm janë të dimensionuara për nivelin 10 kV. Këto linja kryesisht janë ajrore dhe të montuara në shtylla të impregnuara të drurit (SHD), në shtylla të betonit (SHB), e në disa ekziston kombinim i tyre (SHBD).

Njësitë transformuese janë kryesisht të montuara në shtyllë metalike TSM dhe të montuara në shtyllë betoni TS B. Gjendja teknike e këtyre objekteve në tërësi nuk është e mirë, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetërsuara dhe të mirëmbajtura jo si duhet.

Pjesa e telekomunikacionit është e kufizuar në 2000 lidhje të inkorporuara në një central të tipit SI 2000. Nga kjo sasi, fare pak janë distribuuar në pjesën rurale. Rrjeti shpërndarës është ajror.

Përmirësimi i rrjetit të energjisë elektrike në nivel komune duhet të bëhet edhe në segmentin e përmirësimit të infrastrukturës fizike me shtylla elektrike. Ky segment i infrastrukturës energjetike të komunës propozohet që në të gjitha drejtimet e shpërndarjes së energjisë elektrike të kapacitetit 20 kv, të bëhen në shtylla të betonit me gjatësi standarde (sipas standardeve të BE- së). Ndërsa në zonën urbane preferohet të ketë kablllo nëntokësore. Është e rëndësishme të theksohet se rrjeti fizik i energjetikës në nivel të vendbanimeve në mënyrë selektive duhet të përmirësohet me shtylla plotësuese nga druri ose betoni.¹³

¹³ Plani zhvillimor i komunës së Klinës, fq. 69.

Që të përmirësohet rrjetit i furnizimit me rrymë elektrike, komuna e Klinës është dakorduar me KEDS-in që të bashkëpunojnë për përmirësimin e rrjetit elektrik në fshatra, ndërrimin e shtyllave dhe instalimin e kabllave. Në vitin 2020 janë bërë investime të shumta krahasuar me vitet paraprake. Vlen të theksohen investimet në riparimin e trafos në Sferkë, Klinë, Zajm, lagjen Arbëria dhe riparimi i rrjetit në Caravik etj. Mirëpo ka kërkesa të shumta nga pothuajse të gjitha fshatrat.¹⁴

NDRIÇIMI PUBLIK - Rrjeti ekzistues i ndriçimit publik përfshin qytetin e Klinës dhe një pjesë të vendbanimeve të tjera. Mbulueshmëria e vendbanimeve deri më tani është rreth 40%. Por, komuna ka planifikuar që brenda dy vitesh të ketë mbulueshmëri të plotë të të gjitha vendbanimeve.

Gjatë vitit 2022 janë ndërruar të gjithë trupat ndriçues të tipit të vjetër me zhivë apo halogjenë me trupa ndriçues eficient. Përpos riparimit dhe ndërrimit të llambave/trupave ndriçues të dëmtuar në rrugët me ndriçim publik në qytet dhe në shëtitoren përgjatë Lumit Klina, janë instaluar edhe linja të reja në fshati Sferkë, Volljakë, Pjetërq, Gjurgjevik i Vogël, Zllakuqan.



Ndërkaq nga viti 2023 janë kryer punimet në fshatrat: Çabiq, Rudicë dhe Zabërgjë. Gjithashtu rreth 90% e ndriçimit ka përfunduar edhe në Dollovë.¹⁵ Sa i përket qytetit të Klinës mbulueshmëria është rreth 70%. Rrugët “Leonard Palucaj”, “Jeronim De Rada”, “Ilir Merturi”, Lagjja “Tikvesh” janë të përfunduara. Gjithashtu janë kryer intervenime në riparime të stabilimenteve e pajisjeve në shumë rrugë tjera.

¹⁴ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2020, fq. 98.

¹⁵ Raporti i punës së ekzekutivit për vitin 2020, fq. 99.

FURNIZIMI ME UJË - Qytetarët e komunës së Klinës furnizohen me ujë të pijshëm nëpërmjet tri formave:

- ✚ Sistemit qendror të furnizimit - ujësjellësi i KRU "HIDRODRINI";
- ✚ Sistemet e vogla - ujësjellësit lokal (sistem i pompimit), dhe
- ✚ Puset individuale.

Bazuar në statistikën e raportit të performancës komunale, rreth 75% e vendbanimeve, përfshirë edhe qytetin e Klinës furnizohen me ujë nga KRU "Hidrodrini" dhe nga sistemet e pompimit, ndërsa 25% nga puset individuale.

Gjatë vitit 2020 është investuar në sigurimin e burimit të ujit dhe instalimin e rrjetit dhe pompave në Qupevën e Lartë dhe Volljakë, ndërsa banorët kanë investuar në ndërtimin e rezervuarit të ujit. Ky investim do të ndikojë edhe në stabilizimin me furnizim me ujë gjatë gjithë vitit në fshatin Dush dhe Sferkë. Në Sferkë është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të zeza dhe po operon me sukses.

Në vitin 2019 është hartuar projekti më i rëndësishëm dhe më i kërkuar nga qytetarët e komunës së Klinës, projekti i ujit të pijshëm. Ky projekt, pas përfundimit të studimeve të fizibilitetit të kompanisë projektuese Vizion Plus nga Prishtina, vlerëson se burimi i ujit në rrjedhën e shtratit të lumit "Drini i Bardhë" siguron 300 litra ujë të pijshëm për sekond i cili do të jetë i mjaftueshëm për banorët e komunës së Klinës, si dhe për 20,000 banorët jo rezident, të cilët kalojnë kohë të caktuar gjatë vitit në vendlindje.

Në vitin 2020 ka filluar implementimi i fazës së parë: "Ndërtimi i Liqenit Akumulues dhe hapja e puseve për ujë të pijes", në vlerë prej 34,591 €. Punimet janë realizuar sipas projektit, mirëpo rezultatet e pritura nuk ishin të kënaqshme. Është vazhduar me fazën e dytë: "Ndërtimi i liqenit akumulues me gjatësi rreth 1,000 m. Kostoja e projektit sipas studimit do të arrijë deri në 3.5 milionë euro dhe është aprovuar në Asamblenë Komunale.

Në vitin 2023 ka përfunduar shtrirja e rrjetit të ujësjellësit të financuar nga Zyra Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës për 11 fshatrat të pjesës verilindore të Klinës (Gjurgjevik i Madh, Gjurgjevik i Vogël, Çabiq, Caravik, Rixhevë, Stapanicë, Përçevë, Gllarevë, Dobërdol, Zabërgjë, Stupë). Pritet lëshimi i ujit pas instalimeve të transformatorëve nga ana e ujësjellësit dhe është duke u biseduar për kyçjet shtëpiake nga donatorët. Vlera e investimit të këtij projekti është 1.5 milion Euro.

Në vitin 2023 ka përfunduar edhe shtrirja e rrjetit të ujësjellësit për fshatrat (Budisalc, Nagllavë dhe Krushevë e Madhe) nga donatorët: Zyra Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës në vlerë prej 250,000 euro, pritend instalimi i kyçjeve shtëpiake për të hyrë në funksion ky rrjet.

Në vitin 2023 ka filluar ndërtimi i fundërruesit (i cili e merr ujin e lumit Drini dhe përmes proceseve kimike e bënë të gatshëm për filtrim në fabrikën ekzistuese. Vlera e ndërtimit është 850.000 euro dhe pritend të përfundojë

në vitin 2024. Ndërrimi i filtrave në fabrikën ekzistuese pritet të realizohet në vitin 2024 nga donatorët, me vlerë 250,000 euro.

KANALIZIMI - Në komunën e Klinës, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, mirëpo mungon trajtimi i tyre. Bazuar në statistikat e raportit të performancës komunale, konsiderohet se 95% e vendbanimeve në këtë komunë kanë qasje të plotë në kanalizim. Ndërsa, 5% e tyre nuk kanë qasje.

Rrjeti i kanalizimeve në qytet e shumë fshatra po paraqet problem të madh në mirëmbajtje. Hedhja e mbeturinave në puseta dhe kyçja e stallave të bagëtive apo ujërave të shiut, shpesh shkakton defekte shumë të mëdha. Problemi më i madh paraqitet në pjesët ku është instaluar kanalizimi, mirëpo nuk ka ende rrjet të ujësjellësit, dhe si pasojë KRU "HIDRODRINI" nuk e merr në mbikëqyrje për shkak se nuk e vjelë tarifën e ujit të harxhuar. Komuna e Klinës është në procesin e marrjes së të dhënave për nevojat e riparimit dhe mirëmbajtjes së këtij rrjeti. Në vitin 2021, komuna ka intervenuar në fshatrat Caravik, Gllarevë, Sferkë, Gremnikë dhe Gjurgjevik i Madh.

Në vitin 2020 ka investuar në riparimin e rrjetit të dëmtuar në gjashtë segmente në fshatin Caravik si dhe ka siguruar gypat e brinjëzuar HDPE PSN 8DN, sipas kërkesës dhe marrëveshjes së bashkëpunimit me KRU "HIDRODRINI" në Klinë, për riparimin e kanalizimit të dëmtuar në fshatin Sferkë.

Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe kanalizimit në fshatin Volljakë është projekt i cili ka filluar në vitin 2019 dhe është realizuar nga CDI, me financim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës. Projekti në total kalon vlerën prej 300,000 €. Është projekti i parë i këtij lloji në komunën e Klinës. Funkionimi dhe mbarëvajtja e këtij impianti do të jete shembull për vazhdim në vendbanimet tjera të komunës¹⁶.

Gjatë vitit 2022 në fshatin Sferkë është ndërtuar impianti për trajtimin e ujërave të zeza, i cili është finalizuar dhe është në funksion, i njëjti po mirëmbahet nga Hidrodrini. Gjatë vitit 2023 gjithashtu kanë filluar punimet në ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në fshatin Gllarevë, i cili do të përfundon në vitin 2024. Vlera e projektit është 240,000 Euro dhe është financim i buxhetit komunal.

Komuna e Klinës, Zyra e Kryetarit me KRU "Hidrodrini" ka nënshkruar marrëveshje për marrjen në menaxhim të të gjitha fshatrave që kanë rrjet të kanalizimit (që njëkohësisht furnizohen me ujë nga ujësjellësi). Nga to priten të merren në menaxhim këto fshatra Këpuz, Qeskovë, Dollovë, Zajm, Videjë, Polce, Deiq, Berkovë, Dresnik, Dollc, Klinafc, Pograxhë, Jashanicë, Dush, Jelloc, një pjesë e Gjurgjevikut të Madh, Siqevë, Ujmirë, Gjurgjevik i Vogël, Kërnicë, Shtupel dhe Dush.

¹⁶ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2020-2021

MBETURINAT - Mbeturinat grumbullohen në tërë territorin e komunës. Komuna ka marrëveshje për shërbime me KRM "Ambienti" njësi në Klinë. Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave të amvisërisë bëhet në tërë territorin e Komunës, respektivisht në 6,873 amvisëri, 728 biznese dhe në 62 institucione.

Gjatë vitit 2022 si rezultati i performacës së mirë në lëmin e shërbimit dhe grumbullimit të mbeturinave, kemi përfituar donacion dhe atë 3 kamionë, 2025 kontejnerë 120 l dhe 240 komposterë. Komuna po ashtu ka finalizuar dokumentin e Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe Rregulloren Komunale për menaxhimin e mbeturinave dhe të cilat janë miratuar në Kuvendin Komunal të Klinës.

KULTURA – Duke marrë parasysh që komuna e Klinës është ndër komunat më të lashta në Kosovë, andaj edhe monumentet kulturore dhe historike janë të shumta.

Komuna e Klinës është e pasur me lokalitete arkeologjike dhe objekte të trashëgimisë kulturore. Fillet e jetës në komunën e Klinës datojnë që nga neoliti dhe parahistoria (më gjerësisht shih të pjesa e dytë, historikun e komunës së Klinës). Gjurmët e para të jetës janë gjetur në këto fshatra: Dollc, Pograhë, Jashanicë e Epërme dhe Qupevë e Poshtme. Gjurmët e kësaj periudhe janë gjetur në enët e qeramikës, në muret e kështjellave si ajo e Dollcit, pastaj në varreza të vjetra etj.

Lokalitetet arkeologjike më të njohura janë: Dresniku, Dollci, Pogragja, Rixheva, Çabiqi, Siqeva, Jashanica, Zabërgja, Gjurgjeviku.

Objektet e evidentuara të trashëgimisë kulturore janë: 52 kulla dhe ura, 2 mullinj, 10 lokalitete arkeologjike, 5 xhamia, 11 kisha mesjetare, 3 kisha katolike, 2 tyrbe, 1 mejtep, 6 hambarë, 2 muze privat.¹⁷

Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme (2023-2024) janë përfshirë 24 monumente dhe lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike (10 në kategorinë monument/ansambël derisa 14 në kategorinë Lokalitet arkeologjik/rezervate) dhe 18 monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore (nënkategoria monument). Gjithashtu, janë përfshirë edhe 7 objekte të luajtshme, të cilat janë paraqitur në vijim.

Monumente të trashëgimisë arkeologjike në komunën e Klinës janë: Manastiri i Dollcit (daton nga mesjeta dhe është zonë e veçantë e mbrojtur), Manastiri i Budisalcit (daton nga mesjeta dhe është zonë e veçantë e mbrojtur), Kisha e Shën Ndrimit (mesjetë), Kisha e Shën Nikollës (mesjetë), Kisha e Shën Nikollës në Mleqan

¹⁷ Strategjia e zhvillimit ekonomik të komunës së Klinës 2017-2021, fq. 21

(mesjetë), Kisha e Shën Nikollës në Çabiq (mesjetë), Kisha e Epërme në Pograxhë (mesjetë), Kisha e Shën Dhimitrit në Pograxhë (mesjetë), Lokalitet arkeologjik parahistorik në Pograxhë (parahistori), Lokalitet arkeologjik parahistorik në Përçevë (parahistori). Shih zonat e veçanta të mbrojtura në shtojcën nr 5.

Si lokalitete të trashëgimisë arkeologjike janë listuar: Gërmadhat e Kishës varrezore të Shën Nikollës në Kijevë (mesjetë), Gërmadhat e Kishës varrezore të Shën Premtes në Dresnik (mesjetë), Gërmadhat e Manastirit “Shën Pjetri & Pali” në Ujmir (mesjetë), Gërmadhat e kishës në Sferkë-Volljakë (mesjetë), Nekropoli tumular në Volljakë (parahistori), Tumat në Kramovik (parahistori), Tumat në Dollc (parahistori), Lokaliteti parahistorik “Rigjeva” në Gllarevë, Lokaliteti parahistorik “Kërshina” në Gllarevë, Tumat Ilire në lokalitetin “Boka” në Përçevë (parahistori), Tuma e madhe Ilire në Jashanicë (parahistori), Lokaliteti shumëstresor në Çabiq (parahistori, mesjetë), Tuma në Zabërgjë (parahistori) etj.

Monumentet e listuara të trashëgimisë arkitekturore janë: Manastiri i Budisalcit, Kulla e Gjon Nikollës në Budisalc, Stacioni i trenit në Budisalc, Kisha varrore e Shën Premtës në Dresnik, Kulla Shaban Ali Berisha në Grabanicë, Kulla e Enver Maxharraj në Gremnik, Kisha e Zllakuqanit, Shkolla fillore e vjetër në Pograxhë, Kulla e Jakajve në Ranoc, Kulla Sali Tafilaj në Shtaricë, Kulla Haki Gashi në Sferkë, Ura e vjetër e gurit në Budisalc, Kompleksi Memorial Mujë Krasniqi në Çabiq (shek. XXI), si dhe katër monumente të tjera që i janë shtuar kësaj liste në vitin 2023: Kulla e Bekë Sylë Millakut – Ujmirë, Kulla e Gjon Mark Çunit - Dresnik, Mulliri i Isuf Halilit – Pjetërq i Epërm, Kulla e Nue Jakut- Videjë.

Ndërsa, si objekte të luajtshme janë listuar: Dy urna (1500-1100 p.kr) – Volljakë, tre tasa një vegjak (850-600 p.kr) – Përçevë, një maje heshte (850-600 p.kr) – Përçevë dhe afreskat e stibadiumit pikturë murale – Dresnik.

Fig. 5 dhe 6 Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut – Qyteti Antik



Burimi: https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5123-02-1_lista_total_shqip.pdf

Vlen të theksohet se Dresniku është një prej lokaliteteve arkeologjike më të rëndësishme jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon. Lokaliteti arkeologjik i Dresnikut gjendet në fshatin Dresnik i Poshtëm, rreth 1.5 km në lindje të qytetit të Klinës dhe shtrihet në mes të fshatit dhe lumit Drini i Bardhë. Gërmimet e vazhdueshme kanë rezultuar më gjetje shumë interesante dhe të rëndësishme për njohjen e qytetërimit të hershëm në Kosovë. Gjatë gërmimeve të viteve 2012-2015, janë identifikuar disa monumente arkitekturore prej të cilave veçohet Aula me përmasa të mëdha. Kjo lloj Aule mund ti përket vetëm pallateve të asaj kohe. Përveç madhësisë së objektit, ky monument veçohet për shkak të dyshemeve të tëra të mozaikut polikrom (shih figurën nr 6).

Pallati është i vendosur në qendrën e këtij lokaliteti dhe gjithashtu është identifikuar muri rrethues me gjerësi 3,7 metra dhe 3 kulla që karakterizohen nga madhësia dhe trashësia e mureve. Brenda mureve është gjetur edhe një kompleks banimi në të cilën u identifikuan gjurmë të pikturave murale të hipokausteve që dëshmojnë nivelin e lartë shoqëror, ekonomik dhe artistik të banorëve të këtij kompleksi. Po ashtu janë gjetur edhe shumë monedha të perandorëve të ndryshëm romak të shekullit III dhe IV si dhe disa copëza të shtatoreve të punuara nga mermeri, pra bëhet fjalë për një “Municipium” (qytet antik). Bazuar në vlerat historike, arkeologjike, artistike dhe shkencore, aseti lokaliteti arkeologjik i Dresnikut në vitin 2016 është shpallur në mbrojtje të përhershme nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Në vitin 2023 si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjes mes CDF si përfitues në projektet e IPPA-s dhe komunës së Klinës si partner kryesor, e gjithashtu edhe marrëveshjes së bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ambasadës Amerikane, pritet të bëhen investime të mëdha në këtë lokalitet, për zhvillimin dhe promovimin e tij si qytet me rëndësi të madhe historike e kulturore.

Komuna e Klinës ka kapacitete edhe për zhvillimin e jetës kulturore. Ekziston Qendra e kulturës “Jehona e Dukagjinit”, Teatri amatorë “Osman R. Gashi” dhe Holli i Galerisë, po ashtu komuna ka edhe bibliotekën publike “Kongresi i Manastirit” si dhe Arkivin Historik të Komunës së Klinës¹⁹.

Sipas të dhënave nga raporti i punës në komunën e Klinës gjatë këtij viti (2023) janë organizuar 55 aktivitete kulturore, rinore dhe sportive që përfshijnë festivale, konkurse letrare e artistike, ekspozita, shfaqje, koncerte, trajnime, sesione informuese, turne në sport etj.

Bazuar në të njëjtin burim, numri i lexuesve në bibliotekën e qytetit gjatë këtij viti ishte 410. Vlen të theksohet

¹⁹ <https://kktk.rks-gov.net/CulturalHeritage/Details/18>.

se biblioteka ka rreth 3000 tituj me rreth 30.000 ekzemplarë, prej tyre 324 tituj janë hyrje e re në vitin 2023.

Edhe për aktivitete sportive konsiderohet se ka infrastrukturë të mirë. Komuna e Klinës ka:

- Dy klube të futbollit
- Dy klube të volejbollit
- Dy klube të hendbollit
- Një klub të basketbollit
- Një klub të boksit
- Dy klube ping-pong
- Një klub të biçiklistave
- Një klub të shahut
- Shoqata e gjuetarëve
- Shoqata e peshkatarëve
- Pesë shkolla të futbollit

Po ashtu, funksionojnë edhe terrenet sportive në vijim: Dy terrene sportive të futbollit të madh, një palestër sportive publike, katër terrene sportive me bari sintetik për futboll të vogël (private). Gjithashtu veprojnë edhe OJQ rinore , kulturore dhe artistike.

PROFILI EKONOMIK I KOMUNËS SË KLINËS – Në aspektin ekonomik, në komunën e Klinës si dhe në gjithë Kosovën, nga viti 1970 e deri në vitin 1980 vërehet një ndryshim pak më i theksuar sa i përket zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, por nga viti 1980 e deri në fillimin e luftës së fundit prapë ka një stagnim si pasojë e okupimit klasik nga pushteti okupues serb.

Nga lufta u shkatërruan në tërësi dhe pësuan dëme shumë të mëdha të gjitha ndërmarrjet ekonomike ekzistuese dhe pothuajse të gjitha shtëpitë e banimit dhe ekonomitë e tyre familjare. Edhe infrastruktura fizike edhe pse e pa zhvilluar, pësoi dëme të konsiderueshme si pasojë e luftës. Me një fjalë duhej filluar një jetë e re dhe gjithçka duhej filluar nga zeroja.

Të gjitha këto ishin dhe do jenë një barrë e madhe për pushtetin lokal të pasluftës, të cilat nuk ishte lehtë të tejkalohen për të arritur deri në një fazë të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe rritjes së mirëqenies qytetare, siç e aspirojmë duke marrë për model komunat e vendeve të zhvilluara ekonomikisht.²⁰

Zhvillimin ekonomik të Klinës duhet shikuar në kontekst më të gjerë dhe përtej kufijve komunal. Pozita e saj në raport me resurset dhe lidhjet me vijat e qarkullimit, paraqet një potencial për shndërrimin e Klinës në një nyje regjionale për zhvillimin e bujqësisë dhe veprimtarive përpunuese.²¹

Territori i Komunës së Klinës shquhet për pasuri natyrore. Hapësira karakterizohet me pyje dhe tokë kualitative bujqësore, pasuri nëntokësore, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore.²²

Ekonomia e Klinës është e bazuar në veprimtarinë bujqësore dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore. Bujqësia si aktivitet ekonomik është e bazuar në kushtet e mira të tokës bujqësore, pasurisë me rrjedha ujore si dhe të reshurave të cilat në Klinë janë në sasi të volitshme. Në komunën e Klinës 87.7% e tokës është nën 600 m lartësi mbidetare, ndërsa 95% është tokë pjellore.

Përveç bujqësisë, Klina shquhet me resurse të pasura natyrore minerale dhe jo minerale: rezerva të linjtit, rezerva të boksitit, argjilë, rërë dhe zhavorr.


Bazuar në statistikat e ASK (2011), burimet kryesore të jetesës në komunën e Klinës janë si vijon: 25.6% (9,844) e tyre kanë burim kryesor punën, 0.2% (69) e tyre si burim kryesor kanë patundshmëritë (qira, interes etj.), pastaj 6.8% (2,623) e tyre janë pensionistë, 7.7% (2,972) jetojnë nga ndihmat sociale, 0.7% (270) e tyre si burime kryesore kanë përfitimet nga sëmundjet, papunësia, pushimi i lehonisë etj., 7.2% (2,772) si burim kryesor të jetesës kanë remitancat, 44.6% (17,153) e tyre mbështeten nga personat tjerë dhe 7.2% (2,793) nga burimet tjera.

²⁰ <https://kk.rks-gov.net/kline/qyteti/historiku/>

²¹ Plani zhvillimor i komunës së Klinës, 2014-2021, fq. 9.

²² Plani zhvillimor, 2012, fq. 29.

Graf. 13 Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës në komunën e Klinës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia sipas burimit kryesor të jetesës, 2011.*

Ndërmarrjet: Sipas Zyrës për Regjistrim të Bizneseve në komunën e Klinës, numri i ndërmarrjeve të regjistruara deri më tani është 1,550. Prej tyre, 938 biznese individuale, 595 shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 10 ortakëri e përgjithshme, 1 shoqëri aksionare, 6 kooperativa bujqësore dhe 0.1% të tjera. Pjesa dërmuese e ndërmarrjeve të regjistruara janë NVM.

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara në komunën e Klinës në vitin 2023 ishte 146, ndërsa atyre të shuara 26 . Informata më të hollësishme sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike për vitin 2020 janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tab. 5 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe shuara sipas sektorëve të aktiviteteve ekonomike, 2020

Nr.	SEKTORËT DHE AKTIVITETET EKONOMIKE	REGJISTRUARA	SHUARA
1	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	10	0
2	Xehetari dhe gurëthyes	2	0
3	Prodhim	16	4
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	0	0
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	2	0
6	Ndërtimtari	28	1
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	20	15
8	Transport dhe ruajtje	6	5
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	13	0
10	Informacion dhe komunikim	2	1
11	Aktivitete financiare dhe sigurimit	1	0
12	Aktivitete të patundshmërisë	1	0
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	6	0
14	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	9	0
15	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	0	0
16	Arsim	1	0
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	2	1
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	4	0
19	Aktivitete të shërbimeve tjera	7	1
Gjithsej		130	28

Burimi: ASK: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2021*, fq. 206-207.

Numri në rritje i bizneseve nuk ka reflektuar në përmirësimin e dukshëm të ekonomisë së komunave dhe uljen e papunësisë për shkak se shumica e bizneseve janë me veprimtari jo prodhuese.²³

Bujqësia: Kushtet klimatike si dhe relievi në rajonin e komunës së Klinës, krijojnë kushtet optimale për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunë.

²³ Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 22.

Sipas të dhënave nga ASK-ja, komuna e Klinës disponon me 14,948 ha sipërfaqe me tokë bujqësore. Kulturat e drithërave zëne sipërfaqe

totale prej 7,551 ha, ku kultura e grurit dominon me sipërfaqe prej 5,557 ha, pas saj vjen kultura e misrit me 1,767 ha. Elbi, thekra dhe tërshëra kultivohen më pak. Ndërsa, nga kulturat bishtajore dominon bizelja me sipërfaqe prej 130 ha, pas saj vjen fasulja me 76 ha. Kulturat e pemëve dhe perimeve shtrihen në sipërfaqe prej 72.8 ha. Prej tyre dominon kultura

e specit me 29 ha, pastaj qepa me 9.5 ha, domatja me 8.5 ha, shalqiri me 8 ha, lakra me 5.7 ha, trangulli me 3.5 ha, hudhra me 3.3 ha etj. (ASK, 2014). Në komunën e Klinës ka vetëm 4.7 ha sipërfaqe me vreshta (ASK, 2014).²⁴

Gjatë vitit 2022-2023, me qëllim të zhvillimit të sektorit të bujqësisë, perimtarisë, pemëtarisë, blegtorisë si dhe të bletarisë, komuna e Klinës ka mbështetur fermerët me:

- 54 makina mjelëse
- 105 motokultivatorë
- 15 shkrirëse dylli
- 10 mbjellëse misri
- 10 mbjellëse gruri
- 20 freza për traktorë
- ka shpërndarë 150 trupa mollë, kumbull.
- 210 serra (165 serra me kapacitet 32m² dhe 45 serra me sipërfaqe 1 ari)



²⁴ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2020, fq. 103.

Ndërsa, gjatë vitit 2022 ndër tjera komuna ka ndërtuar 4500 m kanal për ujitje për fshatrat Stupë- Budisalc. Po ashtu, ka filluar më ndërtimin e kanaleve për ujitje në fshatrat Grabanicë, Krushevë e Madhe. Gjatë vitit 2022, komuna në bashkëpunim me organizatën humanitare “HELP organization” ka ndihmuar ne subvencionimin e ekonomive familjare me aktivitete të fidanëve, koshere për bletarët dhe mini ferma të gjedheve të ndryshme.

Sipërfaqet tokësore në komunën e Klinës.

Komuna e Klinës shtrihet në pjesën verilindore të Dukagjinit, pjesa më e madhe është kodrinore-malore. Në bazë të të dhënave kadastrale, Komuna e Klinës posedon këto sipërfaqe tokësore.

Kategoria	Private	Shoqërore	Gjithsej
Ara	9540.67.51	3263.61.34	12804.28.85
Pemishte	423.11.33	2.67.71	540.06.98
Kopshte	17.17.42	116.95.65	19.85.13
Vreshta	88.79.45	5.41.75	94.21.02
Livadhe	2075.44.09	146.39.98	2221.84.07
Kulloso	893.56.45	1193.40.85	2086.97.30
Pyll	5089.28.06	6477.84.04	11567.12.10
Jopjellore	363.27.63	1205.71.21	1568.98.84
Gjithsej	18491.31.94	12412.02.53	30903.34.29

Turizmi: Klina është e njohur për bukuritë e saj natyrore. Rrjedhimisht, ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit rekreativo-turistik.

Parku “Ujëvarat e Mirushës” është një ndër zonat më bukura dhe interesante të natyrës së Republikës së Kosovës. Ky park shtrihet në territorin e komunave: Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Saktësisht gjendet në (mes të fshatrave Volljakë, Rud, Llapqevë) në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha. Sipërfaqja e këtij parku është 598.4 ha. Lartësia mbidetare e parkut është 340-600 m.

Në këtë park, lumi Mirusha në pjesën e fundit të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirusha dhe krijon 12 ujëvara dhe 16 liqene e që këto paraqesin një fenomen të rrallë morfohidrologjik. Pa dyshim, është një nga peizazhet më atraktive për vizitorë. Ky park zbukurohet edhe më tej me florën dhe

faunën e saj. Që ky atraktivitet i rrallë natyror të zhvillohet edhe më tej, nevojitet investim në infrastrukturë fizike përveç tjerash.²⁵ Ky atraksion në vitin 2021 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës është shpallur Monument i Natyrës me Rëndësi të Veçantë me sipërfaqe të përgjithshme 598.4 ha.²⁶

Fig. 7 Ujëvara e Mirushës



²⁵ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2021, fq. 39

²⁶ https://web.archive.org/web/20160910075813/http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_Natyres_2010-2014_web.pdf

BUXHETI KOMUNAL – Disa nga vështirësitë që janë përballur komunat në Republikën e Kosovës janë: mungesa e një fondi adekuat qendror për investime kapitale të nxitur nga projektet i cili do të menaxhohej nga qeveria sipas një sistemi të unifikuar, mungesa e një tregu kreditor që do t'i mundësonte komunave qasjen në fonde për zhvillim me kamata të ulëta, mungesa e mekanizmit për fondet për emergjenca të paparashikuara. Ekziston një dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake (mesatarisht 18%) dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës (mesatarisht 82%).³³

Edhe buxheti i komunës së Klinës sigurohet nga dy burime kryesore: grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Buxheti i komunës për vitin 2023 është 13,051,595 €. Nga qeveria qendrore janë siguruar 11,517,821 €, ndërkaq shërbimet rezidenciale 160,000 € ndërsa nga të hyrat vetanake janë planifikuar të sigurohen 1,373,774 €.

Komuna e Klinës vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në pese vitet e ardhshme do të përbëjnë rreth 90% të buxhetit total të komunës.³⁴ Më detajisht shih tabelën në vijim.

Burimet e financimit: Përbëhen nga të hyrat vetanake të komunës, grantet qeveritare, grantet e donatorëve të jashtëm dhe huamarrja komunale.

Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mblidhen nga taksat, tarifat, gjjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj. ³⁵Duhet theksuar se gjatë vitit 2023 të hyrat direkte që mblidhen nga komuna e Klinës në raport me të hyrat e planifikuara ishin dukshëm më të larta³⁶



Komunat pranojnë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Grantet operative janë: grantet e përgjithshme, grantet specifike për arsim dhe grantet specifike për

³³ Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 23.

³⁴ Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2023-2025, faqe 7.

³⁵ Ligji nr. 03/I-049 për financat e pushtetit lokal.

³⁶ Raporti punës së ekzekutivit për vitin 2022

shëndetësi. Në vitin 2023, gjithsej granti qeveritar për komunën e Klinës ishte 13,051,595 €. Prej tyre, granti i përgjithshëm 5,458,575 € ose shprehur në përqindje 41.8% e grantit qeveritar, granti i arsimit 4,481,266 € (34.3%), granti i shëndetësisë 1,577,980 € (12.9%). Financimi për shërbimet rezidenciale shuma prej 160,000 E (1.2%). Financimi nga te hyrat vetanake është 1,373,774 ose 10.5%


Tab. 6 Burimet e financimit në komunën e Klinës (€), periudha 2023-2026

BURIMI I TË HYRAVE	2023	Planifikimi 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026
Granti i përgjithshëm	5,458,575	6,086,117	6,539,536	6,965,571
Granti i arsimit	4,481,266	5,453,128	5,616,723	5,785,223
Granti i shëndetësisë	1,577,980	1,673,212	1,756,872	1,844,716
Gjithsej granti qeveritar	11,517,821	13,212,457	13,913,129.49	14,595,510
Financimi për shërbimet rezidenciale	160,000			
Gjithsej të hyrat vetanake	1,373,774	1,436,260	1,492,817	1,567,546
GJITHSEJ BUXHETI	13,051,595	16,648,717	15,405,948	16,163,056

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2024-2026

Burimi: Qarkorja buxhetore 2024-02

Graf. 14 Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Klinës (%), periudha 2023-2026



Bazuar në të dhënat e tabelës nr. 5, kemi kalkuluar mesataren e grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake për periudhën 2023-2026 dhe ka rezultuar si në vijim: Mesatarisht 90.0% e buxhetit të komunës së Klinës bazohet në grantin qeveritar dhe mesatarisht 10.0% në të hyrat vetanake.

Komuna e Klinës në periudhën afatmesme buxhetore 2024-2026 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar

projektet e saj, siç e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Përgjegjësitë.

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2024-2026,

Burimi: Qarkorja buxhetore 2024-02

Tab. 7 Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Klinës (€), 2024-2026

STRUKTURA E TË HYRAVE VETANAKE	2024	%	2025	%	2026	%
Urbanizëm	183,398.0		188,216.0		201,483.98	/
Inspeksion	9,400.0		11,800.0		12,500.0	/
Kadastër	95,630.0		100,515.0		110,000.0	/
Administratë e përgjithshme	189,430.0		197,450.0		209,425.30	/
Buxhet dhe financa	586,902.0		891,536.0		913,136.72	/
Gjithsej Drejtoritë komunale	1,334,760.0	92.93%	1,389,517.0	93.08%	1,446,546.0	92.28%
<i>Arsim</i>	69,500.0	4.84%	70,000.0	4.69%	85,000.0	5.42%
<i>Shëndetësi</i>	32,000.0	2.23%	33,300.0	2.23%	36,000.0	2.30%
GJITHSEJ	1,436,260.0	100.0%	1,492,817.0	100.0%	1,567,546.0	100.0%

Burimi: Adaptuar nga: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2024-2026

Në tabelën e mësipërme është paraqitur struktura e planifikuar e të hyrave vetanake të komunës për vitet 2024-2026. Siç shihet në tabelën e mësipërme, rreth 92,75% e të hyrave vetanake në komunën e Klinës planifikohen të jenë të hyra nga administrata komunale. Pastaj rreth 4.99% etë hyrave nga arsimi dhe 2.26% nga shëndetësia.

Struktura e shpenzimeve: Siç shihet në vijim, shpenzimet rrjedhëse janë mesatarisht 69.06% të shpenzimeve komunale dhe ato kapitale mesatarisht 30.94%. Nga shpenzimet rrjedhëse, më të lartat janë ato për paga dhe mëditje, pastaj shpenzimet për mallra dhe shërbime, subvencionet dhe shpenzimet komunale.

Tab. 8 Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Klinës (€), vlerësim për periudhën 2024-2026

STRUKTURA E SHPENZIMEVE BUXHETORE	2024	%	2025	%	2026	%
Pagat dhe mëditjet	7,936,857.0		7,960,668.0		7,984,550.0	
Mallrat dhe shërbimet	1,710,000.0		1,732,230.0		1,779,000.0	
Shërbime komunale	250,000.0		268,250.0		285,686.0	
Subvencionet	600,000.0		654,000.0		693,240.0	
<i>Gjithsej Shpenzime rrjedhëse</i>	10,496,857.0	69.06%	10,615,148.0	68.90%	10,742,476.0	66.46%
<i>Shpenzimet kapitale</i>	4,151,860.0	30.94%	4,790,800.0	31.10%	5,420,580.0	33.54%
GJITHSEJ	14,648,717.0	100.0%	15,405,948.0	100.0%	16,163,056.0	100.0%

27


Burimi: Adaptuar nga: Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2024-2026.

Burimi: Qarkorja buxhetore 2024-02


²⁷ Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2024-2026.

Graf. 15 Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Klinës (%), vlerësim për periudhën 2024

Shpenzimet komunale



Shpenzimet rrjedhëse



Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Klinës 2024-2026.*


2. ANALIZA SWOT

Një nga veglat për të siguruar besueshmërinë e planeve dhe programeve strategjike për zhvillimin e komunave është edhe analiza SWOT. Në përgjithësi, analiza SWOT është analizë e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm. Mjedisi i jashtëm i komunës përfshin analizën e mundësive “O” dhe rreziqeve “T” që dalin nga mjedisi i jashtëm i komunës. Ndërsa, mjedisi i brendshëm përfshin analizën e anëve të forta “S” dhe të dobëta “W” të vetë komunës. Bazuar në rezultatet e analizës SWOT, është e mundur të vlerësohet nëse komuna ka përparësi dhe burime të brendshme për të realizuar mundësitë në dispozicion dhe për t’iu ikur rreziqeve, dhe cilat mangësi të brendshme kërkojnë eliminim të shpejtë.

Rrjedhimisht, konkurrueshmëria e një komuniteti është një funksion i faktorëve të brendshëm (forcave dhe dobësive) dhe të jashtëm (mundësive dhe kërcënimeve). Analiza SWOT do të ndihmojë në përcaktimin e opinionëve dhe perceptimeve të komunitetit, identifikimin dhe projektimin e tendencave dhe çështjeve të ardhshme për zhvillimin e SZHEL dhe përcaktimin e përgjigjeve të duhura të politikave që krijojnë mundësi për SZHEL. Rezultatet e analizës SWOT janë më të dobishme në përcaktimin e fokusit të planit strategjik. Çështjet e identifikuar do të mbështesin krijimin e vizionit, qëllimeve strategjike, objektivave dhe hartimin e programeve dhe projekteve që do të maksimizojnë pikat e forta, do të adresojnë dobësitë, do të përfitojnë nga mundësitë dhe do të zbusin kërcënimet.

Përkitazi me atë që u tha më lart, vlerësimi i përmbledhës i gjendjes së komunës së Klinës është bërë duke përdorur analizën SWOT. Komuna e Klinës ndikohet nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, qoftë pozitiv apo negativ. Faktorët e brendshëm pozitiv cilësohen si përparësi kurse ata negativ si dobësi. Ndërsa, faktorët e jashtëm cilësohen si mundësi të ofruara që duhet shfrytëzuar, përkatësisht rreziqe, të cilat komuna duhet t’i ketë parasysh dhe t’iu shmanget.

Në vijim janë prezantuar në matricë përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e dala nga analiza e mësipërme e vlerësimit të gjendjes aktuale në komunën e Klinës. Renditja e tyre është bërë krahas informatave të nxjerra sipas rrjedhës së renditjes të pjesëve të analizuara.



PËRPARËSITË

- Strukturë e re e popullsisë
- Resurse njerëzore me kualifikim në disa profesione të caktuara
- Pozitë e mirë gjeografike dhe lidhje të mira të komunikacionit rrugor
- Sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore të punueshme dhe sisteme relativisht të mira të ujitjes
- Resurse nëntokësore të thëngjillit, argjilës, boksitit, zhavorrit, gurit për ndërtim dhe dekorim etj.
- Kushte të mira klimatike për zhvillim të bujqësisë, perimtarisë, pemëtarisë, blegtorisë etj.
- Traditë e etabluar e zhvillimit të disa bizneseve me fokus në bujqësi, blegtori. Pastaj në nxjerrjen dhe prodhimin e gurit për ndërtim dhe dekor, prodhimi i dyerve dhe dritareve të plastikës etj.
- Trashëgimi të pasur kulturore dhe arkeologjike
- Resurse turistike
- Rritja e bizneseve që merren me veprimtari prodhuese
- Të fokusuarit në mirëqenien e qytetarëve
- Investimi i vazhdueshëm në infrastrukturë fizike duke përfshirë atë rrugore, nëntokësore etj.



MUNDËSITË

- Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë nëpërmjet praktikave të reja bujqësore
- Zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore, peizazheve dhe trashëgimisë kulturore
- Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake
- Shfrytëzimi i fondeve të BE-së dhe i skemave të granteve për zhvillim
- Ofrimi i shërbimeve komunale me lehtësira me qëllim të nxitjes së investimeve të huaja direkte
- Lehtësimi i procedurave administrative rreth regjistrimit të bizneseve
- Krijimi i fondit zhvillimor për përkrahjen e NVM-ve
- Nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore
- Shfrytëzimi i mundësive nëpërmjet partneriteteve publiko-private si dhe nxitja e inovacionit
- Ofrimi i trajnimeve në baza të rregullta për bizneset ekzistuese dhe ato të reja, me theks të veçantë në udhëzimet rreth aplikimit për grante
- Ruajtja e mjedisit si riciklimi i mbeturinave, rregullimi i shtratit të lumenjve, rritja e hapësirave të sipërfaqeve të pyllëzuara dhe hapësirave të gjelbëruara
- Së shpejti funksionalizimi i stacionit të autobusëve në Klinë



DOBËSITË

- Shkallë e lartë e papunësisë
- Migrimi kombëtar dhe ndërkombëtar
- Ndërtime në tokat bujqësore dhe mosshfrytëzimi racional i tyre
- Qasje e pamjaftueshme në fonde investive dhe zhvillimore
- Subvencionim i pamjaftueshëm i fermerëve
- Informim jo i mjaftueshëm i bizneseve dhe qytetarëve rreth granteve nga donatorët e ndryshëm
- Dominimi i bizneseve me veprimtari tregtare dhe shërbyese
- Mungesë e resurseve njerëzore me profil në bujqësi dhe turizëm
- Buxheti i pamjaftueshëm komunal për mbështetje më të theksuar të bizneseve vendore
- Dallim i madh ndërmjet kapacitetit ekonomik të komunave, për gjenerimin e të hyrave vetanake dhe i grantit nga Buxheti i Kosovës
- Mungesë e kulturës së promovimit dhe konsumimit të produkteve vendore
- Mos shtrirja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjithë vendbanimet
- Mos mbulueshmëria me shërbime për mbeturina në të gjitha vendbanimet
- Mos mbulueshmëria me ndriçim publik në të gjitha vendbanimet



RREZIQET

- Ndërtime në tokat bujqësore
- Zvogëlimi i vazhdueshëm i fondit të tokës bujqësore
- Teknologjia e vjetërsuar për punimin e tokës bujqësore
- Ekonomia joformale dhe evazioni fiskal
- Interesi i lartë i kredive
- Konkurrencë jo lojale si pasojë e prezencës së ekonomisë joformale
- Zvogëlimi i interesimit të donatorëve për investime
- Rënie e nivelit të arsimit nga viti në vit
- Emigrimi i kadrove profesionale



4. VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT KYÇE

Vizioni dhe misioni i komunës si dhe vlerat kyçe janë elemente thelbësore të ngulitura në të gjithë kornizën për përsosmërinë e performancës në komunën e Klinës. Si pjesë e profilit komunal është vizioni i saj, konkretisht arritja e qëndrueshmërisë ekonomike të komunës. Si dhe, misioni i vazhdueshëm i komunës në mbështetje të realizimit të këtij vizioni. Për të mbështetur misionin dhe arritjen e vizionit të komunës, qëllimet dhe objektivat vendosen përmes proceseve të planifikimit strategjik. Vlerat thelbësore mbështesin këto qëllime dhe objektiva, gjithashtu lidhin së bashku dhe përforcojnë të gjitha vendimet dhe veprimet themelore operacionale.


Në vijim janë prezantuar vizioni dhe misioni i komunës së Klinës.



Pra, vizioni i komunës së Klinës është të arrihet qëndrueshmëria ekonomike e komunës. Ndërsa, komuna ka si mision të saj përkrahjen dhe mbështetjen e zhvillimit të NVM-ve, bujqësisë, turizmit. Po ashtu, pjesë e misionit të saj është edhe përmirësimi i infrastrukturës fizike, ngritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike. Duke mos lënë anash ruajtjen e mjedisit dhe trashëgiminë kulturore.

Vlerat kyçe të komunës së Klinës janë: barazia qytetare (ofrimi i mundësive të barabartë për të gjithë qytetarët, në mënyrë që të arrihet potenciali i tyre i plotë), llogaridhënia (qeverisje komunale efikase dhe efektive), komunikimi (informimi dhe dëgjimi i qytetarëve dhe palëve tjera të interesit), profesionalizmi (kryerja e punëve dhe ofrimi i shërbimeve në mënyrë profesionale), transparencja (promovimi i punës së bazuar në transparencë) dhe respekti (trajtimi i secilës palë të interesit me dinjitet).

Fig. 7 Vlerat kyçe të komunës së Klinës



QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Për të mbështetur misionin dhe arritjen e vizionit të komunës, qëllimet strategjike dhe objektivat specifike vendosen përmes proceseve të planifikimit strategjik.

Pra, përcaktimi i qëllimeve strategjike paraqet hapin e mëtejshëm dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identifikuar, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet e mundshme në dispozicion. Më pastaj çdo qëllim specifikohet me objektiva ose nën qëllime, të cilat deshifrohen tutje nëpërmjet projekteve të propozuara për implementim.

Çështjet kryesore me të cilat përballet komuna e Klinës janë përqendruar në pesë tema, të cilat janë shndërruar në qëllime strategjike për zhvillim ekonomik lokal të komunës së Klinës.

- **Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm (përkrahja e vazhdueshme e NVM-ve** me fokus të veçantë në bujqësi dhe blegtori, nxitja e krijimit të bizneseve të qëndrueshme, nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tërheqja e investimeve të huaja, nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore, nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneriteteve Publiko Private, zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore, peizazheve, trashëgimisë kulturore).
- Zhvillim i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve (ndërtimi i rrugëve të reja dhe infrastrukturës nëntokësore, mirëmbajtja e rrugëve të vjetra, fasadimi i objekteve të vjetra, funksionalizimi i stacionit të autobusëve, ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjetit të kanalizimit, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave).
- **Përmirësim i cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale** (rinovimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive, investimi në infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore, ngritja e kapaciteteve në planifikim strategjik dhe monitorim, përmirësimi i cilësisë në menaxhim të arsimit dhe mësimdhënie, renovimi dhe ndërtimi i objekteve shëndetësore, përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore, përkrahje e të moshuarve dhe familjeve në nevojë, përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve).
- **Shërbime komunale cilësore efikase për qytetarët dhe bizneset** (informimi i qytetarëve dhe bizneseve në kohë për lehtësirat në shërbimet komunale, përmirësimi i dhënies së informatave nga zyrtarët përkatës, publikimi i përditësuar i informatave në ueb-faqen

komunës, matja e kënaqshmërisë së qytetarëve dhe bizneseve për shërbimet e ofruara komunale etj).

- **Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit jetësor** (pyllëzimi – mbjellja e drunjve në sipërfaqe të reja, rikultivimi i zonave të degraduara, mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara, ulja graduale e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës, rregullimi i shtretërve të lumenjve, pastrimi i sipërfaqes së tokës nga mbeturinat e ngurta, mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara, rishikimi i planeve menaxhuese të pyjeve në nivel komunal, mbështetje financiare për projektet e riciklimit të mbeturinave).

Në vijim janë prezantuar qëllimet strategjike, të cilat janë specifikuar më tej në objektiva dhe këto të fundit në projekte të realizueshme.

Qëllimi strategjik 1: Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm

Objektivi specifik 1.1 Përkrahja e vazhdueshme e NVM-ve me fokus të veçantë në bujqësi dhe blegtori, deri në fund të vitit 2029.

Projekti 1.1.1 Mbështetje financiare e fermerëve në ngritjen e serave me participim.

Projekti 1.1.2 Mbështetje financiare për furnizim me fidanë të pemëve sipas kërkesave.

Projekti 1.1.3. Mbështetje financiare për furnizim me pemë arrore me participim.

Projekti 1.1.4 Mbështetje financiare për ngritjen e ekonomive familjare-bujqësore.

Projekti 1.1.5 Mbështetje në sigurimin e mekanizmave bujqësorë dhe multikultivatorë, freza, mbjellëse të grurit dhe të misrit.

Projekti 1.1.6 Mbështetje financiare të fermerëve në aktivitete të bujqësisë.

Projekti 1.1.7 Mbështetje financiare fermerëve në shtimin e fondit blegtoral për 15%.

Projekti 1.1.8 Përkrahja e fermerëve nëpërmjet ofrimit të ndihmës për ndërrimin e mjeteve të vjetërsuara të punës, sidomos mekanizmave bujqësorë.

Projekti 1.1.9 Ndërtimi i kanaleve të ujitjes.

Projekti 1.1.10 Marrëveshje në nivel komunal me zinxhirët kryesorë të marketeve/tregjeve për ofrimin e lehtësirave për plasimin e produkteve të ndërmarrësve lokalë.

Projekti 1.1.11 Organizimi i panairëve me qëllim të promovimit të prodhimeve lokale.

Projekti 1.1.12 Krijimi i një fondi emergjent për mbështetjen e NVM-ve.

Objektivi specifik 1.2 Nxitja e krijimit të së paku 50 bizneseve të qëndrueshme në vit, deri në fund të vitit 2029.

Projekti 1.2.1 Ofrimi i trajnimeve çdo vit për të interesuarit për krijimin e bizneseve të reja, në fushat përkatëse si ndërmarrësi, menaxhim si dhe për industrinë përkatëse.

Projekti 1.2.2 Ofrimi i ndihmës për të interesuarit për fitimin e granteve (në aplikim dhe procedurat përcjellëse), çdo vit në periudhë tremujore.

Projekti 1.2.3 Ofrimi i konsulencave për biznes në mënyrë të vazhdueshme për bizneset e reja.

Projekti 1.2.4 Promovimi i bizneseve të reja të krijuara brenda vitit në bashkëpunim me OJQ dhe drejtoritë përkatëse, nëpërmjet organizimit të panairëve.

Objektivi specifik 1.3 Nxitja e investimeve të huaja direkte dhe tërheqja e së paku 2 milion € investime të huaja direkte, deri në fund të vitit 2029.

Projekti 1.3.1. Evidentimi i investitorëve të huaj aktual sipas veprimtarisë, numrit të punëtorëve, qarkullimit financiar brenda vitit.

Projekti 1.3.2 Identifikimi i së paku 10 investitorëve të huaj potencial, përfshirë edhe diasporën deri në fund të vitit 2029.

Projekti 1.3.3 Identifikimi dhe subvencionimi i projekteve të gjelbërta

Projekti 1.3.4 Organizimi i së paku tri konferencave ku ftohen investitorët potencialë dhe krijohen lidhjet për nxitje të investimeve të mundshme në komunë, deri në fund të vitit 2029.

Objektivi specifik 1.4 Nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore, deri në fund të vitit 2029.

Projekti 1.4.1 Përpilimi i listës së eksportit aktual sipas veprimtarisë, vëllimit dhe qarkullimit.

Projekti 1.4.2 Përkrahja e vazhdueshme dhe lehtësira të tjera taksave komunale për bizneset që eksportojnë produktet e tyre .

Projekti 1.4.3 Mbështetje e vazhdueshme institucionale në sigurimin e mekanizmit për eksport të prodhimeve bujqësore.

Objektivi specifik 1.5 Nxitja e inovacionit nëpërmjet Partneriteteve Publiko Private, inicimi i së paku tri projekteve dhe përfundimi i tyre deri në fund të vitit 2029

Projekti 1.5.1 Ngritja e grupit punues dhe kapaciteteve për Partneritete Publiko Private .

Projekti 1.5.2 Identifikimi i projekteve dhe përzgjedhja e tri projekteve potenciale për Partneritete Publiko Private.

Projekti 1.5.3 Sigurimi i fondeve për financimin e Studimeve të Fizibilitetit për projektet e përzgjedhura të Partneritete Publiko Private.

Projekti 1.5.4 Hartimi i studimit të fizibilitetit për tri projekte në Partneritete Publiko Private.

Objektivi specifik 1.6 Zhvillimi i turizmit vendor nëpërmjet promovimit të resurseve natyrore, peizazheve, trashëgimisë kulturore, deri në fund të vitit 2029.

Projekti 1.6.1 Hartimi dhe përgatitja e broshurave informuese,

Projekti 1.6.2 Promovimi i turizmit rekreativ të zonës së Klinës.

Projekti 1.6.3 Promovimi i trashëgimisë kulturore në komunën e Klinës.

Projekti 1.6.4 Promovimi i Ujëvarës së Mirushës.

Projekti 1.6.5 Promovimi i të gjitha atraksioneve turistike të komunës së Klinës në platformat më të njohura online.

Qëllimi strategjik 2: Zhvillim i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve

Objektivi specifik 2.1 Ndërtimi i rrugëve të reja dhe infrastrukturës nëntokësore, mirëmbajtja e rrugëve të vjetra, fasadimi i objekteve të vjetra në periudhën strategjike.

Projekti 2.1.1 Ndërtimi i segmenteve dhe i infrastrukturës nëntokësore të rrugës “Imer Berisha”, “Drini i Bardhë”, “Skender Regjepi”, “Abedin Rexha”, “Mehmet Haxhaj”, “Haxhi Zeka” në Klinë.

Projekti 2.1.2 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Caravik – Çabiq.

Projekti 2.1.3 Ndërtimi i segmenteve të rrugëve “Nora” (trotuar) dhe infrastrukturës nëntokësore në Zajm-Deiq.

Projekti 2.1.4 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Vogël – Klinafc.

Projekti 2.1.5 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Gllarevë – Rixhevë – Stapanicë – Zabergjë.

Projekti 2.1.6 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Grabanicë – Bokshiq – Dollovë.

Projekti 2.1.7 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gremnik.

Projekti 2.1.8 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Jashanicë – Jelloc – Resnik.

Projekti 2.1.9 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Siqevë – Ujmirë – Shtaricë.

Projekti 2.1.10 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Sferkë – Volljakë – Qupevë.

Projekti 2.1.11 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Qeskovë-Këpuz-Rastokë.

Projekti 2.1.12 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Ranoc – Leskoc.

Projekti 2.1.13 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Zllakuqan – Pataqan – Berkovë.

Projekti 2.1.14 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushevë e Vogël (trotuari Klinë-Zllakuqan).

Projekti 2.1.15 Fasadimi i objekteve të vjetra në qytet.

Projekti 2.1.16 Riparimi dhe sanimi i gropave të rrugëve me asfalt.

Projekti 2.1.17 Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve.

Projekti 2.1.18 Ndërtimi i trotuarit Jagodë – Videjë.

Projekti 2.1.19 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Pjetërq – Dugajevë-Drenoc.

Projekti 2.1.20 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gjurgjevik të Madh.

Projekti 2.1.21 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Përçevë.

Projekti 2.1.22 Ndërtimi i kanalizimit në lagjen “Arbëria”, “Tigvesh” dhe në sheshin “Nënë Tereza”.

Projekti 2.1.23 Rregullimi i rrugës Klinë – Shtupel – Binxhë.

Objektivi Specifik 2.2 Ndërtimi i parqeve, trotuareve, shtigjeve të biçikletave si dhe infrastruktura përcjellëse.

Projekti 2.2.1 Ndërtimi i parkut industrial në Dresnik.

Projekti 2.2.2 Ndërtimi i infrastrukturës për parqet energjetike në zonat: 1. Sferkë-Volljakë-Përçevë;

2. Zllakuqan-Gjurgjevik i Vogël, Ranoc, Leskoc.;

3. Gllarevë me rrethinë;

4. Këpuz- Qeskovë, Grabanicë me rrethinë;

5. Jashanicë me rrethinë;

6. Shtupel-Dranashiq- Berkovë;

7. Gjurgjevik i Madh, Çabiq, Caravik ,Dobërdol.

Projekti 2.2.3 Ndërtimi i parqeve në fshatra (çdo vit nga 2 fshatra).

Projekti 2.2.4 Ndërtimi i trotuareve në fshatra (çdo vit nga 5 fshatra) në relacion fshat-shkollë

Projekti 2.2.5 Ndërtimi i trotuarit, shtigjet e biçikletave, ndriçimi përgjatë lumit Drini i bardhë dhe Mirusha, nga ura e Haxhisë deri të Ujëvarat e Mirushës

Projekti 2.2.6 Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukturës rrugore në gryken e Jarinjës-Pograxhë-Jashanicë.

Objektivi specifik 2.3 Ndërtimi i urave.

Projekti 2.3.1 Ndërtimi i urës mbi lumin Drini i bardhë në Volljakë-Këpuz

Objektivi specifik 2.4 Planifikimi urban.

Projekti 2.4.1 1 Rekomandohet që gjatë hartimit të PZHK-së të parashihen zhvillime të reja në zonën A, Lagjen Dukagjini, tri hyrjet e qytetit si dhe në Zona, Dollc, Dresnik.

Objektivi specifik 2.5 Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrjetit të kanalizimit.

Projekti 2.5.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese.

Projekti 2.5.2 Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel – Kërnicë – Binxhë – Grabc.

Projekti 2.5.3 Ndërtimi i fundërruesit të fabrikës së ujit të pijes në komunën e Klinës.

Projekti 2.5.4 Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza Zllakuqan, Jashanicë, Shtaricë, Gllarevë, Radulloc.

Projekti 2.5.5 Ndërtimi dhe sanimi i rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Klinës.

Projekti 2.5.6 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Budisalc, Rudicë dhe urës në Rudicë.

Projekti 2.5.7 Ndërtimi i kanalizimeve në lagje të Klinës.

Projekti 2.5.8 Ndërtimi i ujësjellësve në lagje, "Arbëria", "Tigvesh", sheshi "Nënë Tereza", Dollc-Dresnik, Grabanicë, Gremnikë dhe Drenoc.

Projekti 2.5.9 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në qytet dhe fshatra.

Projekti 2.5.10 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore në Zajm.

Projekti 2.5.11 Liqeni akumulues për furnizim me ujë të pijes në Klinë.

2.5.12 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Videjë, Dollc, Paskalicë, Jagodë, Krushevë e Madhe

2.5.13 Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Klinë-Shtupel-Kërrnicë.

2.5.14 Projektet infrastrukturore me bashkëfinancim.

Objektivi specifik 2.6 Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik.

Projekti 2.6.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të trupave ndriçues

Projekti 2.6.2 Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik

Objektivi specifik 2.7. Shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Projekti 2.8.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluarra (nëse ka).

Projekti 2.8.2 Përpilimi i listës prioritare për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Projekti 2.8.3 Rritja e mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina rreth 100%, deri në fillim të vitit 2024.

Qëllimi strategjik 3: Përmirësim i cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale

Objektivi specifik 3.1. Rinovim i objekteve shkollore dhe fushave sportive deri në fund të periudhës strategjike.

Projekti 3.1.1 Rinovimi i objekteve shkollore.

Projekti 3.1.2 Rinovimi i fushave sportive.

Projekti 3.1.3 Furnizim me inventarë në shkolla.

Objektivi specifik 3.2. Investim në infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore, në shkollat fillore dhe të mesme.

Projekti 3.2.1 Deri në vitin 2024 së paku 85% e shkollave të jenë të pajisura me infrastrukturë dhe teknologji informative bashkëkohore.

Objektivi specifik 3.3. Ngritja e kapaciteteve të Drejtorisë Komunale të Arsimit në planifikim strategjik dhe monitorim, deri në shtator të vitit 2024.

Projekti 3.3.1 Zhvillimi i planit komunal për zhvillim të arsimit 2024- 2029, deri në fund të vitit 2025

Projekti 3.3.2 Trajnimi i stafit të Drejtorisë Komunale të Arsimit për planifikim strategjik dhe operacional deri në gusht të vitit 2025

Projekti 3.3.3 Hartimi i rregullores brenda shkollës deri në gusht të vitit 2025

Objektivi specifik 3.4. Përmirësimi i cilësisë në menaxhim dhe mësimdhënie nëpërmjet vlerësimit sipas metodologjisë 360°, ku nxënësit vlerësojnë mësimdhënësit, mësimdhënësit menaxhmentin e shkollës, menaxhmenti i shkollës mësimdhënësit. Të futet në aplikim prej shtatorit 2024 dhe të vazhdojë çdo vit.

Projekti 3.4.1 Zhvillimi i partneritetit mes shkollave profesionale dhe bizneseve, në mënyrë që burimet njerëzore të aftësohen krahas kërkesës së bizneseve

Projekti 3.4.2 Analizimi i rezultateve, interpretimi i tyre dhe përgatitja për përmirësimet e mundshme deri në janar të vitit 2024

Projekti 3.4.3 Përzgjedhja e më të mirëve në mesin e nxënësve, mësimdhënësve, drejtorëve të shkollave në

qershor 2024. Të praktikohet çdo vit.

Projekti 3.4.4 Zhvillimi i partneritetit mes shkollave profesionale dhe bizneseve, në mënyrë që burimet njerëzore të aftësohen krahas kërkesës së bizneseve

Objektivi specifik 3.5. Rinovimi dhe ndërtimi i objekteve shëndetësore.

Projekti 3.5.1 Ndërtimi i objekteve shëndetësore (ndërtimi i QMF –së dhe Objekti i Urgjencës)

Projekti 3.5.2 Rinovimi i objekteve shëndetësore

Objektivi specifik 3.6. Përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore në QKMF, AMF dhe AM

Projekti 3.6.1 Furnizim me pajisje mjekësore

Objektivi specifik 3.7. Përkrahje e të moshuarve dhe familjeve në nevojë.

Projekti 3.7.1 Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar.

Projekti 3.7.2 Ndihmë financiare për familjet në nevojë (720).

Projekti 3.7.3 Përmirësimi i kushteve të banimit së paku për 120 familje të identifikuar si raste sociale.

Objektivi specifik 3.8. Përmirësimi i mirëqenies së qytetarëve.

Projekti 3.8.1 Inventarizimi dhe restaurimi i objekteve kulturore

Projekti 3.8.2 Zhvillimi i turizmit dhe promovimi i parqeve të natyrës

Projekti 3.8.3 Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive.

Projekti 3.8.4 Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve kulturore.

Projekti 3.8.5 Ndërtimi i fushave sportive dhe rekreacioni nëpër lokalitete të fshatrave.

Qëllimi strategjik 4: Shërbime komunale cilësore dhe efikase për qytetarët dhe bizneset

Objektivi specifik 4.1 Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe efikase për qytetarët dhe bizneset

Projekti 4.1.1 Informimi i qytetarëve dhe bizneseve në kohë për lehtësirat në shërbimet komunale.

Projekti 4.1.2 Përmirësimi i dhënies së informatave nga zyrtarët përkatës, nëpërmjet trajnimit të tyre.

Projekti 4.1.3 Publikimi i përditësuar i informatave në ueb-faqen e komunës, për shërbimet, dokumentet e nevojshme dhe procedurat e tyre.

Projekti 4.1.4 Matja e kënaqshmërisë së qytetarëve për shërbimet e ofruara komunale.

Projekti 4.1.5 Matja e kënaqshmërisë së bizneseve për shërbimet e ofruara komunale.

Objektivi specifik 4.2 Rritja e transparencës

Projekti 4.2.1 Publikimi i rregullt i raporteve gjashtëmujore, vjetore si dhe raporteve tjera relevante të punës, në ueb-faqe të komunës.

Objektivi specifik 4.3 Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike komunale

Projekti 4.3.1 Ndërtimi dhe renovimi i objekteve komunale.

Projekti 4.3.2 Digjitalizimi i lëndës arkivore.

Projekti 4.3.3 Mirëmbajtja dhe furnizimi me pajisje dhe material shpenzues për zyrat komunale (të gjendjes civile).

Qëllimi strategjik 5: Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit jetësor

Objektivi specifik 5.1 Pyllëzimi – mbjellja e drunjëve

Projekti 5.1.1 Mbjellja e drunjëve në sipërfaqe të reja prej 3 ha në vit.

Projekti 5.1.2 Rikultivimi i zonave të degraduara në baza vjetore.

Objektivi specifik 5.2 Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara

Projekti 5.2.1 Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të gjelbëruara, në baza vjetore.

Objektivi specifik 5.3 Ulja graduale e ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës

Projekti 5.3. Ndërtimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës në Drenoc-Grabanicë.

Projekti 5.3.2 Rregullimi i shtratit të lumit Drini i bardhë në Klinë – Volljakë.

Projekti 5.3.3 Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, lagjja “Arbëria”, Burimi i Jarinjës-Pograxhë.

Projekti Ndërtimi i kanalit kullues nga Gryka e Jarinjës-Dresnik-Arbëri.

Projekti 5.3.4 Pastrimi i 80% të sipërfaqes së tokës nga mbeturinat e ngurta, në baza vjetore.

Objektivi specifik 5.4 Ruajtja e mjedisit

Projekti 5.4.1 Mbrojtja e pyjeve nga prerjet e pakontrolluara.

Projekti 5.4.2 Rishikimi i planeve menaxhuese të pyjeve në nivel komunal.

Projekti 5.4.3 Mbështetje financiare për projektet e riciklimit të mbeturinave.

Me përmbushjen e qëllimeve bazë dhe realizimin e këtyre projekteve për periudhën strategjike, në komunën e Klinës do të:

- Përfitojnë mesatarisht 1,480 NVM në vit nga përmirësimi i infrastrukturës rrugore, ligjore dhe lehtësimi i procedurave administrative rreth regjistrimit të bizneseve;
- Përfitojnë mesatarisht 40 NVM në vit nga krijimi i fondit zhvillimor për përkrahjen e NVM-ve;
- Përfitojnë mesatarisht 290 fermerë në vit nga projektet bujqësore;
- Do të rriten mesatarisht 30% në vit sipërfaqet bujqësore në serra;
- Do të rriten mesatarisht 15% në vit % rendimentet për ha;
- Do të rriten mesatarisht 30% në vit sipërfaqet e pyllëzuara dhe hapësirat e gjelbëruara;
- Do të rritet mesatarisht për 50% numri i vizitorëve;
- Do të përmirësohet mesatarisht 25% në vit mirëqenia e ekonomive familjare;
- Do të arrihet që 95% e familjeve dhe bizneseve në zonën rurale të lidhen me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit
- Do të arrihet që 80% e familjeve dhe bizneseve në zonën rurale të lidhen me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Do të përfitojnë mesatarisht 720 familje nga ndihmat financiare;
- Do të asfaltohen 98% e rrugëve etj.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal 2024-2029 për komunën e Klinës ka edhe planin e vet të zbatimit (*shih shtojcën 1*) që mbulon periudhën 2024-2029, i cili përbëhet nga aktivitetet, afati i zbatimit të tyre, vlera totale, burimi i financimit dhe institucionet udhëheqëse dhe përgjegjëse.

Plani i zbatimit të strategjisë do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në strategji. Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal përbëhet nga indikatorët matës, të cilët janë të vendosur në nivel të objektivave specifike në strategji.

Megjithëse komuna do të monitorojë dhe paraqesë raporte të rregullta, është e domosdoshme të vlerësohet nëse janë arritur rezultatet e synuara. Komuna do të përqendrohet në vlerësimin e fushave të caktuara në lidhje me rëndësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e planit strategjik. Prandaj, komuna do të fillojë një vlerësim afatmesëm në vitin 2024 dhe përsëri në fund të periudhës strategjike në vitin 2029. Sidoqoftë, vlerësimi i projekteve dhe programeve do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës strategjike.

NDIKIMI FINANCIAR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Vlerësimi i përgjithshëm i vlerës së aktiviteteve: Plani i veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2024-2029 për komunën e Klinës, ka një vlerë totale të zbatimit për tri vitet e para prej 21,082,000 €.

Burimet e financimit të strategjisë: Financimi i zbatimit të planit të veprimit të kësaj strategjie, parashihet të bëhet nga buxheti i komunës së Klinës, grantet qeveritare, donatorët etj.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

PËR: Kuvendin komunës Kryesuesin z. Fadil Gashi;

NGA: Drejtoria për Kadastër Gjeodezi e Pronësi drejtorin Amir Daka

PERMES: Kryetarit të komunës z. Zenun Elezaj



LËNDA: Kërkesë për miratimin e listës së përgjithshme dhe listës së veçante të pronave të paluajtshme të cilat parashihen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/ L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme të komunës dhe rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, kërkojmë nga kuvendi i komunës së Klinës që të miratojë listën e përgjithshme dhe listën e veçante të cilat parashihen për të dhënë në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

Kjo listë është formuar me arsyetimin e interesit të përgjithshëm publik dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Bashkangjitur gjeni:

- Listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme dhe
- Listën e veçante.

Me respekt,

Klinë datë 12.12.2023

01 Nr. 463-91731/2023

KOMUNA E KLINËS					
LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT SOCIAL					
	GJENDJA DERI ME	30.04.2022			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	AFATI I KONTRATËS		SIPËRF	QERAJA
		FILLIMI	MBARIMI	BANESËS	MUJORE
1	Miradie Borinca	26/10/2005	26/10/2007	63.70	23.89
2	Mustafë Deliu	26/10/2005	26/10/2007	63.70	23.89
3	Shqiperim Lika	26/10/2005	26/10/2007	51.50	19.31
4	Sadik Gashi	26/10/2005	26/10/2007	51.50	19.31
5	Amrush Hasani	26/10/2005	26/10/2007	51.50	19.31
6	Hidajete Zhabota	26/10/2005	26/10/2007	51.50	19.31
7	Nuredin Daka	26/10/2005	26/10/2007	63.70	15.93
8	Hamide Manaj	26/10/2005	26/10/2007	63.70	15.93
9	Nazmie Haliti	26/10/2005	26/10/2007	63.70	15.93
10	Hamit Gashi	26/10/2005	26/10/2007	63.70	15.93
11	Skender Gashi	26/10/2005	26/10/2007	63.70	15.93
12	Mane Dallaveri	26/10/2005	26/10/2007	63.70	15.93
13	Milaim Raci	26/10/2005	26/10/2007	51.50	12.88
14	Abedin Bojaj	26/10/2005	26/10/2007	51.50	12.88
15	Florije Doçi	26/10/2005	26/10/2007	51.50	12.88
16	Muhamet Gashi	26/10/2005	26/10/2007	51.50	12.88
17	Selman Berisha	26/10/2005	26/10/2007	45.01	11.25
18	Shemsie Ukaj	26/10/2005	26/10/2007	24.50	9.19
19	Faze Shala	26/10/2005	26/10/2007	32.80	8.20
20	Rexhë Gashi	26/10/2005	26/10/2007	24.50	6.13
21	Xufe Agushi	26/10/2005	26/10/2007	24.50	6.13
22	Xhafer Zikolli	26/10/2005	26/10/2007	24.50	6.13
23	Gjylferie Gashi	26/10/2005	26/10/2007	32.80	-
	TOTALI				319.09
LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT SOCIAL					
	GJENDJA DERI ME	30.04.2022			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	AFATI I KONTRATËS		SIPËRF	QERAJA
		FILLIMI	MBARIMI	BANESËS	MUJORE
1	Gjavit Shala	7/12/2006	7/12/2008	63.70	23.89
2	Imer Zenelaj	7/12/2006	7/12/2008	63.70	23.89
3	Xhafer Ademi	7/12/2006	7/12/2008	63.70	23.89
4	Zejnepe Regjepi	7/12/2006	7/12/2008	63.70	15.93
5	Ali Gashi	7/12/2006	7/12/2008	63.70	15.93
6	Jahir Racaj	7/12/2006	7/12/2008	63.70	15.93
7	Fatime Agushi	7/12/2006	7/12/2008	63.70	15.93
8	Tomë Zallaj	7/12/2006	7/12/2008	63.70	15.93
9	Hane Kelmendi	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
10	Shaban Fejzullahu	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
11	Sulltan Desku	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88

12	Jashar Elezaj	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
13	Shefqet Mulaj	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
14	Xhevat Desku	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
15	Naim Rraci	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
16	Nurie Berisha	7/12/2006	7/12/2008	51.50	12.88
17	Fazli Salihu	7/12/2006	7/12/2008	45.50	11.38
18	Sefer Desku	7/12/2006	7/12/2008	24.50	9.19
19	Fatmire Elezaj	7/12/2006	7/12/2008	32.08	8.02
20	Arben Doqi	7/12/2006	7/12/2008	32.08	8.02
21	Mic Mulaj	7/12/2006	7/12/2008	24.50	6.13
22	Shaban Krasniqi	7/12/2006	7/12/2008	24.50	6.13
23	Marie Berisha	7/12/2006	4/5/2016	24.50	-
	TOTALI				303.14
KOMUNA E KLINËS					
LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT SOCIAL					
	GJENDJA DERI ME	30.04.2022			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	AFATI I KONTRATËS		SIPËRF	QERAJA
		FILLIMI	MBARIMI	BANESËS	MUJORE
1	Vesel Berisha	1/11/2010		55.77	13.95
2	Avdi Raci	1/11/2010		55.77	13.95
3	Shehrije Isaj	1/11/2010		55.77	13.95
4	Krist Lekaj	1/11/2010		55.77	13.95
5	Bedri Raci	1/11/2010		55.77	13.95
6	Lutfi Morina	1/11/2010		55.77	13.95
7	Negjmie Morina	1/11/2010		55.77	13.95
8	Kadri Pantina	1/11/2010		55.77	13.95
9	Ismet Gjemajli	1/11/2010		55.77	13.95
10	Besim Raci	1/11/2010		55.77	13.95
11	Riza Boja	1/11/2010		50.00	12.50
12	Gjergj Tuna	1/11/2010		50.00	12.50
13	Gjemë Balaj	1/11/2010		50.00	12.50
14	Mejreme Behrami	1/11/2010		50.00	12.50
15	Xhemë Marmullaku	1/11/2010		50.00	12.50
16	Mustafë Raci	1/11/2010		50.00	12.50
17	Shota Berisha	1/11/2010		50.00	12.50
18	Asllan Berisha	1/11/2010		50.00	12.50
19	Mentor Mulaj	1/11/2010		50.00	12.50
20	Rrustem Rraci	1/11/2010		50.00	12.50
21	Niman Thaqi	1/11/2010		45.50	11.30
22	Fetie Shala	1/11/2010		45.50	11.30
23	Ilaz Gashi	1/11/2010		45.50	11.30
24	Qazim Gashi	1/11/2010		45.50	11.30
25	Bukurie Hoti	1/11/2010		45.50	11.30
	TOTALI				321.00

KOMUNA E KLINËS					
LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT KOMUNA					
	GJENDJA DERI ME	30.04.2022			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	AFATI I KONTRATËS		SIPËRF	QERAJA
		FILLIMI	MBARIMI	BANESËS	MUJORE
1	Fadil Gashi	12/10/2010			20.00
2	Esat Raci	12/10/2010			20.00
3	Vezire Elshani	12/10/2010			20.00
4	Arben Limani	12/10/2010			20.00
5	Zenel Bashota	12/10/2010			20.00
6	Fadil Agushi	12/10/2010			20.00
7	Hazir Morina	12/10/2010			20.00
8	Emine Bojaj	12/10/2010			20.00
	TOTALI				160.00
LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT SO					
	GJENDJA DERI ME	31.07.2018			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	AFATI I KO	SIPËRF	QERAJA	
		FILLIMI	BANESËS	MUJORE	
1	HILA RACAJ	18.04.2019	01-360/16040	65.00	40.00
2	FETIJE BALAJ	18.04.2019	01-360/16147	65.00	40.00
3	DYKE ADEMI	18.04.2019	01-360/16128	65.00	40.00
4	EGZON HAZIRAJ	18.04.2019	01-360/16126	65.00	40.00
5	ALI SYLA	18.04.2019	01360/16068	65.00	40.00
6	HAXHI GASHI	18.04.2019	01-360/16231	65.00	40.00
7	HAVA MORINA	18.04.2019	01-360/16133	65.00	40.00
8	HISEN VISHAJ	18.04.2019	01-360/16115	65.00	40.00
9	MENTOR GASHI	18.04.2019	01-360/16226	65.00	40.00
10	SAFETE BEQIRI	18.04.2019	01-360/16177	65.00	40.00
11	ZARIFE SHALA	18.04.2019	01-360/16103	65.00	40.00
12	ADEM BAJRAMI	18.04.2019	01-360/16189	65.00	40.00
13	Xhevdet Haltaj	18.04.2019	01/360/16052	65.00	40.00
14	MUHAMET BERISHA	18.04.2019	01-360/16169	61.00	38.00
15	GJAVIT GASHI	18.04.2019	01-360/16220	61.00	38.00
16	SABIT QERKINAJ	18.04.2019	01-360/16047	61.00	38.00
17	ESAT HAZIRAJ	18.04.2019	01-360/16073	61.00	38.00
18	RAMIZ ZEQA	18.04.2019	01-360/16057	61.00	38.00
19	ALI GASHI	18.04.2019	01-360/16151	61.00	38.00
20	HAFIJE BACAJ	18.04.2019	01-360/16083	61.00	38.00
21	MUHARREM JASHARI	18.04.2019	01-360/16194	61.00	38.00
22	FARUK JUSUFI	18.04.2019	01-360/16130	61.00	38.00
23	LULJETA HODAJ	18.04.2019	01-360/16186	61.00	38.00
24	HAMDİ BASHOTA	18.04.2019	01-360/16173	61.00	38.00
25	Agim Pantina	18.04.2019	01/360/16079	61.00	38.00
26	MARTIN MARKAJ	18.04.2019	01-360/16183	47.00	29.00
27	GJYLE HOTI	18.04.2019	01-360/16035	47.00	29.00

28	SABILE DILAVERI	18.04.2019	01-360/16119	47.00	29.00
29	SABRIJE ELEZAJ	18.04.2019	01-360/16157	47.00	29.00
30	AFERDITA GASHI	18.04.2019	01-360/16163	47.00	29.00
31	KUMRIJE BERISHA	18.04.2019	01-360/16109	47.00	29.00
32	Floriqe Berisha	18.04.2019	01/360/16063	47.00	29.00
33	Shpresa Berisha	18.04.2019	01/360/16166	47.00	29.00
34	Shkelzen Gashi	18.04.2019	01/360/16193	47.00	29.00
35	Astrit Morina	18.04.2019	01/360/16079	47.00	29.00
TOTALI					1266.00

KOMUNA E KLINËS					
LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT KOMUNA					
	GJENDJA DERI ME	30.04.2022			
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI				
	AFATI I KONTRATËS			SIPËRF	QERAJA
		DATA	FILLIMI	BANESËS	MUJORE
1	Shehide Krasniqi	05.03.2020	360-8574/20	95m2	71.25
2	Isaj Gashi	05.03.2021	360-8558-20	100m2	75.00
3	Sokol Gashi	05.03.2021	360-8566-20	110m2	82.50
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
TOTALI					228.75

LISTA E QIRAMARRËSVE - PËRFITUESVE SE BANESAVE NE OBJEKTIN E BANIMIT SOCIAL					
	GJENDJA DERI ME				
Nr.	EMRI DHE MBIEMRI	AFATI I KONTRATËS		SIPËRF	QERAJA
		FILLIMI	MBARIMI	BANESËS	MUJORE
1	Yll Imeri	01.03.2022		24.00	18.00

	Objekti I			KODI 50408	
BORGJI	BORXHI	PAGESA E MARRUR		MUAJT	Nr.
PARAPRAK	TOTAL	DATA	PAGESA		SALLDO
0.00	23.89				23.89
585.86	609.75	04.04.23	50.00		559.75
2,511.08	2,530.39				2,530.39
211.53	230.84	20.04.23	100.00		130.84
2,959.36	2,978.67				2,978.67
1,932.12	1,951.43				1,951.43
936.41	952.34	19.04.23	50.00		902.34
2,707.21	2,723.13				2,723.13
2,657.21	2,673.13				2,673.13
1,541.28	1,557.20				1,557.20
2,015.73	2,031.65				2,031.65
2,755.01	2,770.93				2,770.93
1,912.36	1,925.23	04.04.23	15.00		1,910.23
939.02	951.89				951.89
864.26	877.13				877.13
1,846.80	1,859.67				1,859.67
204.28	215.53				215.53
1,037.28	1,046.47				1,046.47
811.60	819.80				819.80
606.73	612.85				612.85
678.12	684.24				684.24
28.76	34.88				34.88
(24.60)	(24.60)				(24.60)
